
MAL BERISHA
SHQIPTARËT,
LISA
MBI
TRUALLIN
ILIR

SHQIPTARËT,

LISA MBI TRUALLIN ILIR

Përgatitur nga

Mal Berisha

Vlerësime të shtypit amerikan për shqiptarët dhe Shqipërinë, (1908-2003)

Përgatiti për botim:	Mal Berisha
Redaktore letrare:	Keti Tabako
Faqosja:	Anduena Manushi
Ballina:	Arian Dheri
Përgatitja për shtyp	Studio grafike Elsi Kongo
Shtypi	Pegi

brengës,

dhembjes,

dashurisë

dhe krenarisë sime që mban emrin

Kosovë.

VLERËSIME TË SHTYPIT AMERIKAN PËR SHQIPTARËT DHE SHQIPËRINË, (1908 – 2003)

Shqipëria është lis i rritur mbi një trung ilir. Ashtu si disa drurë të mëdhenj zënë me hijen e tyre një pjesë të madhe të lëndinës, mbretëria e shtriu hijen e saj mbi Epir, në veriperëndim të Maqedonisë dhe në më të shumtën e territoreve që sot quhen Jugosllavi. Ajo, gradualisht, u shkatërrua nën sulmin e furishëm të Filipit të Maqedonisë dhe të birit të tij të famshëm, Aleksandrit. Më vonë, rreth kohës kur Roma kishte përfituar për vete nga parulla e luftës 'Delenda est Carthago', iu kthye pushtimit transadriatik dhe Ilirisë duke e vendosur atë në varësinë e tri perandorive.

Duke ndjekur ndarjen e Epirit, Iliria ra nën gotët dhe, më vonë, jugu i saj u përfshi nga pushtimet bullgare. Kështu, të shtyrë nga prapa, fiset ilire, epirote dhe maqedonase u shkrinë në një dhe, konkretisht, në atë që gjeografia e kohës së sotme e njeh si Shqipëria.

Asgjë nuk mbeti nga Lisi Ilir përveç lëndës shqiptare.

HYRJE

Shtypi amerikan i ka kushtuar një vëmendje të posaçme Shqipërisë dhe shqiptarëve gjatë tërë kohës së ekzistencës së shtetit amerikan, por në mënyrë të veçantë gjatë shekullit XX. Janë të shumta entet botuese amerikane, të cilat janë marrë seriozisht me çështjen shqiptare. Pikërisht për këtë arsye, mendova që t'i hyj një pune hulumtuese të këtyre artikujve të botuar me qëllim që t'i bëhet e njohur lexuesit shqiptar mënyra sesi janë pasqyruar në faqet e këtij shtypi, shqiptarët dhe çështja e tyre. Ky libër është pjesa e parë e një plani për pasqyrimin e sa më shumë shkrimeve të kësaj natyre. Për hir të nivelit të lartë shkencor dhe të lehtësisë për ta pasur në dispozicion për hulumtim, në këtë vëllim, jam mbështetur, kryesisht, te shkrimet e revistës *National Geographic* dhe disa të tjerave.

Revista *National Geographic* është, ndoshta, revista më e njohur, më prestigjioze, me tirazhin më të madh dhe një ndër më të vjetrat që ende botohet në tërë botën. Në një shtrirje kohore prej 118 vjetësh që prej vitit kur ka filluar të botohet, në të kanë gjetur pasqyrim, thuajse, tërë vendet, popujt, dukuritë dhe gjërat më interesante të botës. Që prej vitit 1908 e deri sot ajo, kohë pas kohe, i ka kushtuar një vend të veçantë edhe popullit shqiptar, atdheut të tij, Shqipërisë, 'Vendit të Shqiponjave' siç e kategorizon ajo, dhe trojeve etnike shqiptare në Ballkan.

Duke shfletuar faqet e kësaj reviste, pasi isha njohur me disa shkrime të viteve të fundit për shqiptarët, të botuara prej saj, u interesova të gjeja se në çfarë kohe ia kishte tërhequr vëmendjen asaj çështja shqiptare. Për ta arritur këtë, iu drejtova Bibliotekës Publike të qytetit të Nju Jorkut në Shtetet e Bashkuara. Aty gjendej koleksioni i plotë i kësaj reviste, si dhe i mjaft botimeve të tjera periodike me interes për shqiptarët.

Kështu i bëra një shfletim të kujdesshëm çdo numri të botuar nga kjo revistë që në vitet e para të ekzistencës së saj, pra, që në vitin 1888. Pothuajse gjithçka, që është shkruar për shqiptarët ose që ka të bëjë sado pak me shqiptarët në këtë revistë, është pasqyruar në këtë libër bashkë me disa komente dhe, me një numër mjaft të madh fotografish, të shoqëruara me shpjegimet e nevojshme.

Shqipëria në Revistën *National Geographic* është shfaqur, për herë të parë, në vitin 1908[1]. Në atë kohë shteti shqiptar nuk kishte lindur ende. Shqipëria përmendet në shkrimet e bëra nga udhëtarë, të cilët kanë kaluar pranë ose nëpër Shqipëri. Në vijim ne e gjejmë Shqipërinë dhe shqiptarët në shkrime të viteve 1909, 1912, 1913 për të ardhur te shkrimi i parë i plotë, i ilustruar dhe plot informacion i shkruar nga Gjeneral Brigade i Ushtrisë Amerikane, George P. Scriven.[2] Shkrimi mban titullin, "Vëzhgime të kohëve të fundit në Shqipëri"[3] dhe është botuar në gushtin e vitit 1918. Ky shkrim mund të themi se përbën edhe fillimin e një periudhe kur Shqipëria shfaqet në revistën *National Geographic* më e plotë, me tiparet e saj të veçanta dhe në përshkrime sa romantike, aq edhe realiste. Në dhjetor të vitit 1918, në një shkrim të

[1] National Geographic Magazine, nëntor 1908, faqe 796.

[2] George P. Scriven ishte gjeneral i ushtrisë amerikane. Ai është bashkëthemelues i qendrës së aeronautikës NASA në Florida të SHBA – së në vitin 1915. Ai është edhe një ndër teoricienët e lëvizjeve të njësive të thjeshta këmbësore të ushtrisë amerikane.

[3] National Geographic Magazine, *'Recent Observation in Albania'*, shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918, faqe 90-114.

gjatë për Racat e Evropës[4], raca shqiptare zë një vend të rëndësishëm, përshkruhet plot me ngjyra interesante dhe në mënyrë mjaft shkencore.

Shkrimi i kushton vend të posaçëm racës shqiptare dhe e bën këtë me mjaft saktësi shkencore.

Të njëjtin qëllim ka edhe botimi i shkrimit 'Racat dhe fetë në Maqedoni'[5]. Edhe aty, shqiptarët, në atë pjesë të territorit të tyre në Ballkan, janë trajtuar me kujdes nga autori i shkrimit, Luigi Villari[6]. Ai ka nxjerrë në pah origjinën dhe disa nga veçoritë e popullit tonë në atë trevë, që në atë kohë gjendej nën perandorinë turke e që më pas ra nën pushtimin sllav. Të dyja këto shkrime përbëjnë pjesën e dytë të librit.

Pas vitit 1918, shqiptarët përmenden në vitin 1921 në një shkrim të gjatë për italianët, ku arbëreshët tanë janë të pranishëm jo vetëm në shkrim, por edhe në fotografi. Më vonë, thuajse pas dhjetë vjetësh, në shkurt të vitit 1931 vjen shkrimi i Melvile Chater[7] me titull: "Mbretëria më e re e Evropës"[8] - Pas shekujsh luftërash, më në fund Shqipëria gëzon një epokë paqeje dhe qëndrueshmërie - i shoqëruar nga një cikël i gjatë fotografish, me titull: 'Bijtë e Shqipes'.[9]

Po të shkonim sipas logjikës së paraqitjes kohore të elementeve të kombeve si yni, nga ana e revistës *National Geographic*, Shqipëria dhe shqiptarët do të duhej të rishfaqeshin në këtë revistë aty nga viti 1944 ose 1945. Por kjo nuk ndodhi. Në fakt nuk është aq e habitshme po të shohim ndryshimin dramatik që pësoi historia e shqiptarëve në rajonin e Ballkanit fill pas Luftës së Dytë Botërore. Një ndër dukuritë që kanë pasur më shumë ndikim, pikërisht në këtë pikëpamje, ishte armiqësia e hapur që shfaqte qeveria komuniste shqiptare ndaj çdo gjëje perëndimore, për rrjedhojë, edhe ndaj shtypit të lirë. Në këtë kuadër, kjo

---

[4] National Geographic Magazine, *'The Races of Europe'*, shkruar nga Prof. Edwin A. Grosvenor, dhjetor 1918.

[5] National Geographic Magazine, *'The Races and Religions of Macedonia'*, shkruar nga Luigi Villari, 1912, faqe 1118-1132.

[6] *Luigi Villari* (1876 – 1959), historian italian, udhëtar dhe diplomat. Autor i një numri librash midis të cilëve '*Rusia nën hijen e madhe'*.

[7] *Melvile Chater,* një ndër udhëtarët më të njohur amerikanë të gjysmës së parë të shekullit të njëzetë. Autor i shumë shkrimeve në revistën *National Geographic* dhe librave siç janë: 'Dalmatian Days', 'Duke prekur cepat fundorë të brigjeve nga lind dielli' etj.

[8] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdom'* shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 131-182.

[9] Po aty, faqe 181-190.

armiqësi pasqyrohet edhe në censurën ndaj kësaj reviste për të cilën nuk flitej kurrë në Shqipëri, por që, siç do të shohim, ajo vazhdonte të ripohonte shkencërisht vlera të pamohueshme të kombit tonë.

Është për të ardhur keq që gazetarë dhe udhëtarë të revistës *National Geographic* nuk arrinin të futeshin në Shqipëri për të vijuar pasqyrimin e jetës së 'Popullit më romantik të Evropës', siç i kishte cilësuar revista shqiptarët më se një herë. Kështu, shohim një mungesë të tejzgjatur të vendit tonë në këtë revistë, që vjen deri në tetorin e vitit 1980. Është shumë interesante të vëmë re sesi në këtë vit arritën të futeshin në Shqipëri dy qytetarë turq, gazetari i njohur Sami Kohen[10] dhe fotografi Mehmet Biber[11]. Revista *National Geographic* shfrytëzoi të vetmen mundësi që kishte për të depërtuar në guackën e izoluar shqiptare nëpërmjet këtyre dy gazetarëve të një vendi mik të Shqipërisë – Turqisë. Udhëtimi i tyre nuk u bë në të njëjtën kohë dhe shkrimi, në të vërtetë, është një përmbledhje e përshtypjeve që ata i dërguan revistës. Kështu, pas një heshtjeje prej më se pesëdhjetëvjeçare, Shqipëria u rishfaq në një formë të ndryshme nëpërmjet shkrimit shumë kuptimplotë: 'Shqipëria e vetme kundër tërë botës'.[12] Autorët e shkrimit sjellin një tablo të një realiteti të çuditshëm, e megjithatë, janë mjaft miqësorë dhe aspak përçmues ndaj asaj periudhe kohore të cilën vetëm ata që e kanë jetuar Shqipërinë e asaj kohe, mund ta përfytyrojnë.

Me këtë artikull, Shqipëria dhe shqiptarët hyjnë përsëri në 'ciklin' e vet normal të pranisë në këtë revistë. Në vitin 1990, një artikull i gjerë i revistës me titull 'Jugosllavia, një shtëpi shumë e përçarë'[13] shkruar nga Keneth C. Danforth,[14] sjell një tablo të dhembshme të periudhës shtypëse milosheviçiane kundër shqiptarëve të Kosovës. Në këtë shkrim Kosova paraqitet si vendi i aparteidit në Evropë, ndonëse janë vetëm fillimet e asaj që do të ndodhte më vonë.

---

[10] *Sami Kohen,* gazetar shumë i njohur i gazetës *Milliyet* në Stamboll, Turqi.

[11] *Mehmet Biber*, fotograf shumë i njohur i gazetarisë turke. Ai e ka shtrirë veprimtarinë e vet brenda dhe jashtë Turqisë.

[12] National Geographic, Magazine, *'Albania Alone Against the World',* tetor 1980, faqe 530-557. [13] National Geographic Magazine, *'Yugoslavia A House Much Divided'*, shkruar nga Keneth C. Danforth, gusht 1990.

Në vitin 1992, një gazetar i njohur amerikan me baba serb dhe nënë shqiptare shfaqet me një artikull mbresëlënës nga ana emocionale, realist nga ana e pasqyrimit të situatës dhe interesant nga vlerat që sjell. Dushko Doder,[15] një emër i njohur për librat e tij për Kremlinin dhe për Gorbaçovin, më vonë, edhe për biografinë e tiranit Milosheviç, si dhe për artikujt e botuar në Uashington Post, sjell në faqet e revistës një tablo të dhembshme të periudhës fill pas rënies së komunizmit në Shqipëri. [13][14] Titulli i shkrimit, po ashtu, është kuptimplotë dhe në kundërshtim të thellë me shkrimin paraardhës të revistës: "Shqipëria i hap dyert".[15]

Në vitin 2000, një gazetar tjetër i njohur, Priit Vesilind,[16] boton shkrimin, 'Shqiptarët, një popull i çbërë', [17] në të cilin gjejmë një pasqyrim krejt tjetër nga ai që çfarë *National Geographic Magazine* i kishte bërë kombit tonë deri në atë kohë. Është një shkrim, i cili, për herë të parë, ndërthur probleme të Shqipërisë me Kosovën. Shkrimi e paraqet popullin shqiptar si një të tërë, një popull që ka arritur në një cak të tillë, të cilit i përket e ardhmja dhe që është në vigjilje të marrjes së përgjegjësive të përbashkëta kombëtare.

Që prej atij viti, Shqipëria dhe shqiptarët nuk janë përmendur më në këtë revistë. Ndoshta, po të ndiqet 'cikli', ne do ta shohim veten përsëri në faqet e revistës aty nga viti 2010. Deri atëherë do të kenë ndodhur ndryshime të tilla të mëdha, që i japin revistës materiale të reja për arritje më kuptimplote të kombit tonë. Një shenjë e mirë për këtë është edhe vizita në vjeshtën e vitit 2005 e një grupi të madh udhëtarësh dhe gazetarësh të Revistës në qytetin e lashtë të Butrintit, nën kujdesin e Lordit anglez Rothschild. Për më tepër, zhvillimet bashkëkohore në Kosovë, e cila është në prag të pavarësisë, nuk mund të mbeten jashtë vëmendjes së shtypit amerikan. Një shtet i ri po lind. Amerikanët dihet se janë ata që presin ta përkundin të parët.

---

[13] *Keneth C.Danuorth*, udhëtar dhe gazetar i shquar i *National Geographic Magazine.*

[14] *Dushko Doder*, ish korrespondent i gazetës *"Uashington Post"* nga Moska, është autor i librit *"Hijet dhe pështërimat: fuqitë politike brenda Kremlinit"* – Prej Brezhnjevit te Gorbaçovi dhe biografisë së Gorbaçovit *"Heretik në Kremlin"*. Një ndër librat e tij më të fundit, i shkruar bashkë me Luise Branson, është: *"Milosheviç: portreti i një tirani"*.

[15] National Geographic Magazine, korrik 1992, faqe 66 – 93.

[16] *Pritt Vesilind*, gazetar i njohur i National Geographic Magazine. Ai ka punuar për këtë revistë 23 vjet dhe ka marrë 23 tituj nderi, 6 prej të cilëve vetëm në SHBA.

[17] National Geographic Magazine, shkurt 2000, faqe 51 – 83.

Revista *National Geographic* sigurisht që u njoh vonë në Shqipëri. Në kohën kur Shqipëria shfaqet për herë të parë në faqet e kësaj reviste, shqiptarët ishin në përpjekjet e tyre historike që jo vetëm të fitonin lirinë nga Perandoria Osmane, por edhe të mësonin shkrim e këndim. Është koha e Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe, që u mbajt në Manastir më 1908. Kuptohet që, me atë gjendje që mbretëronte, pak njerëz në Shqipëri mund të njiheshin me këtë revistë ose me shkrime të tjera të autorëve amerikanë. Por edhe kur u shkrua artikulli i parë i plotë në vitin 1918 në këtë revistë, gjendja ishte thuajse, e njëjtë. Kjo kishte ndryshuar dukshëm në vitin 1931 kur u botua shkrimi i dytë i plotë, por, sigurisht, njohësit e gjuhës angleze ose të gjuhëve të tjera evropiane në të cilat botohej revista, ishin ende të paktë. Gjendja ndryshoi në të mirë të leximit pas Luftës së Dytë Botërore, por politika e ndjekur ndaj Perëndimit bënte që lexuesi shqiptar të mos dinte gjë rreth kësaj reviste sikundër as rreth botës që fillonte jashtë kufijve të Shqipërisë. Pas ndryshimeve demokratike, kur Shqipëria u hap, shqiptarët mësuan gjuhë të huaja, dolën nëpër botë dhe revista u bë e njohur për një masë të gjerë të tyre.

Ky ka qenë, pikërisht, një ndër motivet që më ka shtyrë për t'i dhënë lexuesit një pasqyrë, sa më të plotë, të asaj sesi e kanë parë të huajt e, veçanërisht amerikanët, vendin tonë në këtë hark kohor më se një shekullor nga ente botuese kaq të mëdha siç është revista *National Geographic*, *Politics of the Balkans* etj., të cilat njihen edhe për saktësinë shkencore të botimeve të verifikuara. Në libër lexuesi do të gjejë edhe referenca nga autorë të tjerë amerikanë, siç janë Edwin Jackue, Jozef S. Roucek etj.

Është një fakt i njohur që revista *National Geographic* shquhet për fotografitë me fuqi të habitshme shprehëse, pa folur për cilësinë e tyre në planin teknik dhe artistik. Revista, që nga fillimi i botimit të saj, ka përdorur mjetet fotografike që kanë përfaqësuar kulmin e zhvillimit teknologjik të këtij arti të bukur. Shqiptarët, në këtë revistë, gjenden që prej fillimit të shekullit të kaluar. Fotografia e parë që kemi gjetur në të, është: 'Rekrutë shqiptarë për truproje të sulltanit'[19] në shkrimin 'Shënime për Maqedoninë' shkruar në nëntor të vitit 1908.

Është interesant se, edhe kur nuk ka shkrime të drejtpërdrejta për shqiptarët e mbetur jashtë kufirit të Shqipërisë, atyre u vjen në ndihmë fotografia. Kështu gjenden fotografi nga 'Tregu i Prizrenit', 'Dy djem

shqiptarë të Kosovës', fotografi nga 'Shqiptarët arbëreshë në Siçili', fotografi nga 'Shqiptarët në Maqedoni', 'Shqiptarët në Guci' etj.

Me interes janë të gjitha fotografitë. Por ka prej tyre që ilustrojnë shkrime për racën njerëzore. E tillë është fotografia 'Një burrë dhe një grua nga Shkodra' në shkrimin *The Races of Europe,* i cili ka për qëllim të ilustrojë bukurinë njerëzore në Evropë nëpërmjet kësaj race kaq të pashme siç janë shqiptarët. Po kështu, në një shkrim për Malin e Zi në vitin 1971 botohet një fotografi e disa shqiptarëve të Plavës e të Gucisë, të njohur për tiparet e tyre kreshnike si alpet ku jetojnë. Pjesa më e madhe e fotografive është botuar në këtë libër.

Për t'i dhënë mundësinë lexuesit që të njihet sa më nga afër me materialet e kësaj reviste dhe me materialet e tjera të përfshira në këtë botim, artikujt për Shqipërinë dhe për shqiptarët do të botohen sipas një rrjedhe tematike, të shoqëruar me komente të thjeshta. Ndërkohë shkrimet do të ndërthuren me fotografitë përkatëse. Gjithashtu, në fund të çdo faqeje ka edhe shumë shpjegime të termave, të vendeve, të emrave dhe të figurave më të rëndësishme. Duhet thënë se këto shpjegime nuk janë pjesë e teksteve origjinale, por një dëshirë e autorit për t'i dhënë sa më shumë informacion shkencor lexuesit të këtij materiali.

Le të jetë ky botim një ndihmë modeste në pasurimin e bibliotekës shqiptare me një libër i cili pasqyron mendimet dhe vlerësimet e autorëve të huaj, e, veçanërisht, atyre amerikanë, si dhe të enteve të tyre botuese për kombin tonë.

[19] National Geographic Magazine, 1908, fotografi e bërë nga Frederick Moore (Macmillan), faqe 797.

Shqiptarët e njohin veten si 'Bijtë e Shqipes'. Ata i kanë vënë emrin vendit të tyre 'Shqipëria' ose 'Toka e Shqipes'. ata e morën këtë emër tre shekuj para Krishtit prej Pirros, Mbretit të Epirit, për sertësinë e treguar prej tyre në betejë. Shqiptarët gjithmonë e kanë konsideruar veten një grup etnik të veçuar, që besohet të rrjedhë drejtpërsëdrejti prej ilirëve të lashtë dhe prandaj ata mbeten banorët më të vjetër të Gadishullit të Ballkanit. Të shtyrë nga valët pushtuese dhe nga lëvizjet e fiseve prej territoreve të tyre të gjera në Gadishullin e Ballkanit, ilirët u vendosën në malet e mbrojtura mirë të veriut gjatë shekujve kur keltët, romakët, hunët dhe sllavët po e pushtonin Ballkanin. Për dy mijë vjet ata ia dolën që të ruajnë trashëgiminë kulturore, zakonet, institucionet dhe gjuhën e tyre.

I

ORIGJINA E SHQIPTARËVE DHE E SHQIPËRISË

Duhet thënë që në fillim se revista *National Geographic* nuk ka zbuluar ndonjë gjë të re rreth origjinës së racës shqiptare dhe ashtu nuk ka sjellë ndonjë risi të habitshme rreth

saj. Ajo që vlen për t'u theksuar është se, duke qenë një revistë, e cila në faqet e saj boton vetëm fakte të mbështetura në hulumtime dhe në saktësi shkencore e të pohuara nga shumë burime, ajo ka ripohuar dhe ka vënë në pah të vërteta të padiskutueshme shkencore, paralele me arritjet e shkencave albanologjike, të sulmuara keq nga pseudoshkencëtarët, armiqtë dhe keqdashësit e kombit shqiptar. Interesant është fakti se në asnjë rast udhëtarët e kësaj reviste nuk kanë marrë krahun e pseudoshkencës dhe kjo e bën revistën edhe më të çmuar për ne shqiptarët. Meqë gjeneza e popullit shqiptar është pika më e rëndësishme nga ku nis zhvillimi i mëtejshëm i kombit tonë, le të ndalemi, pikërisht, në mënyrën se si e ka trajtuar revista këtë çështje:

Që në shkrimin e parë të botuar në vitin 1908, me titull 'Shënime për Maqedoninë', revista shkruan:

> "Shqiptarët vijnë nga një racë e pastër evropiane. Ata janë shtatgjatë, shpatullgjerë, me fytyra të pastra, krejt të ndryshëm nga çdo lloj populli tjetër i Maqedonisë, madje flasin një gjuhë krejt të ndryshme. Edhe pse asgjë nuk është e njohur përfundimisht rreth origjinës së tyre,

> është më se e mundshme pasardhësit e ilirëve të lashtë të cilët, një herë e një kohë, zinin tërë anën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit

dhe qenë shtyrë gradualisht në malet e Shqipërisë prej pushtimeve të njëpasnjëshme të grekëve, të romakëve, të sllavëve dhe të turqve."[18]

Ajo vijon ta forcojë këtë ide dhe t'i japë lexuesit botëror një përfytyrim historik në shkrimin më të gjerë për racat evropiane të botuar ndonjëherë në këtë revistë, nga Edwin A. Grosvenor, në vitin 1918 kur thekson:

"Shqiptarët zënë një territor në lindje të Adriatikut, që i përgjigjet afërsisht Epirit të Lashtë dhe Ilirisë Jugore. Origjina dhe gjuha e tyre paraqesin shumë vështirësi. Profesor Ripley beson se ata i kanë rrënjët në vendin e tyre. Dr. Deniker i quan ata 'një racë e veçantë adriatikase ose dinarike'. Është e pranueshme që t'i shohim ata si popullin më të vjetër të Evropës Juglindore, pasardhës të pellazgëve."[19]

Ky konstatim i revistës, natyrisht, që është në një vijë me përfundimet ku kishin arritur rilindësit tanë në atë kohë dhe përbënte një argument të pamohueshëm kundër teorive shoviniste të cilat lulëzonin në akademitë ballkanike në planin teorik, dhe që nuk mbeteshin vetëm aty, por shtriheshin edhe në atë politik, duke pasur për rrjedhojë grabitjen e pjesëve të tëra të tërësisë tokësore të banuar prej shqiptarëve që në motet e tyre stërgjyshore.

Është viti 1918 kur Gjenerali i Ushtrisë Amerikane George P. Scriven shkruan në revistë:

"Shqiptarët shihen si raca më e lashtë e Evropës Juglindore. Nuk ka të dhëna për ardhjen e tyre në Gadishullin e Ballkanit. Nuk ka as legjenda që lidhen me origjinën e tyre. Ata mendohet të jenë pasardhësit e të shpëngulurve më të hershëm arianë dhe, me këmbënguljen e tyre të lavdërueshme, ia kanë dalë që të vijnë deri në ditët tona, duke i përdorur malet e vendit të tyre si fortesa mbrojtëse në rrjedhën e shumë mijëvjeçarëve."[20]

Më pas ai jep një përkufizim i cili do të shkaktonte një ndjenjë ëndjeje dhe krenarie te çdo pjesëtar i racës shqiptare: "Shqipëria është vendi më romantik në Evropë, ndoshta edhe në botë."[21]

---

[18] National Geographic Magazine, *'Notes on Macedonia'*, 1908, faqe 798.

[19] National Geographic Magazine, *'The Races of Europe'*, dhjetor 1918, faqe 477.

[20] National Geographic Magazine, *'Recent Observation in Albania',* shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918, faqe 91.

[21] National Geographic Magazine, 1908, faqe 35.

Duke vijuar me vlerësimin e lashtësisë së racës shqiptare, revista ripohon edhe këtë vlerësim për origjinën pellazgo-ilire të shqiptarëve:

"Shqiptarët e sotëm do t'ju thonë se ata vetë përfaqësojnë racën më të lashtë të Evropës Juglindore. Në të vërtetë, gjuha dhe zakonet e tyre fisnore na kujtojnë origjinën e tyre të largët. Ata ndoshta janë pasardhësit e ilirëve të lashtë, të cilët, në fakt, rrjedhin

Fotografi me ngjyra nga Luigji Pellerano (1931)
Kjo kështjellë përkujton heroin legjendar të shqiptarëve-Skënderbeun në Krujë.

Kjo kullë e vetmuar e Skënderbeut është ajo që Longfellou, në 'Përrallat e bujtinës ndanë udhës', e quan Kështjella e Bardhë ose Ak Hisar siç u quajt qyteti i Krujës nga turqit. Në shekullin XV, Skënderbeu iku nga shërbimi për sulltanin, mori kështjellën e Krujës dhe nisi betejën për liri, që zgjati gjatë tërë jetës së tij, për çlirimin e Shqipërisë.

nga pellazgët, rrënjët e kësaj race i gjejmë në letërsinë greke."[22]

[22] National Geographic Magazine, *'Notes on Macedonia'*, nëntor1908, faqe 797.

Nëpërmjet udhëtarit të famshëm Melvile Chater, revista arrin deri aty ku kanë shkuar në atë kohë shkencëtarët tanë, por edhe të huaj, si Milan Shuflaj,[23] Han,[24] Jokl[2526] etj., kur thotë se:

> "Deri atëherë kur arkeologjia të hedhë më shumë dritë mbi gjuhën shqipe, mendimet filologjike lidhur me këtë temë, do të jenë të ndryshme. Kjo na bën të pohojmë se një e treta e fjalëve të gjuhës shqipe kanë origjinë pellazge; se gjuha shqipe është pasardhëse e ilirishtes së lashtë dhe se nuk ka ngjashmëri me greqishten; se është



Fotografi nga George P. Scriven (1918)
Kështjella e Ali Pashë Telepenës

gjuha më e vjetër në Evropë dhe se është nëna e latinishtes dhe e greqishtes."[9]

[23] *Milan Shuflaj* (1879 – 1931), hebre hungarez që jetonte në Kroaci. Ai mori gradën e doktorit të shkencave albanologjike dhe u bë i njohur në botë për studimet e tij në këtë fushë. Është vrarë nga shovinistët serbë pikërisht për këto studime.

[24] *Johan George Van Han* (1811-1869), albanolog austriak i shquar i shekullit XIX.

[25] *Norbert Jokl* (1877 – 1942), albanolog austriak me origjinë hebre, që i kushtoi tërë jetën gjuhës shqipe, duke lënë pas një ndër bibliotekat më të pasura në botë për këtë çështje. Ai u bë viktimë e nazistëve.

[26] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdom'*, shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 140.

Fotografi nga James M. Draley (1931)
Toka e njerëzve të shqipes

Mbetet të mësohet ende për 'Tokën e njerëzve të shqipes', për 28 mijë kilometrat e saj katrorë të egra, për malet e saj romantike dhe për fushat pjellore, për burimet minerale dhe për qytetet e fshatrat që popullohen prej 830.000 banorëve e, në veçanti, për malësorët e saj pak të njohur. Veçoria e gjuhës shqipe është se ajo përmban edhe trajtën e shquar edhe atë të pashquar për emrat e vendeve. Trajta e shquar formohet duke ndryshuar mbaresat. Kështu që, emrat Shkodër dhe Shkumbin, në trajtën e shquar shkruhen Shkodra dhe Shkumbini, ku më shumë vend zë forma e dytë.

Shkrimtarët dhe studiuesit e revistës jo vetëm që e ripohojnë faktin e mësipërm, por edhe e ilustrojnë atë duke paraqitur krahasime të tilla, të cilat tregojnë me fakte ndikimin e gjuhës pellazge, prej nga rrjedhin ilirët dhe, më pas, shqiptarët, mbi mitologjinë greke dhe, pikërisht:

"Çfarëdo që të kenë menduar Platoni dhe Herodoti për formulimin e mësipërm, ata të dy na thonë se grekët i huazuan hyjnitë e tyre nga pellazgët. Dhe, sipas disa filologëve, ajo pikëpamje është mbështetur në faktin se emrat Zeus, Nemesis dhe Rhea rrjedhin nga fjalët shqipe zee-zëri, nemë-mallkim dhe rhea-retë."[27]

Luani i Shën Markut në Vuno (1918)

Ndonëse në dukje nuk të jep atë ndjenjë madhështie që të jep Luani i Lucernës, e gdhendur njësoj në shkëmb natyror, kjo skulpturë e vogël paraqet një kapitull interesant të Historisë së Shqipërisë. Ajo është një relike e kohëve mesjetare kur Venecia nuk ishte vetëm nikoqirja e bregdetit shqiptar, por edhe fuqia më e madhe tregtare e botës.

[27] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdom'*, shkruar nga Melvile Chater shkurt 1931, faqe 142.



Fotografi me ngjyra nga Luigi Pellerano (1931)
Shën Pali mund ta ketë parë peizazhin e lashtë shkodran.

Fusha të gjera shpalosen të rrethuara prej malesh të thepisura. Shkodra e vjetër, në dallim nga qyteti i sotëm, ishte, në lashtësi, kryeqyteti i mbretërve ilirë. Një mijë vjet më parë vendi u bë i njohur me emrin Albania. Sipas fjalëve të tij, atë e vizitoi Shën Pali, i cili thotë: "Kam bërë predikime të parreshtura rreth e qark Ilirisë".

Ndërkohë, në studimin për 'Racat e Evropës', Profesor Grosvenor shprehet qartë:

"Gjuha e tyre mendohet të jetë e vetmja gjuhë që ka mbijetuar nga grupi i gjuhëve të lashta trako-ilire. Fjalori i gjuhës së tyre është i ngarkuar me shumë fjalë greke, latine, italiane, sllave dhe turke, por gramatika mbetet tërësisht e veçantë."[28]

Lexuesi do të ndjekë me ëndje përcaktimin e mëposhtëm që revista i bën 'Lisit shqiptar' të rritur mbi 'Trungun ilir'. Duke përdorur një figurë shumë kuptimplote artistike, është ripohuar, për të shumtën herë, vazhdimësia e pranisë shqiptare në trojet e veta ilire:

[28] National Geographic Magazine, *'Races of Europe',* dhjetor 1918, faqe 477.

Fotografi nga Theron J. Damon (1912) Një urë e lashtë afër qytetit të Shkodrës.

"Shqipëria është një lis i rritur mbi një trung ilir. Ashtu si disa drurë të mëdhenj zënë me hijen e tyre një pjesë të madhe të lëndinës, mbretëria e shtriu hijen e saj mbi Epir, në veriperëndim të Maqedonisë dhe në më të shumtën e territoreve që sot quhen Jugosllavi. Ajo, gradualisht, u shkatërrua nën sulmin e furishëm të Filipit të Maqedonisë dhe birit të tij të famshëm, Aleksandrit. Pastaj rreth kohës kur Roma kishte përfituar për vete nga parulla e luftës 'Delenda est Carthago'[29] ajo iu kthye pushtimit transadriatik dhe Ilirisë duke e vendosur atë në vartësinë e tri perandorive."

"Duke ndjekur ndarjen e Epirit, Iliria ra nën gotët dhe më vonë, jugu i saj u përfshi nga pushtimet bullgare. Kështu, të shtyrë nga prapa, fiset ilire, epirote dhe maqedone u shkrinë në një dhe, konkretisht, në atë që gjeografia moderne e njeh si Shqipëria. Asgjë nuk mbeti nga Lisi Ilir përveç lëndës shqiptare."[30]

[29] *Delenda est Carthago*- Kartagjena duhet të shkatërrohet, parullë romake për shkatërrimin e Kartagjenës gjatë Luftës Punike, 149 – 146 p.e.re.

[30] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melville Çater, shkurt 1931, faqe 142.



Fotografi nga Franc Bespalatk (1931)
Një urë me shumë harqe lidh dy anët e Lumit Osum në Berat.

Ujërat e Osumit, një rajon pjellor i jugut, mbajnë gjallë me vaditje fushat e ullinjve dhe të fiqve, të vreshtave dhe të duhanit.

Këtë ide të Melvile Chater, të shkruar që në vitin 1931, e sjell përsëri në faqet e revistës Priit Vesilind thuajse shtatëdhjetë vjet më vonë kur shkruan:

> "Për shqiptarët, *Shqipëri* është ai territor ku shqiptarët kanë jetuar historikisht – ajo pjesë e Ballkanit që shtrihet edhe jashtë kufijve të saj politikë, duke përfshirë Kosovën dhe pjesë të tjera të Serbisë, Maqedonisë, Greqisë dhe të Malit të Zi."[31]
>
> Ashtu siç ka mbetur e gjymtuar nga Konferenca e Londrës, Shqipëria ka një sipërfaqe, thuajse, të barabartë me shtetet e Nju Xhersit dhe të Dolloveres së bashku, por vetëm me 800.000 banorë. Ajo është sa një e katërta e atyre dy shteteve. Më pak se një e treta e shqiptarëve banojnë brenda vijave kufizuese të vendit të tyre, ndërsa të tjerët jetojnë të shpërndarë në Maqedoni, Serbi, Mal të Zi, në Azinë e Vogël dhe në Siçili.

[31] National Geographic Magazine, *'Albanians A People Undone'*, shkruar nga Priit Vesilind, shkurt, 2000.

Por edhe më parë, në shkrimin e tij 'Racat në Evropë', profesor Grosvenor kishte vlerësuar:

> "Shqiptarët shfaqin qëndresë të jashtëzakonshme në ruajtjen e racës së tyre. Bashkësitë shqiptare në Itali dhe në Siçili, të cilat datohet të jenë aty që në shekullin e pesëmbëdhjetë, të përbëra prej një popullsie prej mëse 200.000 frymësh, janë përzier fare pak me italianët dhe vazhdojnë të ruajnë gjuhën dhe zakonet e tyre në një shkallë të lakmueshme. Po kështu, por në një masë më të vogël, bëjnë edhe 200.000 shqiptarët e tjerë që gjenden në Greqi."[32]

Ndërkohë që në shkrimin 'Racat dhe fetë në Maqedoni', në kapitullin për 'Shqiptarët', Luigi Villari shkruante shprehimisht:

"Me gjithë barbarizmin, shqiptarët kanë shumë cilësi të shkëlqyera. Ata janë trima, mikpritës dhe, nëse arrihet t'u merret besa dhe të bëhen për vete, ata mbeten tërësisht besnikë gjer në vdekje."[16]

Fotografi nga Katrice Nicolson (1918)
Malësorë të Veriut

Për të hequr çdo mëdyshje në lidhje me autoktoninë e pranisë [33]shqiptare në dy rajonet që sot janë politikisht të shkëputura, autori na sjell këtë vlerësim:

[32] National Geographic Magazine, *'Races of Europe'*, dhjetor 1918, faqe 477.
[33] National Geographic Magazine, *'The Races and Religions of Macedonia',* shkruar nga Luig Villari, 1912, faqe 1129.

"Rajoni perëndimor i Vilajetit të Manastirit dhe një pjesë e madhe e atij të Kosovës janë të banuara prej një race më të egër dhe më të vjetër se çdo racë tjetër që gjendet në Evropë – prej shqiptarëve. Shumë pak dihet për këtë popull interesant e të çuditshëm përveç asaj që ata flasin një gjuhë indoevropiane, por nuk i takojnë asnjërit prej grupeve të njohura të familjes ariane. Besohet se ata rrjedhin prej ilirëve të lashtë, të cilët qenë shtyrë me forcë drejt perëndimit prej valëve sllave që përparonin në atë drejtim."[34]

Një vlerësim të përafërt revista e kishte hedhur në faqet e saj që në vitin 1909 në shkrimin 'Ku takohen Lindja dhe Perëndimi'.

"Shqiptarët janë të njohur si pasardhësit e banorëve më të lashtë të Gadishullit të Ballkanit, të cilët ndodhen aty përpara grekëve dhe romakëve dhe nuk janë të lidhur me ndonjë popull tjetër ballkanik."[35]

Në vitin 1912, kur revista po u kushtonte vëmendje të posaçme zhvillimeve të ditëve të fundit të Perandorisë Osmane dhe Turqve të Rinj, ja se çfarë shkruhej në të për shqiptarët:

"Shqiptarët janë një racë e ashpër malësore, të cilët kanë mbetur të varfër dhe me toka djerrë prej luftërave shkatërruese që kanë përjetuar që kur raca myslimane ua pushtoi vendin."[36]

Pas pushtimit turk, një ndër çështjet më thelbësore për kombin shqiptar mbeti ruajtja e identitetit të tij evropian edhe në kushtet e ndërrimit masiv të detyruar të fesë. Pra, pas këtij pushtimi që zgjati shekuj të tërë, shtrohej pyetja, a kishte mbetur shqiptari evropian? Faktin që shqiptari kishte qenë dhe kishte mbetur evropian e pohonin dhe e ripohonin të gjithë rilindësit shqiptarë edhe kur jetonin në lindje, ashtu edhe në perëndim. Të gjithë pohonin njëzëri se shqiptarët janë një popull

[34] Po aty.

[35] National Geographic Magazine, *'Where East Meets West',* 1909, faqe 327.

[36] National Geographic Magazine, *'The Young Turks'*, janar 1912, faqe 71.



Fotografi nga Luigji Pellerano
Një treg me gjatësi sa vetë qyteti

Tregu i (stër)zgjatur i Krujës (Kroja) i kujton vizitorit amerikan një "mapo dyzetkatëshe të shtrirë për tokë". Shitësa mishi, furrxhinj, prodhues kandilësh, gurgdhendës të kalldrëmit, pastiçierë, prodhues qilimash dhe llullash, e sa e sa zeje të tjera, të gjithë, njëri pas tjetrit, e zënë këtë treg prej dyzet ose pesëdhjetë dyqanesh, fasadat e të cilave shkojnë paralel me rrugicën e kalldrëmtë.

Por le të shohim sesi e sjell këtë të vërtetë revista *National Geographic* që në vitin 1912, në muajin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në shkrimin e Theron J. Damon[37] nga Konstandinopoja:

"Shqiptari është evropian; më shumë se dymijë vjet ai ka jetuar aty ku jeton edhe sot – në fortesën e Epirit dhe të Ilirisë, përballë thembrës së çizmes italiane në brigjet e Detit Adriatik."[21]

Këtë të vërtetë autori e ilustron shumë bukur me arbëreshët e Italisë, të cilët, edhe pse jo në trojet e tyre, e kanë ruajtur identitetin kombëtar.

[37] *Theron J. Damon*, National Geographic Magazine, nëntor 1912, faqe 1090-1103. [21] National Geographic Magazine, *'The Albanians'*, shkruar nga Theron J. Damon, nëntor1912, faqe 1090-1103.

Cilido të jetë shkaku, cilësia ose motivi i kësaj mbijetese, çka është me rëndësi është fakti që shqiptarët kudo që janë, ruajnë dallimet e tyre racore:

> "Shqiptarët e Italisë i ruajnë dallimet e tyre racore edhe sot e kësaj dite. Mosdashja ose pazotësia e shqiptarëve për të ndryshuar individualitetin e tyre ka gjetur pasqyrim në vazhdimësinë e pranisë së sistemit fisnor shqiptar dhe në grindjet e pandërprera ndërfisnore. Si rrjedhojë e kësaj, Shqipëria nuk ka mundur të paraqesë një front të bashkuar kundër një armiku të përbashkët."[38]



Fistar shqiptar në Pazarin e Shkodrës (1912)

Udhëtarët e revistës janë marrë intensivisht edhe me përcaktimin e prejardhjes së emrit *Shqipëri* dhe *shqiptar*. Në të janë dhënë shumë variante, një pjesë e të cilave, sigurisht, janë të diskutueshme, por, gjithsesi, lexuesi do të ketë rast të njihet me to. Trajtimin më të gjerë të kësaj çështjeje e ka bërë Melvile Chater që në hapat e parë të udhëtimit të tij në Shqipëri. Ja

[38] Po aty, faqe 1093.

Hartë e vizatuar nga A.H Bumstead (1918)
Hartë e Shqipërisë dhe e kufijve të saj me vendet fqinje ballkanike.

si i përshkruan ai kontaktet e para me 'Tokën e njerëzve të shqiponjës':

> "… sapo e ndalëm makinën, një shqiponjë gjigande u ngrit prej anës së rrugës, përplasi krahët dhe u ngjit si shigjetë drejt kupës së kaltërt të qiellit duke kaluar përmbi kreshtat e maleve të largëta. Deri tani, takimet me njerëzit, shtrëngimi i duarve me ta, ishin ato që kishim ndier në Shqipëri, por ishte ai shpend madhështor që na bëri të ndiheshim se ishim vërtetë në Shqipërinë e lashtë, në ***Tokën e njerëzve të shqiponjës***. Nëse disa turistë të lashtë grekë ose romakë do të kishin thirrur me të madhe, 'Ja, kjo është Shqipëria!', shqiptarët vetë nuk do ta kishin kuptuar se për çfarë vendi po bëhej fjalë. Afërsisht nëntë shekuj më parë, disa të huaj, ndoshta, duke e gjetur fjalën *Shkipëria* të vështirë për ta shqiptuar, e kthyen atë nga *alp* ose *alb* në *Albania* si një emër i maleve të bardha të mbuluara me dëborë."[23] Dhe më poshtë vijon:

> "Emri *shqiptarët*, në vetvete, shkon thellë në histori te shfaqja e fiseve të mjegullta nëpër malet e Ballkanit. Ashtu si fjala *shkëmb*, e

cila është fjalë vendase, dhe ka kuptimin [39]*gur*, edhe vetë emri ka shumë mundësi që të ketë kuptimin *banorët e shkëmbinjve* ose *malësorët*. Por tradita shqiptare e bazuar te Plutarku ofron një shpjegim më bindës. Biografi grek e lidh këtë me krahasimin që Pirros, Mbretit të Epirotëve, i bënin trupat e tij me shqiponjën. Monarku me plot hire, bashkë me luftëtarët e tij, i lëshonte shigjetat drejt qiellit duke krijuar një pamje të ngjashme me shqiponjën."[40]

Për të ardhur te ky konstatim, ndoshta i pari në llojin e vet i njohur deri më sot:

"Kuptimi simbolik i shqiponjës dhe i shigjetës është i lashtë. Mijëra vjet më vonë, ai simbol do të shfaqej në Stemën Konsullore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sido që të jetë, epirotët u kapën pas emrit të Mbretit Pirro dhe simboleve të tij, duke e pagëzuar vetveten me krenari - shqiptarë ose Bijtë e Shqipes."[25]

Në librin 'Luftërat e shqiptarëve në Botën e Vjetër dhe të Re' gjejmë një shpjegim të përafërt në lidhje me origjinën e shqiptarëve, të emrit të tyre dhe të gjuhës shqipe. Pjesa që vijon dëshmon edhe një herë interesin e autorëve amerikanë për çështjen shqiptare.

"Robert Guiscard, kryqtari norman që e pushtoi Shqipërinë Qendrore në shekullin e njëmbëdhjetë, thuhet të jetë përgjegjës për emrin Albania; ai dhe pasuesit e tij e gjetën të vështirë që ta shqiptonin emrin e qytetit shqiptar *Elbasan* dhe e ndryshuan atë në Albania.[41]"

Më poshtë le t'i referohemi autorit tjetër amerikan Josef R. Reucek, i cili është marrë intensivisht më çështjen shqiptare. Ja si e pasqyron ai çështjen shqiptare në librin e tij *Politics of the Balkans*:

"Shqiptarët e njohin veten si *Bijtë e Shqipes*. Ata i kanë vënë vendit të tyre emrin *Shqipëria* ose *Toka e Shqipes*. E morën këtë emër tre shekuj para Krishtit prej Pirros, Mbretit të Epirit, për sertësinë e

[39] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdom'* shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, 140.

[40] Po aty. [25]

Po aty.

[41] *'Albanian Struggle in the Old World and New'*, Boston: The Writer Inc., 1939, faqe 3-4.

treguar prej tyre në betejë. Shqiptarët gjithmonë e kanë konsideruar veten një grup etnik të veçuar që besohet të rrjedhë drejtpërsëdrejti prej ilirëve të lashtë dhe prej këndej ata mbeten banorët më të vjetër të Gadishullit të Ballkanit. Të shtyrë nga valët pushtuese dhe nga lëvizjet e fiseve prej territoreve të tyre të gjera në Gadishullin e Ballkanit, ilirët u vendosën në malet e mbrojtura mirë të veriut gjatë shekujve kur keltët, romakët, hunët dhe sllavët po e pushtonin Ballkanin. Për dy mijë vjet ata ia dolën që të ruanin trashëgiminë kulturore, zakonet, institucionet e tyre dhe gjuhën.

Kushtet gjeografike i kanë ndarë shqiptarët në dy grupe të lidhura fort midis tyre, gegëve në veri dhe toskëve në jug. Lumi Shkumbin është vija ndarëse e tyre. Gegët që jetojnë në izolim më të madh përshkruhen, zakonisht, të fortë, supersticiozë, por edhe të guximshëm, të thjeshtë dhe besnikë. Si ushtarë ata janë të pathyeshëm, por edhe rebelë. Nga ana tjetër, toskët i kanë zgjeruar marrëdhëniet me grekët dhe me vllehët, merren me tregti dhe me bujqësi në ndryshin nga punët blegtore të veriorëve. Gjuha ka shumë dialekte, të cilat nuk i pengojnë njerëzit ta kuptojnë njëri-tjetrin. Shumica e popullsisë është myslimane. Në jug gjendet një pakicë e cila lutet në Kishën Ortodokse greke, ndërsa në veri gjendet bashkësia katolike.

...

Në vitin 1879, në Kostandinopojë, një grup mësuesish atdhetarë shqiptarë përgatitën Abetaren shqipe. Më pas librat, revistat dhe periodikët u shfaqën në 'gjuhën e çuditshme dhe të mallkuar shqipe'. Pas Traktatit të Shën Stefanit, i cili i dha Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë territore të tëra të banuara vetëm prej shqiptarëve, udhëheqësit atdhetarë shqiptarë, të shtypur në vendin e tyre, u detyruan të vepronin në dobi të çështjes së tyre kombëtare nga Bukureshti, Sofia, Kajroja dhe, më në fund, edhe nga Shtetet e Bashkuara".[27]

Dhe në tërë këto konstatime shkencore të udhëtarëve, më profetiku do të ishte fragmenti i mëposhtëm i shkruar nga një gjeneral i ushtrisë amerikane, George P. Scriven, bashkëkohës i Presidentit amerikan Wilson, i cili bëri aq shumë për ne shqiptarët, kur shkruan:

"Shqipërisë i nevojiten njohuri dhe ndihma nga popujt e mëdhenj të globit. Ajo ka mbetur për një kohë shumë të gjatë në errësirë, pasi

duart e fqinjëve të saj e kanë mbërthyer për fyti duke i [42]zënë frymën. Nuk është habi që ajo ta kërkojë rrugën e zhvillimit të saj kombëtar nën një mbikqyrje dhe përkujdesje të ngjashme me atë të një fëmije; dhe ajo është një fëmijë i shëndetshëm, që premton një pjekuri të fortë e të guximshme, sapo të gjendet për të një mbrojtës i përshtatshëm dhe i pranueshëm prej saj."[43]

A nuk është sot, pikërisht, populli dhe atdheu i gjeneralit Scriven dhe i Presidentit Wilson në krah të popullit shqiptar në rrugën e realizimit të aspiratave të tij? A nuk është sot populli shqiptar 'foshnja më e shëndetshme', populli me lindshmërinë më të lartë në Evropë dhe i gatshëm që të ballafaqohet me sfidat e kohës? A nuk ka kaluar ky popull tërë kalvarin e vuajtjeve, të shtypjes, genocidit, dëbimit masiv, shfarosjes, coptimit të trojeve, ndarjes shekullore dhe, prapëseprapë, qëndron i palëkundur, vital, krenar, i papërkulur në trojet e veta stërgjyshore?

Fjalët e gjeneralit amerikan janë thënë pak kohë para se vetë Presidenti amerikan i asaj kohe, Wilson, të deklaronte botërisht përpara se të nisej për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes në Paris:

"Unë do të kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes[44] dhe atë zë do ta përdor në emër të Shqipërisë."[30]

[42] Joseph S. Raucek, *'Politics of the Balkans'* (New York, McGrew-Hill,1939) Kapitulli V "*Albania*", faqe 84-88

[43] National Geographic, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918, faqe 113.

[44] Fjala është për Konferencën e Versajës në Paris, të mbajtur nga data 18 janar 1919 deri në datën 21 janar 1921, me disa ndërprerje. Aty Shqipëria ishte një prej çështjeve të diskutuara gjerësisht për shkak të lakmive të fqinjëve për të shkëputur territore të tjera nga trupi i saj edhe ashtu i gjymtuar nga Konferencat e mëparshme si ajo e Ambasadorëve e vitit 1913. [30] Edwin E. Jacques, '*The Albanians*', botim i Shtëpisë Botuese McFarland, 1995, Kreu, 'Ndërhyrja e Presidentit Amerikan' Woodrow Wilson, faqe 365.

… Dyrrahiumi i ditëve kur lulëzonte Roma. Shumë vogëlushë ilirë, të cilët i shihnin legjionet e kësaj të fundit tek marshonin, u rritën për t'i shërbyer Gardës Pretoriane. Njërit prej këtyre të rinjve vendas, i quajtur Deocletian, as që i shkonte mendja se një ditë do të vishte vellon e purpurt perandorake…për të ardhur pastaj te një tjetër embrion perandorësh ilirë, Konstandini i vogël, i parathënë për t'u quajtur 'i madh', i cili mund të ketë thirrur "Ja tek erdhën" kur legjionet u turrën përmes qytetit të tij, Nishit, që tani gjendet nën Serbi….[45]

[45] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 157.

II

FIGURAT E SHQUARA TË KOMBIT SHQIPTAR

Një ndër vlerat më të mëdha për Shqipërinë dhe për shqiptarët, që lexuesi do të gjejë në botimet e revistës *National Geographic*, do të jetë përshkrimi që u ka bërë ajo figurave të ndritura të kombit tonë. Atje janë trajtuar, njëri pas tjetrit, Pirroja i Epirit, perandorët e lashtë romakë e bizantinë me origjinë ilire e deri te Nënë Tereza.

Melvile Chater vjen në përfundimin: Tre emra ngrihen mbi gjithë të tjerët në historinë e Shqipërisë: Ata janë:

- Pirroja, i vlerësuar prej Hanibalit si i pari midis luftëtarëve të kohës së tij dhe komandanti, i cili, për gjashtë vjet me radhë, i kalli datën si Romës, ashtu edhe Kartagjenës;
- Skënderbeu, heroi kombëtar dhe, për një kohë, ai që i mposhti turqit, dhe
- Ali Pashai, i mbiquajtur Luani i Tepelenës, një prej figurave më piktoreske dhe më të shquara të kohëve moderne."

Ja si i përshkruan ilirët e mëdhenj, Gardën Pretoriane, Diocletiani dhe Konstandinin:

"… Dyrrahiumi i ditëve kur lulëzonte Roma. Shumë vogëlushë ilirë, të cilët i shihnin legjionet e kësaj të fundit tek marshonin, u rritën për t'i shërbyer Gardës Pretoriane. Njërit prej këtyre të rinjve

vendas, i quajtur Deocletian, as që i shkonte mendja se një ditë do të vishte vellon e purpurt perandorake… për të ardhur pastaj te një tjetër embrion perandorësh ilirë, Konstandini i vogël, i parathënë për t'u

quajtur *i madh*, i cili mund të ketë thirrur: *"*Ja tek erdhën kur legjionet u turrën përmes qytetit të tij, Nishit, që tani gjendet nën Serbi…."[46]

Më poshtë lexuesi gjen një nga konstatimet më të habitshme për shqiptarët dhe një dukuri që, sado e njohur si dobësi e shqiptarëve, ka edhe të mirën e saj – mbijetesën kolektive nëpërmjet një cilësie jashtëzakonisht të spikatur individuale:

"Jo më pak për t'u vlerësuar se atdhetarizmi i ri shqiptar, është fakti se shqiptari është pjesëtari më individualist i racës njerëzore. Po të mos ishte kështu, ai prej motesh do ta kishte humbur individualitetin e tij midis popujve të ndryshëm, të cilët në rrjedhat e historisë u kanë rënë maleve shqiptare kryq e tërthor. Përkundër sulmeve të furishme e të vazhdueshme të romakëve, gotëve, serbëve dhe bullgarëve dhe 350 vjetëve sundim të turqve, shqiptari e ka ruajtur të pathyeshëm individualitetin e tij."[47]

Ndërsa për *Skënderbeun* revista jep vlerësimin e mëposhtëm:

"Vetëm një hero kombëtar, i aftë për t'i bashkuar ata, ka dalë prej shqiptarëve – Skënderbeu. Ai vdiq në vitin 1468 pasi fitoi plot 21 beteja të ndërsyera nga turqit. Vdekja e tij e la Shqipërinë pa udhëheqës, dhe shqiptarët trima, të cilët nuk njohin besnikëri ose ligj përtej atij të familjes dhe të fisit, ranë nën pushtetin e Muhametit të Dytë, pushtuesit të Konstandinopojës. Muhameti mundi t'i shtypte por jo t'i nënshtronte shqiptarët; as sulltanët e mëvonshëm nuk ia kanë dalë që ta plotësojnë këtë dëshirë. Më e mira që ata mundën të bënin, ishte t'u shkonin pas qejfit dhe, deri në ditën e fundit të tiranisë së Abdyl Hamitit, shqiptarët u trajtuan si njerëz të veçantë."[48]

[46] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdom'*, shkruar nga Melvine Chater, shkurt 1931, faqe 157.

[47] *Theron J. Damon,* National Geographic, nëntor 1912, faqe 1093.

[48] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdon'*, shkurt 1931, faqe 162.

Fotografi nga Frederik Mur (1908)
Kryengritësit shqiptarë në veri të vendit

Duke na dhënë më pas një përshkrim si ky:

"Kalaja e rrënuar e Krujës shërben më mirë se çfarëdo lloj monumenti tjetër për të përjetësuar kujtesën e Gjergj Kastriotit, i njohur me adhurim nga çdo shqiptar si Skënderbej. Në fillim të shekullit XV, ai bashkë me tre vëllezërit, u mor peng në Konstandinopojë. Gjergji, si i ri që ishte, u mbajt me kujdes nga sulltani. Në rrjedhën e viteve ai e riemëroi atë si Iskander Bej, i dha komandën e një kavalerie dhe Skënderbeu u bë një prej oficerëve më të shkëlqyer të sunduesit. Por, siç provuan ngjarjet e mëvonshme, në zemër ai mbeti shqiptar.

Rreth tridhjetë vjet më vonë, kur turqit u thyen prej hungarezëve, Skënderbeu, në mënyrë të papritur, marshoi drejt Krujës, e përzuri garnizonin turk, mori kështjellën nën kontroll dhe i ktheu dinjitetin Shqipërisë".

Gjatë 24 vjetëve të udhëheqjes së tij, ai u bëri ballë fushatave ushtarake turke, të cilat, në raste të veçanta, numëronin deri në 200.000 ushtarë, dhe përdornin artileri që hidhte predha guri deri në disa qindra kilogram. E, megjithatë, ai mbeti i pamposhtur prej ushtrisë turke. Kur Skënderbeu vdiq, në moshën 64-vjeçare, ai la prapa një

famë, e cila edhe sot e kësaj dite bën krenar çdo shqiptar. Turqit i kthyen kockat e tij në stoli guximdhënëse.

E një bukurie të vërtetë është balada e vjetër, e cila tregon se si vdekja e detyroi atë që ta linte betejën ne mes.

Gjergji i thotë të birit:

"Sot fati e ka sjellë jetën time në fund të saj. E pres pa m'u trembur syri thirrjen e fatit tim, por dua të të them dy fjalë në këtë orë të rëndë të jetës sime: Bëj gati kalin tim, shpalos flamurin shqiptar, ngule shpatën time në dhe! Kështu, kur era e veriut të fryjë me furi, kali i vrapit do të hingëllijë, shpata do të vringëllijë dhe armiku, me t'i parë dhe me t'i dëgjuar ato, do t'ia mbathë me të katra nga frika e vdekjes!"[49]

"Bëmat e Skënderbeut jetojnë në veprën e Longfellout, 'Përralla nga bujtina buzë rrugës', ndërsa figura e këtij luftëtari shqiptar, sikundër më vonë edhe ajo e Ali Pashait, shkëlqen në faqet e Child Harold të Bajronit, që e vizitoi atë në vitin 1810 pasi e kishte shpallur veten 'Sundimtar të Shqipërisë, të Epirit dhe të Thesalisë'.

"Ali Pashë Tepelena i vuri qëllim vetes dhe, thuajse, ia arriti kësaj, t'i çlironte plotësisht këto provinca; por në një orë të ligë, i mashtruar prej premtimeve për paprekshmëri, ai u dorëzua. Premtim ogurzi! E megjithëse koka e njeriut që i solli aq trazira perandorisë, stolisi Portën e Seragalios,[50] veprat e tij mbetën gjallë, duke frymëzuar Greqinë, e lidhur këmbë e duar me zinxhirë nga osmanët, që të ngrihej e të luftonte për liri."[51]

Në shkrimet e saj të njëpasnjëshme revista i jep një vend të veçantë edhe dy figurave të tjera shqiptare, që u bënë çlirimtarët dhe themeluesit e dy prej shteteve më të forta të Mesdheut, Greqisë dhe Egjiptit.

Për këtë Profesor Grosvenor në shkrimin *Racat e Evropës* i cilëson Marko Boçarin dhe Mehmet Ali Pashanë e Kavallës si më poshtë:

[49] Po aty, faqe 163.

[50] *Porta e Seragalios,* Porta e Lartë në Stamboll.

[51] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater shkurt 1931, faqe 163.

"... Marko Boçari, për të cilin shkruante natën në tendën e tij Fitz-Greene Halleck,[52] ishte, gjithashtu, shqiptar. I tillë ishte Muhamet Ali Pashai, figura myslimane më e shquar e shekullit të nëntëmbëdhjetë."[53]

Ky popull, që u kishte dhënë grekëve udhëheqësin e revolucionit të tyre, që i çliroi ata nga zgjedha disashekullore otomane, ndërsa egjiptianëve udhëheqësin që themeloi dinastinë mbretërore midis të cilëve shkëlqeu Ibrahim Pashai, ndërtuesi i Kanalit të Suezit, një mbretëri që zgjati deri në vitin 1953 me rrëzimin nga froni të Mbretit Farruk, tani ka provuar, sipas Profosor Grosvenor:

"Mjeshtëria evropiane për të bërë shtete nuk e ka parë kurrë ndonjëherë veten në pozita më qesharake se kur e caktoi të ndruajturin Princ Vidin si mbret të shqiptarëve në vitin 1913."[9]

Më tej, për Marko Boçarin, revista sjell edhe këtë vlerësim:

> "Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë shqiptarët iu bashkuan fqinjëve të tyre jugorë, grekëve, duke u bërë shtylla kurrizore e luftës për pavarësinë e Greqisë. Të gjithë të afërmit e Marko Boçarit, heroit shqiptar që udhëhoqi luftën për pavarësinë e Greqisë, emigruan për në Qefalonia në brigjet e Greqisë, por rreth dy milionë shqiptarë të tjerë, më me pak fat, mbetën nën sundimin turk."[54]

Në radhën e figurave të shquara që ka nxjerrë populli ynë, revista *National Geographic* nuk harron të përmendë edhe figurat e shquara që kanë dalë nga arbëreshët e Italisë, siç do të shohim më poshtë:

"Në rrjedhë të shekujve, arbëreshët i dhanë Italisë një Papë,[55] tre

[52] *Fitz- Greene Halleck*, 1790–1867, poet amerikan, bashkautor me Jozef Rodman Drakei i veprës satirike 'Letrat e Grindavecit', pjesa më e madhe e së cilës u botua nga *New York Evening Post* në vitin 1819. Në të njëjtin vit ai publikoi satirën e tij të gjatë *'Shakaja'* (1819) në stilin e Bepos së Bajronit. Ai shkroi poemën '*Marko Boçari*', e cila ishte aq popullore, sa të recitohej lehtësisht me rimë.

[53] National Geographic, "*Races of Europe"*, dhjetor 1918, faqe 477. [9] Po aty.

[54] *Theron J. Damon,* National Geographic, nëntor 1912, faqe 1090.

[55] Papa Klementi XI, *Giovani Francesko ALBANI* (1649 – 1721), u zgjodh Papë i Romës në 23 nëntor1700. Trupi i tij prehet në Kishën e Shën Pjetrit në Romë. Letrat dhe veprat e tij qenë mbledhur dhe botuar prej nipit të tij *Kardinalit Annibale Albani* (2 vëllime, Romë 1722-24).

kardinalë[12] dhe kryeministrin dhe burrin e shtetit, Francesko Krispi.[13] Ata e ruajtën kulturën shqiptare gjatë sundimit turk dhe studiuesit e tyre qenë midis të parëve që e kodifikuan dhe e shkruan gjuhën shqipe."[14]

Dhe më pas revista ndalet, në mënyrë të veçantë, te Francesko Krispi:

"Krispi, ky burrë shteti italian, ishte një shqiptar i vërtetë. Ai ishte pjesëtar i kolonisë së gjerë të shqiptarëve të Siçilisë dhe të Italisë së Jugut, stërgjyshërit e të cilëve, në një numër jo më pak se njëqind mijë, emigruan nga Shqipëria kur turqit e pushtuan atdheun e tyre."[15]

Dhe së fundi, Priit Vesilind përmend figurën më të ndritur njerëzore të shekullit XX, Nënë Terezën:

"Nënë Tereza e Kalkutës, për shembull, ishte bijë e një familjeje shqiptare të krishterë nga Shkupi, e njohur me emrin Agnes Gonxhe Bojaxhi."[16]

---

e tij qenë mbledhur dhe botuar prej nipit të tij *Kardinalit Annibale Albani* (2 vëllime, Romë 1722-24).

[12] Në të vërtetë arbëreshët i dhanë Papatit jo tre kardinalë, siç vëren autori këtu por gjashtë të tillë, pa llogaritur Imzot Mikel Koliqin e kohëve tona. Ata janë, *Gjon Jeronim Albani*, (1509-1591) i cili u bë kardinal në vitin 1570 dhe konkurroi në dy konklava për Papë të Romës. Ai është autor i librit '*Dë Cardinalatu, dë potestate papa*'; Më pas vjen *Horac Albani* (1576-1653) diplomat i njohur i Vatikanit dhe ndihmës i Papa Urbanit VIII ; për të vijuar me *Hanibal Albanin* (1682-1751), i shpallur kardinal në vitin 1711; *Aleksandër Albani* (1692-1779) u shpall kardinal në vitin 1721. A u bë protektor i Mbretërisë së Sardenjës; *Gjon Francesk Albani* (1720-1803), i shpallur kardinal në vitin 1753 dhe *Zef Albani* (17501834) po ashtu, i shpallur kardinal në vitin 1801. Ky i fundit u bë protektor i Perandorisë së Austrisë.

[13] *Francesko Krispi* (1819 - 1901), arbëresh, politikan i shquar dhe kryeministër i Italisë në vitet 1887-1891 dhe 1893-1896.

[14] National Geographic Magazine, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000, faqe 62.

[15] Po aty, faqe 63.

[16] Po aty, faqe 68.

Shqiptarët etnikë, në shumicë myslimane, me rritjen më të madhe të popullsisë në Evropë, përbëjnë 90 përqind të banorëve të Kosovës. Ata pohojnë se rrjedhin nga ilirët, atdheu i të cilëve ishte aty shekuj më parë se serbët dhe sllavët e tjerë të dirgjeshin që nga veriu.

III

SHQIPTARËT NË TROJET E VETA ETNIKE NË KOSOVË DHE NË MAQEDONI

Me sa duket, çështja e Kosovës nuk ka zënë vendin e merituar në faqet e revistës *National Geographic*, të paktën deri në vitin 1990. Kjo mund të ketë ardhur nga fakti që, pas vitit 1913, Kosova nuk është parë si pjesë e Shqipërisë, por e Jugosllavisë. Megjithatë, gjurmë të udhëtarëve të revistës janë gjetur në vitet 1918, 1920 dhe, veçanërisht, në vitin 1990 dhe 2000. Kosova fillon dhe paraqitet seriozisht në shkrimin e vitit 1990 'Jugosllavia, një shtëpi shumë e përçarë', shkruar nga *Kenneth C. Danforth,* ku autori ka dhënë një përkufizim tejet bindës për atë që po ndodhte në atë vend në atë kohë dhe për pasojat që do të kishin shqiptarët prej asaj politike. Lexuesi, ndoshta, do ta gjejë thelbin e tërë tragjedisë që e priste Kosovën, në këto fjalë:

> "Kenneth Anderson është hetues në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, një organizatë që vëzhgon përmbushjen e parimeve të marrëveshjes së Helsinkit të vitit 1975. Raportet e tij më të fundit e përshkruajnë gjendjen në Kosovë si "shembull i frikshëm i fuqisë së një diktature njëpartiake që ka peshën e plotë të një shteti policor të kontrolluar prej një pakice etnike të ndërsyer kundër një tjetre…"[56]

Ndonëse ky shkrim i është kushtuar Jugosllavisë, pjesa më e madhe e

[56] National Geographic Magazine, '*Yugoslavia A House Much Divided*', shkruar nga *Keneth C. Dauforth,* gusht 1990.

tij merret me Kosovën. Shkrimi fillon me një pamje të zymtë të gjendjes në një vend ku sorrat e zeza ende fluturojnë mbi qiellin e Prishtinës dhe flenë vetëm atëherë kur bie ora policore.



Fotografi nga Hans Hildenbrans (1930)
Dy djem në Prishtinë

Ja si e fillon tregimin e tij Dauforth:

"Sorrat e zeza vërshuan përmbi korzë[57] në Prishtinë, kryeqyteti i Krahinës së Kosovës në Jugosllavi. Duke klithur e duke kërkëllitur mbi rrugën kryesore, ato vërshuan poshtë si një masë e zezë e lëvizshme, për të fluturuar përsëri lart në drejtim të qiellit që po përskuqej, e pastaj duke bërë një lëvizje rrotulluese e duke zbritur përsëri si shtëllungë e zezë lëvizëse. Atyre iu desh një orë valëvitjesh të tilla deri sa u ulën sipër degëve të thata të pemëve; pas kësaj, ato i palosën flatrat dhe u qetësuan në errësirën që po pllakoste vendin bashkë me orën policore që po afrohej të hynte në fuqi.

Korza, ose xhiroja e darkës, është shëtitja çlodhëse që bëjnë njerëzit mbrëmjeve duke qeshur, duke, biseduar, pse jo edhe duke flirtuar – në çdo qytet të këtij vendi ballkanik. Por Prishtina ka tani

[57] *'Korza'* në Prishtinë dhe qytete të tjera në Kosovë është rruga kryesore e qytetit, në të cilën në orët e mbrëmjes, vërshon, thuajse i tërë qyteti për të shëtitur dhe për të takuar njëri-tjetrin. Sot 'korza' në Prishtinë mban emrin 'Bulevardi Nënë Tereza'.

një çehre të ngrysur. Hareja e ka braktisur atë. Orkestrat, që më parë luanin muzikë, i kanë mbyllur veglat. Tani dëgjohet vetëm kërkëllima e sorrave.

Njerëzit ecin me hap të përshpejtuar për të kaluar semaforët dhe, nëse shkëmbejnë ndonjë fjalë, atë e bëjnë duke murmuritur plot frikë se mos dëgjohen nga pas, sepse në çdo rrugë ata ndeshin në makinat e policisë dhe në mjetet e tyre të blinduara, në policë që mbajnë helmeta në kokë dhe gjoksore antiplumb, të armatosur deri në dhëmbë, madje, edhe me mitralozë e automatikë që i nxjerrin tytat prej kullave të hekurta. Këta qytetarë të Kosovës, të kësaj krahine të vetëqeverisur të Republikës së Serbisë mund të qëllohen dhe të burgosen, pa një pa dy, edhe vetëm pse thonë fjalët: *Kosova Republikë*.

Në fshatin Studençane, 20 Shkurt 1999
Serbët në patrullim

Serbia ua rrënoi autonominë me tanke, trupa ushtarake, gaz lotsjellës dhe me terror. Megjithëse shumë serbë nuk jetojnë në Kosovë, ata e konsiderojnë atë zemrën e shenjtë të Serbisë mesjetare. Ata nuk mund t'i bëjnë ballë idesë se një ditë mund ta humbin për shkak të një popullsie tjetër josllave, joortodokse, të cilën e quajnë me përbuzje "një racë e fëlliqur që shtohet pa mbarim".

Reçak, Kosovë, 11 shkurt 1999
Në funeralin e shqiptarëve të vrarë prej forcave serbe

Më tej autori u drejtohet statistikave dhe historisë për Kosovën:

"Shqiptarët etnikë, shumica myslimanë, me rritjen më të madhe të popullsisë në Evropë, përbëjnë 90 përqind të banorëve të Kosovës. Ata pohojnë se rrjedhin nga ilirët, atdheu i të cilëve ishte aty shekuj më parë se serbët dhe sllavët e tjerë të dirgjeshin aty që nga veriu."

"Duke e gjetur fjalën *krahinë autonome* një fjalë të pakuptimtë, shqiptarët e Kosovës e ngritën zërin për republikën e tyre brenda Federatës Jugosllave, e cila do të ishte e barabartë me Serbinë. Ky ballafaqim solli si pasojë dhunën. Shqiptarët kryengritës, thuhej, se i kishin gjuajtur me gurë dhe rrahur serbët e paktë në numër. Shteti, duke reaguar me forcë brutale, kishte qëlluar mbi shqiptarët kosovarë, duke vrarë, që në vitin e parë, më shumë se 35 prej tyre.

Disa prej tyre ishin fëmijë dhe përndiqeshin vetëm pse bënin me gishta shenjën *'V'* për fitore ose pse thërrisnin *Lavdi* ose *Demokraci*, dëgjova të thuhej në një kafe anë rrugës.

Policia u shkon njerëzve nëpër shtëpi, i rreh, i vret dhe pastaj i quan *terroristë dhe separatistë,* gjë që përbën edhe një akuzë tjetër.

Ora policore binte në orën nëntë. Unë isha kështilluar që të futesha brenda derës përpara orës tetë. Pas kësaj, çdokush shihej me

dyshim. Qëndruam deri 15 minuta përpara se të shpallej shtetrrethimi. Megjithatë, në rrugë isha vetëm unë, milicia e zymtë, si dhe njeriu i cili dukej se hynte e dilte nga hoteli sa herë që edhe unë e bëja këtë. Gjithkush tjetër ia kishte mbathur për në shtëpi. Edhe sorrat më në fund kishin rënë në gjumë."

Foto nga Mal Berisha, qershor 2006
Gazemestan, Kosovë, vendi ku mendohet se ra Princi Llazar në luftën e Kosovës, 28 Qershor, 1389

Më poshtë Kenneth C. Danforth shkon vetë drejt e në vendin, ku mbi gjashtëqind vjet më parë, u zhvillua Lufta e Kosovës. Është për t'u shënuar se që në fillim autori vjen në një përfundim shkencor kur deklaron:

30 mars 1999: në kufirin midis Kosovës dhe Maqedonisë

Kjo grua nuk ka më forcë të ecë. Sapo arrin në kufirin me Maqedoninë atë e lënë forcat, ndërkohë që fëmijët dhe burri u kërkojnë rojeve kufitare maqedone t'i ndihmojnë. Pas tri ditësh kjo familje gjeti strehë si refugjate në Maqedoni. Shumica e kosovarëve tani janë kthyer në vendin e tyre, ku trupat e NATO-s ruajnë paqen e tyre të brishtë.

"Këtu një aleancë e krishterë u përpoq të ndalonte përparimin drejt veriut të pushtuesve turq osmanë."

Ky është edhe pohimi më shkencor, më i vërtetë që një udhëtar i revistës mund të sillte në faqet e saj, kur dihet sa spekullime ka rreth pjesëmarrjes së popujve të tjerë ballkanikë në këtë betejë. Ai niset dhe shkon drejt e në vendin e betejës dhe na thotë:

"…për të kuptuar emocionet që trazojnë Kosovën, duhet të kthehemi te viti 1389 në Betejën e Fushës së Kosovës – Fushës së mëllinjave – një prej betejave më të mëdha që është zhvilluar ndonjëherë në Evropën mesjetare. Që nga Prishtina shkova atje me makinë. Tymi i dendur që dilte nga termocentrali i qymyrit, mbushte ajrin përmbi fushat e ngrira. Bloza e zezë përzihej me dëborën.

Rrugët e Gjakovës, një herë e një kohë të mbushura me shqiptarë, tani janë rrënuar prej forcave serbe. Afër dy milionë shqiptarë jetonin në Kosovë para luftës, me një nivel jetese më të mirë se ai i vëllezërve të tyre në Shqipëri.

Humbjet, në të dyja anët, patën qenë të tmerrshme. Legjenda thotë se sorrat shqyen, për javë të tëra, kërmat e trupave të vdekur. Beteja shënoi fundin e një perandorie serbe që, një herë e një kohë, kishte qenë e fuqishme. Megjithatë, turqit i prisnin beteja të tjera, edhe më të egra, ndaj ata nuk arritën ta merrnin atë tokë edhe për 70 vjet të tjera.

Të dy udhëheqësit e ushtrive mbetën të vrarë. Dy monumete krejtësisht të ndryshme nga njëri-tjetri qëndrojnë afër një katundthi të quajtur Gazimestan. Një man shumëshekullor i bën hije teqesë së ngritur aty ku vdiq Sulltan Murati I, në çadrën e tij.

Askush nuk e di se ku ra princi serb Llazar në atë betejë. Megjithatë një masiv betoni dhe guri është ngritur për të përkujtuar atë, si dhe *heronjtë e tjerë të Kosovës*. Në verën e vitit 1989, me rastin e 600 vjetorit të betejës, një milion serbë erdhën te maja e asaj kodre.

Foto nga Mal Berisha, qershor 2006
Mazgit, Kosovë, ku është ngritur Tyrbja e Sulltan Muratit, vendi ku mendohet se u vra në çadrën e tij Sulltani Turk nga dora e Milosh Kopiliqit.

"Ata erdhën aty për të zhvatur tani një fitore prej asaj humbjeje të vjetër, duke pretenduar se një kartë e sovranitetit të përjetshëm mbi këtë vend ishte shkruar në vetë gjakun e serbëve dhe tani po shpërndahej këtu. Erdhën që të festonin masat e rrepta nën të cilat Serbia po çmontonte gjithçka që kishte mbetur nga autonomia e Kosovës."

Pasi ka paraqitur të kaluarën dhe të tashmen e atij vendi ku u zhvillua beteja, autori na thotë: "Shqiptarët e Kosovës ndenjën larg këtij festimi të humbjes së pësuar 600 vjet më parë". Ja si e përshkruan ai monumentin dhe, më pas, tërë atmosferën që e shoqëronte Kosovën e fillimit të asaj dekade:

"Rrënimet e bëra nga serbët nuk do të riparohen lehtë. Do të duhen vite që shqiptarët të rindërtojnë vendin e tyre, i cili, tani për tani, është, thuajse, i tëri në këtë gjendje."

"Tani, muaj më vonë, isha i vetëm te monumenti. Një erë që të priste si thikë mbështillte dëborën rreth e rreth atij vendi dhe unë ndieja se po m'i therte sytë. Përtej asaj pjese të pastruar, të rrethuar

prej shkurresh, qëndronte një kosh plastik plehrash i mbështjellë prej mbeturinash të lëna pas nga pjesëmarrësit e festës.

Rrugës në kthim për në Prishtinë më ndaloi milicia. Aty tre autobusë të mëdhenj, plot e përplot me ushtarë, dukeshin sikur kishin ngritur një kompleks ushtarak. Tanket ishin parkuar aty pranë, në pritje për të ndërhyrë në çdo rast nëse dikush ngrihej në Prishtinë, e cila nuk ishte as pesë minuta larg.

Reçak, shkurt 1999.
Një fshat i zhytur në mjerim si ky fëmijë

Autoritetet ushtarake e kishin mbyllur aeroportin e Prishtinës, kështu që për të arritur në Prishtinë u detyrova të fluturoja një ditë më parë nëpër Shkup, kryeqyteti i Republikës fqinje të Maqedonisë. Në agjencinë e makinave me qira këmbëngula që të merrja një makinë me targa 'LJ', që ishin shenjat e targave të Ljubljanës, kryeqytetit të Sllovenisë dhe jo ato të Beogradit, kryeqytetit të Serbisë dhe të Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, që kur shkela aty, fillova të respektoja këshillat që më ishin dhënë për udhëtimin tim në Kosovë. Këshilla tjetër që më duhej ta mbaja mend në çdo çast ishte:

Nëse shihja ndonjë turmë shqiptarësh, duhej të ngrija gishtat lart dhe të bëja shenjën 'V' për fitore.

Shpërngulje masive, 1999

Çfarë vendi është ky, ku njeriu duhet të rrijë gati që, sapo të marrë sinjalin, t'i lutet zotit ta ndihmojë për të shpëtuar lëkurën? Një vend ku duhet të sigurohesh se mos makina që nget, mban targën e një qyteti të papërshtatshëm të të njëjtit vend.

Se sa larg ka shkuar puna në Jugosllavi, autori na e shpjegon më poshtë kur ndalet te përçarjet e mëdha që ekzistojnë:

"Kjo është Jugosllavia: 24 milionë njerëz nga 24 grupe etnike dhe tri fe kryesore, të cilët shkruajnë edhe në alfabetin latin edhe në atë cirilik, të ndarë në gjashtë republika – që shprehin interesa tërësisht të kundërta, ku secila vjell sa të mundet më shumë helmin e urrejtjes kundër tjetrës. Lufta civile është tema më e lakuar në çdo republikë – sa në Serbi, aq edhe në Kroaci, Slloveni, Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni dhe në Mal të Zi. Sllovenia dhe Kroacia, republikat më të kamura, kërcënojnë të shkëputen, por frikësohen nga ndërhyrja e ushtrisë nëse përpiqen ta bëjnë këtë.

Gjeografikisht, Jugosllavia është, thuajse, po aq e larmishme sa vetë Evropa. Në fushat e Vojvodinës erërat valëvitin grunajat e arta të fushave që lagen prej lumenjve Sava dhe Danub. Në perëndim, brigjet e kristalta të Adriatikut lagen në një vijë bregdetare prej 6.115 kilometrash, ku përfshihen edhe 725 ishuj. Por, prapëseprapë, 70 përqind e sipërfaqes së saj përbëhet prej masivesh malore. Alpet Dinarike

shtrihen në drejtimin veri – jug me tërë ashpërsinë e tyre, deri sa arrijnë në Mal të Zi, në një reliev malor majash e thepash të dhëmbëzuar, që krijojnë forma të jashtëzakonshme. Për të kaluar nga njëra anë te tjetra, ka qenë tmerrësisht e vështirë. Ato paraqesin një vijë natyrore me po ato vështirësi që paraqet udhëtimi prej veriut dhe perëndimit katolik, ku shihet Austria dhe Italia, për te jugu ortodoks e mysliman, që kufizohet me Bullgarinë, Greqinë dhe Shqipërinë."



Fotografi e vitit 1999
Aleatja e Ushtrisë Jugosllave

Aleatja e ushtrisë jugosllave, policia serbe në Kosovë, nuk i do gazetarët. Ishte e vështirë të afroheshe, qoftë edhe për të marrë një fotografi të tyre.

"Për ne mendohet se jemi të gjithë jugosllavë", - thotë një avokat kroat nga porti i Splitit. – "Por, sapo të na gërvishtësh sado pak, del menjëherë se jemi ose serb, ose kroat, ose diçka tjetër. Dhe nuk keni pse lodheni shumë duke gërvishtur thellë".

"Kam udhëtuar në Jugosllavi në të gjitha stinët. Kam parë çdo pjesë të vendit por, sa më shumë flas me njerëzit, aq më shumë më vështirësohet mundësia për të pasur një ide të qartë se çfarë është një jugosllav. Unë kam mësuar t'i marr ata siç duan ata vetë, që do të thotë, çfarë familjeje etnike i përkasin, por ende nuk di se cilit vendi i

takojnë. Kodet diplomatike që e lejojnë Jugosllavinë të shkojë mirë me pjesën tjetër të botës, brenda vetë Jugosllavisë nuk zbatohen.

Jugosllavia nën Titon përqafoi perestrojkën dhe glasnostin shumë kohë më parë sesa ndokush të kishte dëgjuar jashtë BRSS- së për Mikael Gorbachov. Duke u shkëputur prej bllokut lindor të Stalinit në vitin 1948, Jugosllavia u bë vendi komunist më i përparuar. Po tani? Tani është në luftë.

Për dekada të tëra perëndimi e mbështeti Jugosllavinë si një mburojë kundër shtrirjes së ndikimit sovjetik. Ekonomia mëkohej me kredi me interesa të ulëta. Jugosllavët kishin mjaft para për pushime. Vendi i tyre ishte model për kombet e paangazhuara në Afrikë, në Azi dhe në Amerikën Latine.

Sot Jugosllavia shpenzon 80 përqind të pagave të veta – e cila është një mesatare prej 212 dollarësh amerikanë në muaj – për ushqime dhe për shtëpi. Niveli i jetesës ka rënë tek ai i viteve 1960. Papunësia arrin deri në 20 përqind. Qeveria noton në një borxh prej 16 miliardë dollarësh. Udhëheqësit grinden për rënien e prodhimit, ndërkohë që dyert e zyrave të shtetit përplasen me zemërim prej nëpunësve që në orën 2 pasdite. Studentët thonë se këtu nuk ka të ardhme.

Çdo grup etnik ia hedh fajin një grupi tjetër për problemet me të cilat ballafaqohet Jugosllavia. Secila palë i jep të drejtë vetes që të urrejë, sikur kjo të ishte dhuratë e qëmotshme si vetë zjarri. Ideali jugosllav – që popuj të cilët historikisht janë grindur me njëri-tjetrin, duke përfshirë sllavë e josllavë, do të mund të jetonin bashkë në paqe pas shekujsh gjakderdhjeje - ka përfunduar në një furtunë të verbër nacionaliste."

Nëpërmjet shkrimit të Kenneth C. Danforth revista jep një portretizim të frikshëm të Slobodan Milosheviçit të asaj kohe:

"Pas mëse 40 vjetëve që kur Jugosllavia ia kishte dalë t'u vinte fre pasioneve të saj fisnore, një ish drejtor banke u shfaq në skenën politike për t'i ripërtërirë po ato pasione dhe për të vënë në shërbim të vet ndjenjat më të errëta nacionaliste: *Slobodan Milosevic, Presidenti i Serbisë, i dalë nga skutat e diktaturës, e ka pastruar partinë dhe e ka bërë çështjen më jetike të saj 'persekutimin' e serbëve në Kosovë.*"

Ja si e përshkruan rritjen e kultit të këtij diktatori:

"Dritaret e dyqaneve të Beogradit mbajnë portretin e Milosheviçit. Fytyra e tij e rëndë shkëlqen në ekranet e televizionit aq sa edhe në dyqanet e këpucëve të grave. Miloshevic po e ndërton kultin e personalitetit dhe të popullaritetit të tij bazuar jo në përmirësimin e nivelit të jetesës, të kujdesit shëndetsor ose të arsimimit, por në goditjen e ashpër ndaj shqiptarëve dhe në kërcënimin për të kolonizuar Kosovën me prurjen aty të qindra mijëra ardhacakëve të tjerë serbë.

Në Jugosllavi, ku ka një traditë gojore të fuqishme, e vërteta nuk është ajo që haset në jetë, por ajo që njerëzit mendojnë se është. Në Beograd, ku ekziston një shtyp rreptësisht i kontrolluar dhe ku nuk ka asnjë zë të lirë që të tregojë se shqiptarët nuk janë ata që i përdhunojnë gratë serbe çdo javë, njerëzit janë të prirur t'i besojnë edhe të dhënat më të tmerrshme të atij shtypi. Për rrjedhojë, milicia e kontrolluar prej serbëve shfryn me tërë forcën mbi shqiptarët e Kosovës, si një herë e një kohë kur ballkanasit vriteshin pa mëshirë me njëri-tjetrin."[58]

"Ndërkohë që tragjedia po hap perden në Kosovë, republikat e tjera e ndjekin situatën me ankth. Sllovenët dhe kroatët thonë që grushti i përgjakur i Serbisë në Kosovë mund të godasë edhe pjesë të tjera të vendit. Serbët përgjigjen me zemërim se ata kanë të drejta të veçanta historike mbi Kosovën, ku shqiptarët janë shumicë vetëm sepse i kanë trembur serbët dhe që serbët duan vetëm barazi."

Në këtë vend edhe vetë fjala *barazi* është një fjalë e egër. Federata është ndërtuar mbi barazinë midis republikave. Ajo që duan nacionalistët serbë është të zbatohet parimi 'një njeri një votë', i cili është mjaft i drejtë për shumicën e vendeve. Por, përderisa serbët përbëjnë 40 përqind të popullit jugosllav, për shembull, ndërsa sllovenët vetëm 8 përqind, barazi individuale e votuesve do të thotë që Serbia të pushtojë tërë vendin."

Më tej Kenneth C. Danforth i revistës *National Geographic* i referohet historisë dhe pasojave të lëna pas nga pushtimi shumëshekullor osman:

[58] National Geographic Magazine, '*Yugoslavia A House Much Divided*', shkruar nga *Kenneth C.Danforth,* gusht 1990.

"Kur turqit u përzunë me forcë drejt Konstandinopojës, pas humbjesh të mëdha në Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913, sundimi i tyre 500-vjeçar mbi Evropën Juglindore la pas një të çarë të madhe kulturore dhe ekonomike në mbarë territorin e asaj që sot quhet Jugosllavi.

Serbët, që, thuajse, e dyfishuan territorin e tyre, donin, gjithashtu, dhe Bosnjën edhe Hercegovinën. Por Austro-Hungaria e kishte aneksuar atë krahinë që në vitin 1908 dhe e mbante nën pushtim. Kur Arqiduka Franc Ferdinand, trashëgimtari i fronit të Habsburgëve, i vizitoi të nështruarit e vet në kryeqytetin e krahinës, Sarajevë, në vitin 1914, ai u qëllua për vdekje prej një nacionalisti serb të Bosnjës. Austriakët e pushtuan Serbinë: Lufta e Parë Botërore ishte tashmë në udhë e sipër.

Bashkë me luftën që po vazhdonte, po përvijohej edhe mbretëria e serbëve, e kroatëve dhe e sllovenëve. E formuar në vitin 1918, ajo përfshiu edhe Malin e Zi (serbët etnikë), si dhe Bosnjën dhe Hercegovinën (serbët dhe kroatët etnikë).

Ky bashkim kaq i vështirë çoi më në fund deri te një farë sjelljeje më njerëzore. Por shpejt ky vend i ri ra nën pushtetin e mbretit serb Aleksandër, despotizmi i të cilit shpejt i tëhuajti kroatët dhe sllovenët prej serbëve. Megjithatë, e vetmja qëndresë që shfaqën kroatët dhe sllovenët, ishte ndërrimi i emrit të vendit në vitin 1929, duke e quajtur atë Jugosllavi ose 'Toka e sllavëve të Jugut'. Në vitin 1934, një separatist kroat e vrau atë në Marsejë.[4] Mbretëria filloi të shpërbëhej. Por, ja, që një udhëheqës guerril kroat, Josif Broz Tito, doli prej hirit të Luftës së Dytë Botërore, i [59]njohur si Marshall Tito, i vetmi njeri që ka mundur ndonjëherë t'i bënte këta popuj kaq armiq, të tregoheshin të qytetëruar ndaj njëri-tjetrit." Për të davaritur çdo lloj ideje të rreme për karakterin demokratik të regjimit titist, Danforth, nëpërmjet paragrafit të mëposhtëm, na jep thelbin e mënyrës sesi Tito e qeverisi Jugosllavinë:

[59] *Mbreti Aleksandër* i Mbretërisë serbo-kroato-sllovene u vra në Marsejë në një vizitë zyrtare që po i bënte Republikës së Tretë Franceze në datën 9 tetor 1934 nga një nacionalist maqedonas i quajtur Vlada Georgiev, i cili ishte shofer i udhëheqësit të Organizatës së Fshehtë Revolucionare Maqedonase. Vrasja e Aleksandrit shënon edhe të parin rast të një vrasjeje politike të filmuar.

"Vuajtjet dhe fitoret e partizanëve të Titos shënuan kapitullin më heroik të luftës dhe e bënë atë një figurë epike, i cili mund të merrte gjithçka që donte si brenda, ashtu dhe jashtë vendit. Titoja ua mbylli gojën kundërshtarëve duke dërguar, të paktën, 7.000 prej tyre në Goli Otok,[60] një ishull i zhveshur në Detin Adriatik.

Për të parandaluar mbisundimin serb mbi tërë vendin, Titoja i dha autonomi më të madhe Vojvodinës (me popullsinë e saj me shumicë hungareze) dhe Kosovës (me popullsi me shumicë shqiptare). Kjo është arsyeja përse sot serbët ia djegin fotografinë Titos dhe bërtasin që t'i hiqen eshtrat nga memoriali ku gjenden në Beograd."[61]

Mënyra e jetesës së shqiptarëve të Kosovës, si dhe brengat dhe shqetësimet e tyre në atë fillim dekade të viteve nëntëdhjetë janë dhënë thjesht dhe me detaje kuptimplotë. Kenneth C. Danforth shkon në një fshat kosovar dhe shkruan:

"Për të shijuar jetën në fshatin kosovar, një ditë i hoqa këpucët sipër një guri te pragu i derës së një shtëpie dhe hyra në dhomën e pritjes së një familjeje të madhe bujku shqiptar. Ndjeva erën e druve të djegura në një stufë metalike dhe pashë me vëmendje stolitë në nënkresat e leshta të vendosura rreth e rreth murit të dhomës.

Ai fis i madh, me një numër prej 250 anëtarësh, kishte një mulli bloje 170 vjeçar, bagëti e pulari, drithëra plot, grurë e misër, speca dhe lakra. Një prej djemve hodhi një mbulesë të gjerë mbi dysheme dhe pastaj, i ndihmuar prej dy të tjerëve, solli një sofër druri tepër të madhe dhe e vuri mbi të. Ne u ulëm këmbëkryq rreth saj dhe e vendosëm mbulesën përmbi gjunj. Një djalë tjetër, më i ri, solli ca pjata të mëdha dhe sinia të mbushura me mish të pjekur, kos dhe qepë, suxhuk, vezë të ziera, bukë misri të ngrohtë të pjekur si kulaç, djathë të butë e të njomë. Secili prej nesh kishte një lugë gjelle dhe pirun, por jo pjatë.

Djem e burra, 18 meshkuj, u ulëm rreth e rreth sofrës. Asnjë grua. Unë i kisha parë disa gra që lëviznin nga një dhomë në tjetrën, madje,

[60] Goli Otok, burg i tmerrshëm ku kanë kaluar vuajtje të mëdha tërë disidentët e kohës së Titos, shumë prej të cilëve ishin shqiptarë.

[61] National Geographic, '*Yugoslavia A House Much Divided*', shkruar nga *Kenneth C. Danforth,* gusht 1990.

edhe kur bëra një shëtitje në fermën e tyre, por jo në odën e burrave. Sa për djemtë, i pyeta sesa vjeç duhet të jetë një djalë që të ulet me burrat?

"Tradita thotë se djali mund të na bashkohet kur të bëhet dhjetë vjeç," - më tha i zoti asaj shtëpie. - "Por tani kjo po ndryshon në disa shtëpi." Ndërkohë që po flisnim, një fëmijë trevjeçar e hapi derën me forcë dhe u turr që të gjente një vend ku të fshihej pas babait të tij, i cili ishte student i inxhinierisë dhe i binte një çiftelie me dy tela. Pasi dëgjoi një pëshpërimë te veshi, fëmija i ngriti dy gishtat në formë 'V'-je në drejtimin tim."[62]

"Më parë nuk flisnim kurrë për politikë në këtë odë", - thotë njëri prej djemve. "Ne ende nuk u jemi kthyer atyre si duhet, pa do ta shohin. Tani ne, shqiptarët, jemi si macja e zënë ngushtë në një cep. Nuk kemi më çfarë të humbasim."

"Ose do të fitojmë demokracinë ose do të vdesim", - tha një tjetër. - "Ata na akuzojnë se duam të bashkohemi me Shqipërinë. Ky është budallallëk. Ne duam të qëndrojmë në Jugosllavi. Por jo në Serbosllavi? Në Serbosllavi? Kurrë!"

"Shumë kosovarë po bëhen me profesorin 44-vjeçar, Ibrahim Rugova, që t'i udhëheqë për të dalë nga ferri ku i kanë degdisur. Lidhja e tij Demokratike pretendon të ketë 350.000 anëtarë, ndërsa falangat komuniste kanë rënë në 80.000. Ne po shtohemi me qindra çdo ditë" - më tha ai. "Jo vetëm shqiptarët, por edhe turqit, madje edhe serbët."

"Fundi i vetëm i këtij pushtimi serb mund të gjendet nëse e fillojmë dialogun. Por ata thonë se do të merren vetëm me 'përparimtarët'. Për ta 'përparimtarë' janë vetëm ata të vijës staliniste: "Kush nuk pajtohet me ta, nuk është përparimtar."

"Edhe më në jug, në Maqedoni, pashë se kishte trazira etnike. Kjo duket se ishte jashtë natyrës së asaj përzierjeje shumëkombëshe - maqedonë, shqiptarë, turq, romë, bullgarë, grekë – që i pashë të përzier nëpër rrugët e Shkupit të vjetër.

[62] Po aty.

Lindshmëria e lartë në radhët e shqiptarëve tregon se ata do të përbëjnë një të katërtën e popullsisë së Maqedonisë dhe, bashkë me këtë rritje, do të shtohen edhe përplasjet."

KOSOVA PAS LUFTËS SË VITIT 1999

Do të kalonin dhjetë vjet deri kur revista *National Geographic* do ta trajtonte drejtpërsëdrejti çështjen e Kosovës, madje, në një kontekst gjithëkombëtar të lidhur me Shqipërinë, me shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi, të Greqisë dhe të diasporës. Ajo që ka vënë re në Kosovë Keneth C. Danforth në vitin 1990, urrejtja, praglufta civile në Jugosllavi, persekutimi ndaj shqiptarëve, tani kanë marrë trajtat e tyre të plota të luftërave në Slloveni, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe më së fundi në Kosovë. Kosova thuajse është zbrazur nga popullsia shqiptare. Masakra të papara kanë ndodhur, NATO ka ndërhyrë dhe i ka përzënë forcat serbe nga Kosova, qindra mijëra shqiptarë të dëbuar janë kthyer në vatrat e tyre të djegura e të bëra shkrumb e hi. Pikërisht, fill pas kësaj, një udhëtar tjetër i revistës *National Geographic* Priit Vesilind ka ardhur në Kosovë dhe për rreth saj dhe na ka dhënë një shkrim të gjerë e të larmishëm. Ai e fillon tregimin e tij për shqiptarët e Kosovës me një detaj interesant nga një film i Hollivudit.

Konspiratorët lëvizin me shpejtësi nëpër aeroportin e Los Anxhelosit. Një burrë me kapele leshi me ca pika me ngjyra të zbehta mban në dorë një valixhe të mbushur plot e përplot. Gruaja ecën me hapa të mëdhenj pas tij.

Robert De Niro: "Çfarë dini ju për ta?"

Anne Heche: "Asgjë."

Robert De Niro: "Saktë. Ata duken të shkathët, të rezervuar. Dua të them, kush di ndonjë gjë për Shqipërinë?"

Verë e vitit 1999 në Prizren

Jeta kthehet në rrugët e Prizrenit ku fëmijët shqiptarë luajnë me trupat gjermane të KFOR-it. Pas vitesh në izolim, shumë shqiptar e mirëpresin një kontakt të tillë me perendimin. “Ky është një çast historik, është një ëndërr shekullore e shqiptarëve për t’u integruar në Evropë” - thotë një zyrtar qeveritar.



Shqiptarët – një komb i ç'bërë[63]

Në filmin e vitit 1998 "Wag the Dog" Heche është një këshilltare e Shtëpisë së Bardhë, ndërsa Robert De Niro një falsifikator politik. Ata përpiqen t'i mbushin mendjen një producenti të Hollivudit që të krijojë një luftë të rreme midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë, në mënyrë që të heqin vëmendjen e publikut nga keqbërjet presidenciale.

Për t'i dalë në krye kësaj ideje, ata kanë zgjedhur si armik një komb gati të panjohur për amerikanët. Për të realizuar një klip me lajmin e gënjeshtërt, producenti vë në ekran një portret shqiptari refugjat, në ikje e sipër, nga një fshat që digjet në sfond. E gjithë kjo është një sajesë kompjuterike.

Por vetëm një vit pasi ky film u vu në qarkullim nëpër kinema, vërtet refugjatët shqiptarë mbushën ekranet e televizorëve. Shtetet e Bashkuara dhe NATO ndërmorën një luftë të vërtetë, ndërkohë që forcat serbe dogjën fshatrat shqiptare dhe dëbuan nga vendi i tyre

[63] National Geographic Magazine, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000, faqe 52 – 83.

800.000 shqiptarë të Kosovës në një pranverë të tmerrshme spastrimi etnik.

Krejt papritur mësuam për Shqipërinë.

Këto imazhe lufte parashtrojnë shumë pyetje. Çfarë kishin serbët kundër shqiptarëve? Përse shqiptarët jetojnë në Kosovë? Kush jeton në Shqipëri? Çfarë janë shqiptarët e Kosovës për ata të Shqipërisë? Cilët janë shqiptarët, kudo qofshin, dhe si erdhën ata deri te vëmendja ndërkombëtare në një gjendje kaq për të ardhur keq?"

Pasi ka sjellë këtë detaj interesant, autori i shkrimit na tregon për udhëtimet, takimet dhe hulumtimet e bëra për të sjellë në faqet e revistës një përshkrim për popullin tonë, të lidhur me një nga ngjarjet që ka pasur jehonën ndërkombëtare më të madhe, të paktën, në dhjetëvjeçarin e fundit. Një çpopullim i pashembullt i një rajoni të tërë, një luftë e përbashkët e Aleancës së Atlantikut Verior, e para në historinë e saj, shtatëdhjetë e tetë ditë bombardime të pandërprera dhe arrihet çlirimi i një populli si një detyrë morale e bashkësisë demokratike perëndimore.

Ai shkruan:

"Në Ballkan, ku viktimizimi nganjëherë merret për nacionalizëm, shqiptarët kanë qenë viktimat klasike dhe shpesh duken të paaftë që ta përshkruajnë vetveten me terma të tjera. Pranverën dhe verën e shkuar kalova pesë javë midis shqiptarëve – brenda Shqipërisë, në kampet e refugjatëve në Maqedoni, Greqi, Itali, në Bronx, Nju Jork, dhe kudo që vajta, shtrova pyetjen:

"Çfarë jeni ju shqiptarët?"

"Ne jemi të shtypur prej fqinjëve tanë."

"Po cila është forca juaj?"

"Ne jemi të fortë që të luftojmë kundër serbëve."

"Mirë, atëherë, cila është dobësia juaj?"

"Na kanë dobësuar të huajt."

Atëherë, mendova të përpiqem vetë që ta ndërtoj këtë skelet të vështirë.

Fotografi e vitit 1970
Malësorë shqiptarë të Gucisë afër kufirit me Shqipërinë

Ajo që shqiptarët kanë më të mirë është: bujaria, besnikëria dhe forca jashtëzakonisht e madhe. Në Kukësin me baltë, brenda kufirit shqiptar, ku mijëra kosovarë kishin parkuar traktorët dhe rimorkjot e tyre së bashku, ashtu siç kishin mundur, një bujk më tha:

"Babai më ka treguar se çdo brezi shqiptarësh i kanosen luftëra. Më duket se kjo është lufta e brezit tonë."

Shqiptarët kanë qenë gjithmonë një popull i qëndrueshëm, të cilët krijonin familje të mëdha. Kjo ndodh, kryesisht, sepse secili priste që të humbiste ndonjë djalë ose prej gjakmarrjes, ose në luftë me pushtuesit. Ndoshta veçoria më e dallueshme e tyre është qëndrimi pragmatik, madje, gati i shkujdesur ndaj fesë. "Feja e shqiptarit asht shqiptaria", - shkruante Vaso Pasha, poet shqiptar i shquar i shekullit XIX.

"Shqiptarët janë popull mesdhetar, të cilët ndoshta rrjedhin prej ilirëve, mitologjia e të cilëve është e ndërlidhur me Greqinë dhe me Romën klasike. Ata merren për myslimanë, ndonëse qenë krishteruar

prej romakëve dhe, shumë prej tyre, edhe sot e kësaj dite, i rrinë besnikë kësaj feje."[64]

Autori i këtij artikulli i kthehet edhe një herë historisë së shqiptarëve dhe, veçanërisht, asaj të Skënderbeut kur thotë:

"Në shekullin XV, të udhëhequr nga heroi i tyre legjendar i njohur me emrin Skënderbej, shqiptarët u ngritën në revoltë kundër ushtrive islame të Perandorisë Osmane. Por turqit osmanë dolën fitimtarë dhe shumë shqiptarë e pranuan islamin si çmim të privilegjeve."

Edhe në këtë shkrim revista merret seriozisht me Betejën e Kosovës të vitit 1389 dhe me rolin që kanë luajtur te serbët mitet rreth saj:

> "Serbët u mblodhën rrethinave të Beogradit - dhe e panë veten e tyre, sikundër që e shohin edhe sot, mbrojtës të krishtërimit.
>
> Miti i tyre sundues është Beteja e Kosovës e vitit 1389, e cila përfundoi me fitoren e osmanëve, duke i hapur rrugën e sundimit të perandorisë mbi Ballkanin. Humbja mbeti në zemrat e serbëve e ngulitur si një kamë dhe nacionalizmi serb e rriti pasionin nacionalist duke u ushqyer me hakmarrje.
>
> Për serbët, shqiptarët janë mbeturinat e turqve osmanë, agjentë të poshtërimit kombëtar ndaj serbëve. Kur Sllobodan Milosheviçi vendosi ta spastronte Kosovën prej shumicës së saj shqiptare në vitin 1989, dukej qartë se ai kishte arritur një marrëveshje të fshehtë me popullin e tij. Por le të ndalemi e të pyesim, pikë së pari, çfarë duan shqiptarët në Kosovë, si pjesë e Serbisë? A e kanë ata vendin e tyre, apo jo?"

Këtë pyetje bën autori në këtë pjesë të shkrimit të revistës dhe ndalet, pikërisht, në njërën nga pikat më të rëndësishme të polemikës serboshqiptare atë të përkatësisë etnike të trojeve shqiptare në Ballkan dhe, më pas, vjen te një konstatim i bazuar në arritjet shkencore të historisë, të albanologjisë dhe të ballkanologjisë. Ja, si përgjigjet ai:

---

[64] National Geographic Magazine, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000, faqe 58.

"Po dhe jo. Fuqitë evropiane ia imponuan Shqipërisë kufijtë

politikë të vitit 1913, duke lënë afërsisht gjysmën e popullit shqiptar jashtë shtetit amë …

Shumë sllavë të Ballkanit frikësohen se mos ky territor përfaqëson 'Shqipërinë e Madhe', si një rrezik i së ardhmes ndaj Evropës së Krishterë dhe ndaj kombeve të saj të brishta. Shqiptarët e thonë me tallje se Milosheviçi i ka bashkuar ata për herë të parë.

Shqiptarët, individualisht, kanë qenë të fortë, por, historikisht, të dobët. Në vitin 1878, ata mbetën pa ndihmë, pasi Rusia e mundi Perandorinë Osmane dhe u përpoq t'u falte sa më shumë toka shqiptare Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Shqiptarët e mbajtën këtë tokë, që ishte nën sundimin osman, deri pas Luftërave Ballkanike në vitin 1913 kur ata e humbën Kosovën, e cila iu dha Serbisë. Shqipëria qe bërë shtet i pavarur një vit para kësaj, por e humbi atë gjatë Luftës së Parë Botërore. Vendi e rifitoi pavarësinë në vitin 1921, por politikani Ahmet Zogu ua rrëmbeu atyre shpresat demokratike dhe e deklaroi veten Mbreti Zog i Parë i shqiptarëve, duke themeluar një shtet alla opera–komike nën tutelën e fashistit italian Benito Musolini.

Italia e pushtoi Shqipërinë disa muaj përpara se të fillonte Lufta e Dytë Botërore. Më pas atë e pushtoi edhe Gjermania; kjo u shoqërua nga një luftë civile që shpërtheu ndërmjet shqiptarëve komunistë, partizanë të drejtuar nga Enver Hoxha, dhe nacionalistëve të djathtë. Në vitin 1946, shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Kosovës u mbajtën në një republikë të gjashtë të kombeve që përbënë Jugosllavinë, nën drejtimin e Josif Broz Titos.

Krahas kësaj, Enver Hoxha, duke premtuar gjoja zhvillimin e kombit, ngriti një sistem të tmerrshëm diktatorial, në të cilin kombinoheshin prapambetja osmane, brutaliteti stalinist dhe paranoja revolucionare kineze.[65] Historia e shqiptarëve është shumë e lidhur me ikjet nga pushtimet, me shpërndarjen në territore të afërta e të largëta, me dëshpërimin e thellë, me dhunën ose kaosin. Çdo largim ka marrë diçka jetësore të kombit. Janë afërsisht 8 milionë shqiptarë në të gjithë botën – të marrë në tërë shtrirjen e tyre – por vetëm 3.2

[65] National Geographic, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000, faqe 59.

milionë jetojnë në Shqipëri, 2 milionë të tjerë në Serbi dhe në Maqedoni; Greqia dhe Italia janë strehë e qindra mijëra të tjerëve. Pjesa tjetër është e shpërndarë në të gjithë botën, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Shqipëria duhej të ishte atdheu që do t'i mblidhte ata, por ajo është aq e braktisur për vete dhe aq e pazhvilluar, saqë nuk mund të përfaqësojë qendrën e aspiratave shqiptare. Ajo ngjan më tepër me një vend të sëmurë pas të cilit çdo shqiptar është i dhënë aq shumë, por që tani gjendet në mjekim për vete.

Shqipëria ishte vendi më i sertë dhe më i izoluar në Evropën Lindore, e fundit që u shkëput nga e kaluara komuniste dhe më e paafta për t'u ballafaquar me sfidat e së ardhmes. "Komunistët vranë shpirtin e popullit shqiptar", - më tha një ish ambasador i Shqipërisë në Itali. Ata vunë partinë mbi kulturën kombëtare.[66] Jugosllavia, prapëseprapë, e kishte një dritare për ta parë botën. Shqipëria nuk e kishte as këtë. Ajo ishte zhytur në errësirë të thellë."

Autori, përsëri, i kthehet çështjes së atdhetarizmit të manifestuar nga shqiptarët në ish Jugosllavi dhe shkruan si më poshtë:

"Ndoshta zemra shqiptare e shfaqi atdhedashurinë, më mirë se kudo tjetër, në Jugosllavi. Gjatë viteve kur Titoja ishte në fuqi, grupet etnike kishin të drejta të barabarta – të gjithë ishin jugosllavë dhe lejoheshin të udhëtonin jashtë vendit. Mijëra shqiptarë të Jugosllavisë kanë punuar në Evropën Perëndimore që nga vitet 1960 dhe pagat e tyre e ndihmonin Jugosllavinë financiarisht.

Pas vdekjes së Titos, në vitin 1980, të paktën Mali i Zi dhe Maqedonia treguan tolerancë ndaj bashkësive të tyre etnike shqiptare, ndërkohë që Serbia iu kthye atyre me tërë ashpërsinë e mundshme. Milosheviçi e filloi me heqjen e autonomisë së Kosovës në vitin 1989, duke i vendosur shqiptarët e Kosovës, megjithëse përbënin shumicën absolute, në periferi të shoqërisë. Ai i përzuri nga çdo pozitë me autoritet, i largoi nga çdo punë në sektorin shtetëror dhe, thuajse, nuk la shkollë pa mbyllur.

[66] Po aty, faqe 60.

Në vitin 1990, ai i merrte të rinjtë shqiptarë me dhunë në ushtrinë jugosllave. "Për shkak se isha i ri shqiptar," - më tregonte një shqiptar në Zyrih të Zvicrës, - "ata më vendosnin në vijën e parë të frontit…kishte djem shqiptarë që u ktheheshin nënave të vdekur në shtëpi. Kjo është arsyeja që u detyrova të iki andej."

Për t'i bërë ballë kësaj gjendjeje, shqiptarët ngritën një ekonomi paralele dhe institucione sociale por, megjithatë, nuk arrinin t'i paguanin të tëra shpenzimet. Gjatë viteve 1990, rreth 350.000 vetë, shumica të rinj, ikën nga Kosova për në vendet perëndimore. Shumë prej tyre përgjigjeshin për mirëqenien e familjeve dhe, nëse nuk mund të gjenin punë, atëherë i ktheheshin krimit. Thuhet se, për vite të tëra, shqiptarët e Kosovës kontrollonin trafikun e paligjshëm të drogës në tregun e Zvicrës, të Gjermanisë dhe të Austrisë.

Largimi i njerëzve të talentuar dhe energjikë e pengoi seriozisht zhvillimin e Kosovës, por kthimi i suksesshëm në shtëpitë e tyre me makina luksoze, me një mendësi të re kapitaliste, si dhe me para të mjaftueshme bëri që ata të ndërtonin shtëpi të reja, duke nxitur lakmi të thellë te serbët, që ishin aq të ashpër ndaj tyre."

Lufta ka mbaruar. Shqiptarët kthehen në vendbanimet e tyre. Ato janë të djegura. Mijëra shqiptarë janë vrarë. Mijëra të tjerë janë zhdukur. Ndërsa autori Veselind, pasi i ka vëzhguar tërë këto ngjarje, shkruan:

"Në kampin e refugjatëve në Stankovac pashë katër djem të moshës katërvjeçare tek luanin pranë gurëve që rrethonin çadrat. Një prej tyre u zgjat me një gur në dorë dhe më tha: "Këtë do t'ia jap NATO-s kur të vijë, që t'i vrasë serbët."

Shumë shqiptarë u kthyen në Kosovë me gurë në duar. Ata i vranë serbët, faj e pa faj, ua dogjën shtëpitë dhe e diskretituan Kishën Ortodokse Serbe. 170.000 serbë, tre të katërtat e popullsisë së paraluftës në Kosovë, u ikën akteve të hakmarrjes. Shqiptarët e Kosovës janë të shqetësuar për pasojat që ka lënë lufta te fëmijët e tyre, kjo mund të çojë në dhunë të mëtejshme.

A mund të jetojnë serbët dhe shqiptarët së bashku? Kurrë më! E pamundur! Këtë më thotë në kampin e Stankovacit Mehmet Shezai Shehu, një ish-mësues i gjuhës shqipe: "Neve nuk na ka dëbuar

Milosheviçi. Këtë e bënë serbët. Ishte një fqinji im, i cili u vesh me uniformë dhe trokiti në derën time duke më thënë: "Ik! Menjëherë! Të jap 15 minuta kohë!"

MAQEDONI

Është interesant të shënohet se shkrimi i parë i botuar për shqiptarët në revistën *National Geographic* është në nëntor të vitit 1908. Ai mban titullin 'Shënime për Maqedoninë'[67] dhe, duke qenë se ky është artikulli i parë i botuar për shqiptarët, lexuesi do ta gjejë më poshtë të plotë, pa shkurtime dhe komente:

Shqipëria, ndonëse gati sa nuk shihet me sy që nga Italia, është rajoni më pak i njohur në Evropë.

"Shqipëria është vendi më romantik në Evropë, ndoshta, edhe në botë. Është një vend pa ligje, ku e drejta është me të fortin, dhe pjesë të saj janë aq të pashkelshme nga të huajt, sa dhe Afrika. Në disa krahina të vendit, shtëpitë, më shumë se shtëpi banimi, janë fortesa të ngritura prej guri, pa dritare në katet e para, ndërsa ato në katet më të larta kanë frëngji. Në cepat e një fshati ose të një prone të caktuar gjenden kullat, si pika vrojtimi, për ta parë armikun që në rrugë e pastaj për t'u mbrojtur prej tij.

Ligji i parë në këtë vend është ligji për armën, siç ka qenë edhe në perëndimin e egër. Por vendi është më pak i populluar seç ishte kufiri amerikan në ditët e hershme të tij dhe njerëzit janë lidhur së bashku në fise, si për t'u mbrojtur, ashtu edhe për të sulmuar.

Në Shqipëri nuk ka sistem arsimor – turqit e kanë mbajtur vendin në analfabetizëm të plotë – dhe premtimet duket se janë bërë vetëm sa për të kaluar lumin. Kjo ndodh, me sa duket, sepse sulltani në Stamboll do t'i mbajë ata vetëm për truproja të tij. Shqiptari nuk ndihet përgjegjës për atë që bën ndaj atij që nuk i është betuar… …Në vend të kapeles, shqiptarët, në përgjithësi, vendosin një qeleshe të bardhë që ngjeshet mirë pas kokës, e cila shquhet shumë në dritën e diellit. Disa mbajnë kësula të kuqe të modës, otomane prej të cilave

[67] National Geographic Magazine, nëntor 1908, faqe 796-799.

varet një xhufkë e plotë e gjatë, ngjyrë argjendi, e zezë ose blu e që zgjatet poshtë deri te shpatullat.

Qethja e flokëve tek ata është krejt e pazakonshme. Burrat e rrujanë kokën nga të dyja anët duke mbajtur një tufëz flokësh në mes. Ajo përdridhet dhe futet nën qeleshe, diçka që gjendet edhe tek indianët e kuq. Ca të tjerë e rruajnë kokën vetëm në atë pjesë ku vendoset qeleshja. Ka arsye për këtë: meqë myslimanët rrallë e heqin qeleshen, temperatura e kokës barazohet prej saj. Ka edhe një dyzinë me forma të tjera qethjeje, asnjëra prej të cilave nuk e zbukuron shqiptarin. Megjithatë, ai përherë shfaqet i mahnitshëm.

Shqiptarët vijnë nga një racë e pastër evropiane. Ata janë shtatgjatë, shpatullgjerë, me fytyra të pastra, krejt të ndryshëm nga çdo lloj populli tjetër i Maqedonisë, madje edhe gjuha që flasin është tërësisht e ndryshme. Edhe pse asgjë nuk dihet përfundimisht për origjinën e tyre, është mëse e mundshme që ata të jenë pasardhësit e ilirëve të lashtë, të cilët, një herë e një kohë, zinin tërë anën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit dhe qenë shtyrë, gradualisht, në malet e Shqipërisë prej pushtimeve të njëpasnjëshme të grekëve, romakëve sllavëve dhe turqve.[68]

Shqipëria kurrë nuk ka qenë tërësisht e nënshtruar dhe as e qytetëruar. Në Mesjetë ajo ka qenë pjesërisht e pushtuar prej princëve. Nën sundimin turk ajo përfundoi në një gjendje të egër.

Shumica e shqiptarëve janë bërë myslimanë, kryesisht për shkak se feja u jepte të drejtën që të mbanin armë dhe privilegje të tjera [15].

Shqiptarët ishin e vetmja racë e krishterë, e cila u pushtua nga turqit dhe ndërroi fenë. Sulltani i zgjidhte truprojat midis tyre. Kur ata ia kthyen urdhrin, ai e kuptoi se kishte ardhur koha për t'u plotësuar kërkesat.

Shqiptarët në Maqedoni, të cilët ishin të parët që u përmendën në këtë revistë, vijnë përsëri në faqet e saj pas 92 vjetësh në shkrimin e Priit Vesilind, pikërisht, në periudhën e luftës në Kosovë, kur ata shfaqën solidaritetin e tyre më të madh me vëllezërit shqiptarë të Kosovës.

[68] National Geographic Magazine, '*Notes on Macedonia*', nëntor 1908, faqe 802.
[15] Po aty.

Në Maqedoni shqiptarët jetojnë më mirë se ata në Kosovë dhe në Shqipëri – në fakt disa janë bërë të pasur. Jo të gjithë janë myslimanë. Nënë Tereza e Kalkutës, për shembull, ishte bijë e një familjeje shqiptare të krishterë nga Shkupi, e njohur me emrin Agnes Gonxhe Bojaxhi.[69]

Megjithatë, edhe në këtë shtet ku shqiptarët përbëjnë, të paktën, çerekun e popullsisë së përgjithshme, shqiptarët janë objekt diskriminimi që rrjedh nga urrejtja banale që sllavët ushqejnë ndaj tyre. Ata shërbejnë si ministra në qeverinë maqedonase e, megjithatë, sot për sot zënë, vetëm 4% të punëve shtetërore. Disa vite më parë, policia i shtypi përpjekjet për të legalizuar një universitet në gjuhën shqipe në Tetovë,[70] në njërin prej qyteteve me popullsinë më të madhe shqiptare në Maqedoni.

Ndarja etnike u thellua kur, në vitin 1991, Maqedonia fitoi pavarësinë. Ajo e fitoi atë pa gjak, por thellësisht e lëkundur, duke mos i pranuar shqiptarët si partnerë të barabartë që do ta mbanin këtë shtet në këmbë. Kësisoj, shqiptarët u kthyen në një minoritet të madh, por tepër shqetësues brenda këtij shteti sllav. *"Kur këtu ishte Jugosllavi, ne njiheshim si një kombësi e përligjur me të drejta," - na thotë një punonjës i televizionit të Tetovës. "Tani vlerësohemi si një racë e rrezikshme dhe provokuese dhe populli shqiptar është nën një presion të madh. Çdo shqiptar e ndien frikën nën lëkurën e tij".*

Gjatë dëbimit të fundit masiv të shqiptarëve të Kosovës nga terrori serb, maqedonët sllavë i pritën ata me frikë të përgjithshme dhe me armiqësi të hapur, duke ua mbyllur dyert. Por shqiptarët etnikë të Maqedonisë vepruan ndryshe: ata strehuan në shtëpitë e tyre 150.000 refugjatë kosovarë.

Strategët i frikësoheshin luftës globale nëse serbët sulmonin Kosovën. Ata mendonin se shqiptarët e Maqedonisë do të bashkoheshin për t'u mbrojtur si komb. Pastaj Shqipëria vetë do të detyrohej të hynte në luftë, duke tërhequr kështu Greqinë dhe

[69] National Geographic, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000.

[70] Në vitin 1993 policia maqedonase vrau studentin Abdylselam Emini përpara dyerve të universitetit, thjesht sepse demonstronte për hapjen e këtij universiteti.

Bullgarinë. Turqia do të ndërhynte për të kundërgoditur rivalin e saj rajonal, Greqinë."

Por dominoja maqedonase nuk u shemb në vitin 1999, në një masë të madhe falë disiplinës së udhëheqësve shqiptarë aty. Në kampin e Bllacës, pranë kufirit, autoritetet maqedonase thuajse, i burgosën afro 50.000 refugjatët kosovarë të valës së parë të dëbimit të marsit të vitit të kaluar. Ata i lanë ata pa ushqime dhe pa ndihmë sanitare, duke u mohuar, për ditë të tëra, edhe kontaktet me punonjësit ndërkombëtarë të ndihmave. Prapëseprapë, unë nuk arrita të shihja ndonjë politikë radikale rekrutuese të shqiptarëve nga ana e UÇK-së, në kampet maqedonase.[71]

[71] National Geographic Magazine, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000.

Në rrjedhë të shekujve arbëreshët i dhanë Italisë një Papë, tre kardinalë, kryeministrin dhe burrin e shtetit, Francesko Krispi. Ata e ruajtën kulturën shqiptare gjatë sundimit turk dhe studiuesit e tyre qenë midis të parëve që e kodifikuan dhe e shkruan gjuhën shqipe.

IV

ARBËRESHËT DHE DIASPORA

Revista *National Geographic* e ka trajtuar, jo një herë, çështjen e arbëreshëve ose të shqiptarëve të Italisë. Në vitin 1919, në shkrimin 'Emigracioni është industri në Itali' arbëreshët përmenden si njëri nga grupet më të mëdha që emigronte në Shtetet e Bashkuara. Po kështu, në shkrimin e vitit 2000, Priit Vesilind përshkruan udhëtimin e bërë bashkë me aktivistin e njohur arbëresh të Amerikës, themeluesin e lobit shqiptaro-amerikan, ish kongresmenin, njeriun e palodhur të çështjes kombëtare shqiptare në përgjithësi dhe asaj të Kosovës në veçanti, Joseph DioGuardi. Aty autori përjeton çastet e një ribashkimi të gjakut të shprishur[72] dhe e përshkruan këtë me shumë dashuri:

Fshatarët e Piana Del Greçit janë pasardhës drejtpërdrejtë të shqiptarëve të Greqisë, të vendosur aty në një periudhë kur Siçilia u afroi atyre strehë nga zgjedha turke. Në ditë festash gratë veshin kostume, të cilat në Shqipëri visheshin pesëqind vjet më parë. Siçilia strehon njerëz të hershëm dhe, bashkë me ta, edhe kostumet që kontinenti i ka harruar ose i ka ndryshuar shumë kohë më parë.

> "Prej më se 500 vjetësh shqiptarët kanë filluar të lenë vendin e tyre dhe të marrin rrugën drejt gadishullit italian, drejt fqinjit të tyre mbrojtës, shpesh i gjetur pranë në ditë të vështira, por jo rrallë edhe

> kryeneç. Brigjet italiane, në pikën e vet më të ngushtë, janë pak më shumë se shtatëdhjetë kilometra larg nga Shqipëria. Gjatë kohës së komunizmit, disa shqiptarë e shihnin fshehtas televizionin italian. Ai

[72] National Geographic Mgazine, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000, faqe 64.

sillte tek ata pamjet e elegancës, të përparimit dhe të shoqërisë së konsumit.

Në shekullin XV, pasi qëndresa e tyre e udhëhequr nga Skënderbeu u thye, mijëra shqiptarë të krishterë kapërcyen Adriatikun. Këta refugjatë të atëhershëm u quajtën arbëreshë dhe themeluan 50 fshatra, në më të shumtën e rasteve nëpër krahina të tilla, si: Siçilia, Kalabria, Kampania dhe Puglia.

Fotografi autokrome lumiere nga Luig Perellano (1927)
Gra krenare për kostumet e tyre shumëngjyrëshe në Siçili

Fshataret e Piana Del Greçit janë pasardhëse të drejtpërdrejta të shqiptarëve të Greqisë të vendosur aty në një periudhë kur Siçilia u afroi atyre shpëtim nga zgjedha turke. Në ditë festash gratë veshin kostume, të cilat në Shqipëri ishin në modë 500 vjet më parë. Siçilia strehon njerëz të hershëm dhe, bashkë me ta, edhe kostumet që kontinenti i ka harruar ose i ka modifikuar shumë kohë më parë.

Fotografi e vitit 1921
Një familje arbëreshe emigron edhe një herë tjetër

Në rrjedhën e shekujve, arbëreshët i dhanë Italisë një Papë, tre kardinalë, kryeministrin dhe burrin e shtetit, Francesko Krispi. Ata e ruajtën kulturën shqiptare gjatë sundimit turk dhe studiuesit e tyre qenë midis të parëve që e kodifikuan dhe e shkruan gjuhën shqipe.

Edhe që këtu shqiptarët-arbëreshë morën rrugën për në vende të tjera. Në vitin 1929, Joseph DioGuardi e la fshatin e tij arbëresh të quajtur Greçi dhe u vendos në Bronx, Nju Jork. Aty ai hapi një dyqan ushqimor. Djali i madh i tij e dinte veten për italian. Vetëm kur u bë anëtar i Kongresit Amerikan, ai mësoi për të kaluarën e tij. "Babai im ishte një burrë i thjeshtë", - thotë DioGuardi.[73] - *"Ai fliste me motrat në një gjuhë të çuditshme dhe unë mendoja se ajo gjuhë ishte një dialekt i italishtes".*

Në mesin e viteve '80, DioGuardi mori flamurin e përpjekjeve për njohjen

[73] Joseph DioGuardi, amerikan me origjinë arbëreshe nga Greçi i Italisë, ish Kongresmen i SHBA-së, themelues i Lobit Shqiptaro-Amerikan, njëri ndër veprimtarët më të shquar të çështjes kombëtare shqiptare në Amerikë. Ai ka meritën që e futi çështjen e Kosovës në rendin e ditës të Shteteve të Bashkuara. Ai është themeluesi dhe Presidenti i Ligës Qytetare Shqiptaro - Amerikane. Me emrin e tij është e lidhur puna që kanë bërë shumë senatorë dhe kongresmenë amerikanë për çështjen shqiptare. Një rol të veçantë luan në këtë drejtim edhe e shoqja, publicistja e njohur dhe këshilltare për çështjet ballkanike, Shirley Cloyes.

e çështjes shqiptare në SHBA dhe u njoh si kreu i lobit shqiptar në Nju Jork dhe në rrethinë. Prillin e kaluar, Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane dërgoi 385 shqiptaro-amerikanë për të luftuar përkrah UÇK-së.

Joseph DioGuardi, Kongresmen Amerikan, 1985-1989

DioGuardi dhe e shoqja, Shirley, më ftuan t'i shoqëroja në një udhëtim për në Greçi,[74] në atë fshat të përgjumur të vendosur midis fushave të florinjta grunore të krahinës së Kampanias. Midis të paktave fjalë që DioGuardi dinte nga vendlindja e babait, ishte: 'Gjaku i shprishur'. Ishte kjo fjalë magjike, e shqiptuar nga DioGuardi, që bëri të shndrisnin sytë e shumë njerëzve. Më tej pasoi përqafimi i përmallshëm i Giovani Puchi, një shitës ushqimesh në pension, me të cilin DioGuardin e lidhte i njëjti gjysh.

"Unë mund të jem amerikan me dy prindërit nga Italia", - thotë DioGuardi, - "por tani kam zemër shqiptare".[75]

[74] Fshati Greçi në Itali është i populluar prej arbëreshëve. Këtë emër ai e ka marrë prej shqiptarëve të Jugut të Shqipërisë, që u vendosën aty pas vdekjes së Skënderbeut, por që vendësit i morën në fillim për grekë.

[75] National Geographic Magazine, '*Albanians A People Undone*', shkurt 2000.

Kostume popullore arbëreshe (1922)

Fotogafi nga Frederic Moor (1908) Kafazët shqiptarë të veshur me fustanella

Kafazi është një rojë i armatosur, të cilin e mbajnë ambasadat ose konsullatat e huaja për t'i ruajtur ata ose vendbanimet e tyre në Stamboll. Vini re pistoletat e tyre.

Në të vërtetë revista *National Geographic* ka përmendur që shqiptarët janë të përhapur nëpër vende të ndryshme të botës, duke dhënë edhe shifra për këtë. Megjithatë, përveç kujdesit që ka bërë Priit Vesilind në shënimet e marra në udhëtimin e bërë në Greçi, nuk ka ndonjë të dhënë tjetër aq të plotë.

Por revista nuk e ka anashkaluar edhe një dukuri tjetër; atë të kthimit të shqiptarëve në atdhe që nga mërgimi ku ishin, sa herë që krijoheshin kushtet ose këtë e kërkonte nevoja e ngutshme e familjes. Lidhur me këtë është interesant të shihet një fragment nga shkrimi i Melvile Chater në vitin 1931, kur ai takon dy shqiptarë, të cilët kishin qenë në Shtetet e Bashkuara, kishin punuar ca kohë dhe ishin kthyer përsëri në atdhe. Historia e Nexhdet Qerrexhiut, i kthyer në Nik Karter në Amerikë, dhe e Pjetrit na kujton dëshirën e shqiptarëve për t'u kthyer në atdhe, qoftë edhe nga Amerika, por edhe gjendjen që lënë kur ikin dhe atë që gjejnë kur kthehen përsëri.

Fotografi nga Artur Warner (1921)
Pamje rruge në Kalabri

Fotografi e vitit 1912 nga Theron J. Damon
Një grup krerësh të kryengritësve shqiptarë. Në mes tyre bie në sy një arbëresh nga kolonitë shqiptare në Itali.

Fotografi nga Artur Warner (1921)
Piana del Greçi: Një prej katër vendbanimeve të populluara prej shqiptarëve në Siçili.

NJË SHQIPTAR ME EMRIN 'NIK KARTER'

Në një vend me qytetërim të përparuar, një vjedhës makinash mund të përfundojë në burg. Në një Shqipëri më primitive, kuptohet, ku kushtet shoqërore shpesh të kujtojnë fillimet e jetës në perëndim, vjedhje kuajsh do të thotë vdekje e pashmangshme. Për këtë arsye, në tregun shqiptar të kuajve, pazaret bëhen në prani të një zyrtari, i cili i lëshon blerësit një vërtetim ku provon zyrtarisht shitblerjen dhe pagesën e bërë për këtë.

Një shofer i porositur, me një makinë të vogël, erdhi në kohën e duhur te dera jonë. U nisëm, duke lënë pas minaretë e Korçës, kaluam mespërmes fushës së gjerë dhe e gjetëm veten në hyrje të një gryke të thellë, të ngushtë shkëmbore. "Vend i keq banditësh," - tha nëpër dhëmbë shoferi ynë shqiptaro-amerikan. - "A e dini ç'do të thotë banditë? Thashë se e dimë. Një orë më pas hymë në një grykë të dytë me pamje mahnitëse. "Vend i keq me pengesa"! - tha përsëri shoferi. - "A e dini se ç'do të thotë pengesë?" Me një gëzim të shtirur i thamë se e dinim ç'do të thoshte edhe ajo fjalë.

Ai djalë gazmor vazhdoi të na tregonte për vendndodhjet e pritave të kaluara, si dhe për vendet ku trupat qeveritare i kishin pastruar bandat plaçkitëse. Kishim ardhur në Ersekë. Ndaluam për të vështruar vllehët shtegtarë tek po i ngarkonin gomerët e tyre që të merrnin rrugën në drejtim të maleve, në mbyllje të asaj dite pazari. Mendova se kishte ardhur koha ta pyesnim shoferin tonë për emrin. Kështu bëra. I riu shqiptar i ktheu sytë e tij të mëdhenj si rruaza, plot dritë e jetë dhe, pa ndonjë mburrje, shqiptoi:

"Unë jam Nik Karter".

Si është e mundur? A po udhëtonim vërtetë të shoqëruar nga një mbrojtje kaq e veçantë? Si ndodhi që një qime-ngritur, i quajtur Nik, në ditët e tij djaloshare më të mira, të ishte me origjinë shqiptare? Ja se si e mësuam këtë.

"Një ditë prej ditësh, ndonja dhjetë vjet më parë, prindërit e kishin përcjellë shoferin tonë deri te dyert e një shkolle shtetërore në Nju Jork. Kur mësuesi i tij mësoi se ai e kishte emrin Nexhdet Qerrexhiu, u kërkoi prindërve të tij emigrantë që, nëse jo për ndonjë arsye tjetër, të paktën, për hir të lehtësisë për ta shqiptuar, duhej bërë diçka për ta ndërruar atë emër. Kështu, babai e përshtati mbiemrin duke e përkthyer atë pikë për pikë në anglisht dhe e quajti Karter. Tani fëmijët e shkollës nuk kishin pse të vuanin më për të shqiptuar një emër aq të gjatë. Edhe në Shqipëri, Nexhdet Qerrexhiu përdorte patentën e shoferit me emrin *Nicola Carter*, megjithëse

oficeri që e kishte lëshuar, kishte harruar të shënonte: *Njeriu i Grykës së Vdekur*.

> "Në afërsi të Leskovikut, bora e hedhur me qavë u grumbullua aq shumë, sa na shkëputi nga pjesa tjetër e botës, duke kërcënuar që të na fuste në një rrugë pa krye të tipit alpin. Ishte një kërcënim i përsëritur shpesh, por, sidoqoftë, i shmangur gjatë dhjetë ditëve të udhëtimit me automobil sa nëpër shtigje malore, aq edhe mespërmes fushave të gjera."[76]

Dy personazhe të këtij shkrimi, Nik Karter dhe Pjetri ose Pjetra, siç e shqiptojnë malësorët këtë emër, e shoqërojnë autorin e shkrimit dhe ekipin e tij nëpër Shqipëri nga cepi më jugor deri te cepi më verior i kufijve politikë të Shqipërisë. Por ndarja e të huajve me Pjetrin në Shkodër është e një bukurie të veçantë prekëse:

> "Pjetri na dha një përshëndetje faqe më faqe, aq të butë e të këndshme, si të ishte grua; pastaj e ktheu fytyrën drejt murit – qeshja jonë ishte plot dhembje dhe aq e vjetër sa ajo e Gunga Dinit[77] – ndërsa dënesa e tij sa nuk na i nxori zemrat prej gjoksit; menjëherë, ne amerikanët shquajtëm tek ai fare qartë ato lidhje të largëta, të mjegullta të jetës së tij, të përziera me të kaluarën e dikurshme në Kentuckin e largët.
>
> Hipëm në makinë dhe u nisëm. Ishte më mirë të mos flisnim, andaj mbetëm gojëkyçur për një farë kohe. Ndoshta përmallimi i Pjetrit kishte hyrë brenda nesh, brenda ne të çuditshmëve në Shqipërinë e largët - jehonë e një refreni të pavdekshëm, ku zemra i kthehet përjetësisë aty ku jetojnë njerëzit e lashtë."[78]

ARUMUNËT E ÇUDITSHËM

[76] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkurt 1931.

[77] *Gunga Din,* është një prej poemave më të famshme të shkruara prej Rudyard Kipling. Poema është një tregim i rimuar i një ushtari anglez që i kushtohet një mbajtësi uji vendas që i shpëton jetën.

[78] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melville Chater, shkurt 1931, faqe 182.

Midis shqiptarëve jeton një grup njerëzish të çuditshëm që e thërrasin veten arumunë. Thuhet se janë pasardhës të rumunëve – prej legjionit të pestë rumun, i cili u shpërbë dhe u shpërnda përgjatë rrugës që shtrihej nga Durazzio për në Konstandinopojë. Kjo rrugë e madhe e Romës së lashtë (Via Egnatia), e quajtur në fillimin e saj Rruga Appian, kalonte drejt juglindjes nëpërmjet Italisë, mespërmes Brindisit, fillonte përsëri në Durrës, rendte që andej nëpërmjet Elbasanit pranë Liqenit të Pogradecit për në Kërçovë dhe, më pas, vazhdonte për në Manastir dhe Vodenë; prej andej



Fotografi nga Gjeneral George P. Scriven
Ana lindore e Kështjellës së Ai Pashë Tepelenës

Kur Aliu ishte katërmbëdhjetë vjeç, babai i tij, beu trashëgimtar i Tepelenës, u vra prej çifligarëve fqinjë. Pas kësaj, nëna e tij, një grua me forcë të jashtëzakonshme karakteri, organizoi një bandë kusarësh, që u kujdesën për djalin, me idenë se një ditë do të merrte hak ndaj vrasësve të babait. Kështu, nën një kujdes të tillë, u bë pashai më i pushtetshëm i Perandorisë Osmane. Ai u bë një sundues i padiskutueshëm i Epirit, i Shqipërisë dhe i Thesalisë, i tillë sa as Napoleon Bonaparti nuk mundi të bënte pa hyrë në aleancë me të.

për në Selanik dhe, pas tij, zgjatej deri në Konstandinopojë.

Rumunët janë njerëz shumë krenarë dhe pyetjes për origjinën e racës së tyre i përgjigjen duke thënë, "jemi pasardhës të rumunëve". Ata janë popull thjesht çoban, jo të dhënë pas plaçkitjes ose kusarisë. Fshatrat e tyre primitive të vogla, të përbëra prej gurësh, dallohen nëpër male, madje, shpesh në lartësitë e maleve. Një koloni e gjerë e tyre e njohur si *vllahi* jeton në shpatin e Malit të Pindit që sheh nga ana e Leskovikut, por larg, matanë luginës dhe grykës së malit.

Që nga lartësitë, ku arumunët i kullotin tufat e tyre të bagëtisë gjatë verës, zbresin në dimër nëpër lugina dhe në rrugën e tyre, të tërë së bashku, burra, gra dhe fëmijë të rrethuar prej qindra delesh e dhish, në kërkim të kullotave. Këto formojnë një pamje të jetës shtegtare që na kujton ditët e Abrahamit.

Thuhet se gjenden 80.000 arumunë të tillë; por kush e di me të vërtetë numrin e tyre, ashtu siç janë të shpërndarë nëpër maja malesh, nëpër fshatra të pashkelshme ose në shpella, duke lëvizur prej një vendi në një tjetër.[79]

Fotografi e vitit 1931
Një popull i veçantë i maleve të Shqipërisë

[79] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918, faqe 95.

"Shqipëria, ndonëse është ngjitur me Italinë, është më pak e njohur sesa pjesa e brendshme e Amerikës," shkruante historiani Eduard Gibbon njëqind vjet më parë. Ajo ende është, në masë të madhe, *terra incognita*. Një letër e drejtuar për në *Albani* tani vonë, qe dërguar nga Anglia në Amerikë dhe pastaj u kthye nga Albany[80], në Nju Jork me një shënim sipër: "Jo për Albany, përpiquni ta gjeni këtë vend në Evropë".



Fotografi nga Luig Pellerano (1931)
Këtu, një herë e një kohë, u zihej pritë barbarëve

Gryka e Këlcyrës formon një portë natyrore midis Maqedonisë dhe Adriatikut. Iliria e lashtë prej nga rrjedhin shqiptarët, përbënte një mbrojtje të anës lindore kundër barbarëve, të cilët erdhën këtu për t'u mposhtur para se të arrinin legjionet romake.

[80] Albany, është kryeqyteti i shtetit të Nju Jorkut në SHBA.

Fotografi nga Gjen. George P. Scriven (1918)
Përfaqësues i popullit më të vjetër të Evropës Juglindore

Shqiptari e quan veten *Bir i Shqipes së Maleve* – dhe ai e meriton këtë emër, sepse e ka ndërtuar shtëpinë midis thepave jopjellorë të tokës së tij për shumë shekuj, duke e ruajtur deri në një masë të habitshme pavarësinë dhe paprekshmërinë e tij racore.



Shkodra dhe kodrat rreth saj (1918)

Fotografi e vitit 1908 nga Frederik Moor (Macmillan)
Rekrutë shqiptarë për truproje të sulltanit[81]

[81] Kjo është fotografia e parë e botuar për shqiptarët në *National Geographic Magazine* në vitin 1908.

Kanuni i Lekës, i administruar prej një këshilli të plotë të pleqësisë së fisit, përfaqëson një prej formave më të vjetra të trupit gjykues, që i ka mbijetuar përshtatjes së përgjithshme me ligjin e shkruar.

V

KANUNI, BESA, GJAKMARRJA, MIKU, VIRGJINAT DHE GRUAJA SHQIPTARE SIPAS REVISTËS

Revista i ka kushtuar një vend shumë të rëndësishëm trajtimit të çështjes së Kanunit të Lekë Dukagjinit, *Besës Shqiptare*, vendit që zë gruaja në shoqërinë shqiptare, si dhe dokeve e zakoneve të tjera tradicionale të ruajtura te populli ynë. Duket se Kanuni nuk i ka shpëtuar syrit të asnjë udhëtari amerikan, që ka shkelur në trojet shqiptare, qoftë para Luftës së Dytë Botërore, qoftë pas rënies së Murit të Berlinit.

KANUNI I LEKE DUKAGJINIT

> "…Prej fisit të tyre rrjedh hartuesi i Kanunit, i cili mban emrin e hartuesit dhe mbiemrin e krahinës: Lekë Dukagjini. Ky Kanun e qeveris vendin që prej Mesjetës, veçanërisht në pjesën e tij malore.[82]
>
> Në të vërtetë, shumë studiues mendojnë se Leka mori dhe ripunoi një ligj që ekzistonte që përpara tij dhe që mund ta ketë zanafillën që në fillimet e hershme të jetës fisnore shqiptare.

[82] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdom'*, shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 179.

Përtej kodeve qeveritare, si dhe Dhjetë Urdhëresave, qëndron Kanuni i pashkruar i Lekë Dukagjinit. Ai mbështetet në *lex talionis*[83] dhe e ka bazën në parimet e patriarkalizmit, pra, të epërsisë së burrit mbi gruan. I interpretuar në mënyrë më të thjeshtë, ai i jep burrit të drejtën që të vrasë gruan ose fëmijët e vet. Jo më shumë se njëzet vjet më parë, një malësor shqiptar ia shpagoi pabesinë gruas së tij duke shtënë mbi të me fishekun që vëllai i saj ia kishte dhënë atij si provë të lejes për ta bërë këtë.

Megjithëse drejtësia primitive e Kanunit dhe kodi i gjakmarrjes së malësorëve mund të na duken barbare, prapëseprapë ato duhen parë si mënyrë e të mbijetuarit të këtij populli në rrjedhën e shekujve të gjatë e të errët të sundimit osman. Këtyre njerëzve u duhej që të mbroheshin, në një farë mënyre, nga e keqja, pasi ishin të ballafaquar me pushtetin e zyrtarëve të shkujdesur turq, të cilët e bënin, thuajse, tërësisht të pamundur kapjen dhe ndëshkimin e keqbërësve.

Këta malësorë janë aq të veçantë dhe të pathyeshëm, sa edhe vetë malësorët skocezë do t'ua kishin zili; kjo lloj fare njerëzore, vërtetë e jashtëzakonshme, ka mbetur, thuajse, e vetëqeverisur nëpër baticat dhe zbaticat e perandorive që vinin e shkonin. Megjithëse konservatorizmi mund të shihet si term i prapambetur për t'u zbatuar ndaj këtyre burrave shenjtarë të fiseve, e vërteta është se malësorët veprojnë sipas traditave krahinore kryeneçe të një të kaluare, tashmë, të lënë pas.

Kanuni i Lekës, i administruar prej një këshilli të plotë të pleqësisë së fisit, përfaqëson një prej formave më të vjetra të trupit gjykues që i ka mbijetuar përshtatjes së përgjithshme me ligjin e shkruar. Paditësi emëron anëtarët e jurisë, vendimi i të cilëve për dhënie pafajsie pranohet vetëm nëse është i njëzëshëm. Nëse njëri prej anëtarëve të jurisë voton kundër *pafajësisë*, atëherë ai që del kundër, duhet zëvendësuar prej dy të tjerëve. Pleqësia nuk mund të japë dënim me vdekje, madje as burgim ndaj njeriut të dënuar, por vetëm gjoba ose djegie pasurie."

BESA SHQIPTARE

Le të ndalemi tani te Besa Shqiptare, një virtyt i trajtuar gjerësisht prej shumë autorëve të kësaj reviste. Besën e gjejmë të trajtuar në disa

[83] *Lex talionis* – Ligji i Hakmarrjes.

shkrime dhe të huajt e kanë vlerësuar pa masë këtë cilësi të mëveçme të shqiptarëve. Megjithatë, duhet thënë se përshkrimi që Dushko Doder i bën Besës, fjalës së nderit të shqiptarit, mbajtjes së fjalës së dhënë, është sa bindës, sa emocionues, aq edhe mahnitës në detyrimin që kjo fjalë përmban kur shqiptari e jep atë.

Dushko Doder është biri i një nëne shkodrane. Ai ka udhëtuar në Shqipëri. Ka takuar shumë njerëz midis të cilëve edhe At Simon Jubanin, priftin katolik, i cili pasi ka kaluar nëpër burgjet komuniste, me ndihmën e rinisë shkodrane, myslimanë e të krishterë së bashku, ka hapur Kishën Katolike në qytet, duke sfiduar qeverinë komuniste të asaj kohe. Ja si e sjell ai në revistë takimin dhe bisedën me At Jubanin:

"Ai më ftoi në zyrën e tij, ku një fotografi e takimit të tij me Papa Gjon Pavlin II tregonte statusin e tij të ri pas vitesh lënieje pas dore. At Jubani e dinte se e ardhmja kërkonte shumë përpjekje."

"Është e vështirë të kalosh nga një shtet fisnor në demokraci", u shpreh At Jubani. Tranzicioni do të marrë kohë, por shqiptarët e kishin demonstruar, tashmë, aftësinë e tyre përtëritëse. Ai shtoi: "Enver Hoxha nuk e kishte shkatërruar fenë më shumë se ç'kishte shkatërruar njërin prej atributeve më të forta të kulturës shqiptare – Besën Shqiptare, ose fjalën e dhënë".

"Kur Enver Hoxha erdhi në fuqi, Besa ishte Besë", - kujton At Jubani. - "Por Enveri u përpoq ta zëvendësonte atë me korrupsionin, gënjeshtrën dhe me padijen."

"Ah Besa, m'u kujtua një fjalë e vjetër", - thotë Doder: "Shqiptarët po dhanë fjalën, therin djalën." Si fëmijë e kisha dëgjuar këtë fjalë të thënë me solemnitet, përtej çdo fjale tjetër, dhe isha mësuar ta nderoja fjalën time të dhënë, pa marrë parasysh se çfarë do të ndodhte më pas. Ajo është ende e freskët në mendjen time dhe jeton në qenien time. Deri në Luftën e Dytë Botërore Shqipëria kishte qenë, në thelb,

shoqëri fisnore, feudale, e lidhur fort pas traditave dhe besnikërisë – dhe, gjithmonë, pas asaj që çmohet më shumë - Besës."

"Në Shqipërinë e hershme Besa nuk ishte vetëm një kod moral, i cili në shoqëritë e tjera mund të përbënte themelet e virtytit dhe të nderit. Besa ishte një ligj, i cili ka shërbyer, për shekuj me radhë, si

rregullator i jetës së përditshme. Ajo rregullonte marrëdhëniet midis individëve, fshatarëve, fiseve, madje, edhe krahinave. T'ia thyesh besën dikujt nuk ishte vetëm turpi më i madh, por edhe një shkak për të marrë një dënim të rëndë."[84]

Për ta vërtetuar sesa thellë është ngulitur tek ai kjo ndjenjë fisnike e edukuar nga e ëma, Dushko Doder na jep një shembull konkret sesi ai e mban Besën ndaj kushëririt të tij Jak Kosmaçit, të cilin mezi e ka gjetur në Shqipëri. Ai e ka kërkuar Jakun në Shkodër e më pas në Shijak. Ishte një amanet i lënë nga e ëma. Më në fund janë njohur me njëri-tjetrin dhe i kanë treguar historitë e jetës së tyre. Dy histori krejt të ndryshme, që i lidhte vetëm një pikë: malli i nënës së tij për të parë njerëzit e saj dhe Shkodrën ku kishte lindur. Autori e ka ndier tragjedinë e jetës së kushëririt Jak, por edhe dobësinë e nënës së tij për vendlindjen. Andaj premton që të bëjë diçka për djalin e tij Aleksandrin, i cili gjendej në burgun e refugjatëve shqiptarë në Beograd, ku kishte shkuar në përpjekje për të vajtur në Amerikë. I jep fjalën dhe fjalë e dhënë për të do të thotë Besë. Udhëton për në Beograd. E takon djalin e kushëririt, Aleksandrin. E nxjerr nga burgu. I rregullon vizë udhëtimi për në perëndim. E merr për darkë. E lut që të kthehet në Shqipëri, *pasi punët po ndryshojnë*. Nuk e bind dot. E përcjell dhe kthen lajmin në Shijak tek i ati i djalit për të cilin, pas tërë atij kalvari të pafund vuajtjesh e persekutimi ndaj pesë brezave të familjes, brenga e fundit ishte i biri në burgjet serbe. Po e citojmë mbylljen e tregimit të Doderit:

"…Duke u kthyer për në shtëpinë time në Beograd, u kujtova për premtimin që i kisha dhënë Jakut. Aleksandri, ende, mbahej në një burg në Jugosllavi ku ai dhe refugjatë të tjerë shqiptarë prisnin për t'u marrë në shqyrtim dhe për të parë se si qëndronte puna me statusin e tyre nga ana e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Kur i telefonova Ambasadës Amerikane, një nëpunës i sektorit konsullor më tha se Aleksandri nuk mund të merrte azil në Amerikë. "Pse nuk përpiqeni për në Kanada ose Australi?" - më këshilloi ai.

Kanadaja pranoi ta merrte, kështu që unë pata kënaqësinë e madhe ta shihja Aleksandrin të liruar. E mora për darkë që të festonim bashkë.

[84] National Geographic Magazine, *'Albania Opens the Door'*, korrik 1992, faqe 86.

A do të ktheheshit ndonjëherë në Shqipëri?

"Kurrë," - më tha Aleksandri. "Kam bërë një betim."

Unë këmbëngula, por Aleksandri qëndroi qetësisht në të tijën. Atëherë lëre të ikë, mendova, ai, vërtet, mjaft ka vuajtur.

Ai ka ikur për një jetë të re në Kanada, ku do të bashkohet me gruan dhe me fëmijët. Kur i tregova kushëririt Jak rreth kësaj, ai u tregua i kënaqur nga lajmi i mirë.

I kënaqur, por jo i habitur.

Pa dyshim:I kisha dhënë Besën Jakut."[85]

Jaku që këtë lajm mezi e priste, është kënaqur, por nuk është habitur. Me dy fjalë Doder ka dhënë tërë filozofinë e fjalës së parafundit të shkrimit të tij: 'Besë' pasi jo vetëm për Jakun si shqiptar, por edhe për Doderin si nip shqiptari, nuk bënte që Besa të shkelej.

Për besën shprehet edhe autori tjetër, Priit Vesilind, si më poshtë:

Ajo që shqiptarët kanë më të mirë është se janë bujarë, besnikë, dhe jashtëzakonisht të paepur.[86]

GJAKMARRJA

Revista *National Geographic* i ka kushtuar një vend të rëndësishëm dukurisë së gjakmarrjes te shqiptarët. Thuajse çdo udhëtar i revistës e ka vënë re këtë dukuri të shqiptarëve. Disa prej tyre e kanë vlerësuar si dukuri

[85] National Geographic Magazine, korrik, 1992, *'Albania Opens the Door'*, shkruar nga Dushko Doder, faqe 93.

[86] National Geographic Magazine, '*Albanian a People Undone*', shkurt 2000.

primitive, disa si nevojë për shkak të keqqeverisjes osmane. Më poshtë po japim disa prej mendimeve më të zgjedhura për të:

> "Por të mos flasë kush për shqiptarin si njeri që nuk udhëhiqet nga ligji. Ai jeton me skrupulozitetin më të madh deri në kufijtë e njohjes së tij; por ai është ligji që i është dhënë prej zakoneve të natyrës së stërgjyshërve të tij shekuj më parë, diçka "e kodifikuar" në shekullin e pesëmbëdhjetë, ndonëse edhe sot e kësaj dite nuk gjendet i shkruar midis rregullave të çuditshme që qeverisnin jetën."[6]

Siç dihet, gjakmarrja ka qenë dhe, ende, ushtrohet në Shqipëri si zakon i keq, por që nuk i shpëton asnjëherë syrit të të huajve. Ja sesi shkruan Melvile Chater për gjakmarrjen:

> Merre gjakun! Që prej kësaj dite kur thuhet kjo fjalë, tëhuajtja shoqërore e ndjek fistarin, i cili qëndron saktësisht pas marrjes së gjakut. Por nga ana tjetër, nëse ai qëllon mbi njeriun që kërkon, në një kohë kur ky i fundit është i shoqëruar nga një grua ose nga një fëmijë, ose brenda asaj kohe kur i është dhënë besë (ndërprerje e përkohshme e gjakmarrjes), emri i tij do të bëhej një emër i pështirë dhe i përbuzur. Sapo vepra të jetë kryer, marrësi i gjakut përhap lajmin se nderi i tij është vënë në vend. Nëse ai vihet në ndjekje, ka të drejtë që të kërkojë ushqim dhe strehë për 24 orë te çdo vatër. Pjesëtarët e familjes ku ai kërkon strehë, janë të detyruar ta mbrojnë, si dhe ta përcjellin nën masa sigurie për në ndonjë vend tjetër.

Shkrimtarët e vjetër, udhëtarë, pa dyshim do ta kishin përshkruar këngën e mëposhtme si *melodi vajtimtare*. Kënga është e thjeshtë dhe e shkurtër:

Tinzisht rri aty i strukur mbas gurit,
Ku vrasës i vëllait kalon,
Nderën e fisit e të burrit,

[6] National Geographic Magazine, '*The Albanians*', nëntor 1908, shkruar nga Theron J. Damon, faqe 1092.

[7] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 181.

Me një plumb duket se e mbron."[7]

Ja si e përshkruan këtë dukuri edhe George P. Scriven:

"Shqipëria njihet si vendi i gjakmarrjes – zakon fisnor ose, ndoshta, më mirë të themi, zakon racor i vëzhguar për shumë shekuj. Udhëtarët dhe studiuesit, zakonisht, u referohen malësorëve shqiptarë si njerëz tërësisht të paqeverisur nga ligji, por, në të vërtetë, veprimet e tyre deri disa vite më parë tregojnë se ata i bazonin ato në respektimin më të rreptë të ligjit – një ligj fisnor i themeluar në idenë më shpërfytyruese të ruajtjes së nderit vetjak dhe familjar.

Edhe shkelja më e lehtë e zakonit – fyerje që nxit zemërim, goditje e rëndë zemërimsjellëse, shtyrje e paqëllimtë në turmë – çon pashmangshmërisht, në shpalljen e gjakmarrjes. Dhe nderi i palës së dëmtuar është i njollosur deri sa ai të vrasë ose atë që e ka fyer, ose ndonjë pjesëtar mashkull të familjes së tij. Të afërmit e të vrarit, më pas, detyrohen të nisin kërkimin dhe, në këtë mënyrë, shpërthen gjakmarrja.

Shumëkush është kureshtar të dijë për zakonet dhe ritualet e gjakmarrjes. Është ligj i pashkruar i fisit që kushtëzon që, nëse një burrë është i shoqëruar prej një gruaje, ai nuk mund të sulmohet. Shpesh bashkëshortja, e bija ose ndonjë motër e shoqëron njeriun e vet në të gjitha udhëtimet nëpër male, me qëllim që prania e saj ta mbrojë atë nga armiku i papajtueshëm."[87]

MIKU PËR SHQIPTARIN

Ja si e përshkruan Melvile Chater kujdesin që tregon malësori shqiptar për mikun:

"Një kanun i rreptë e bënte mikun të ndihej i sigurtë nëpër male. Edhe sot, pas kaq shekujsh, fisi shqiptar është i ndarë në

[87] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven , gusht 1918, faqe 92.

mëhalla[88] (grupe shtëpish të njerëzve të afërt), të cilat janë të nënndara në grupe shtëpish, secila e udhëhequr prej të zotit të shtëpisë. Këtu, mbi të gjithë, është bajraktari ose mbajtësi i flamurit. Madje edhe sot e kësaj dite, ende vazhdon të respektohet ligji shqiptar i kreut të fisit si mikëpritës i të huajve; ai është më shumë ligj sesa zakon, që rrjedh nga përgjegjësia që mbart mikpritja dhe që përcillet nga njëri fis te tjetri. Nëse, zoti mos e thëntë, neve na zihet pritë dhe vritemi ndërkohë që jemi në territorin e bajraktarit, kjo kthehet menjëherë në çështje nderi që e detyron atë të marrë hak për ne. Prej këtej rrjedh përgjegjësia që ka fisi për sigurinë e mikut për aq kohë sa ai qëndron ose shkel mbi tokat e atij fisi.[89]

Nëse një udhëtar e ka kaluar natën në shtëpinë e dikujt, i zoti i asaj shtëpie, sipas ligjit fisnor, është i detyruar që të deklarojë gjakmarrje ndaj çdo personi që do të fyente ose do të prekte këtë mik, brenda një periudhe kohe të caktuar, të llogaritur nga çasti i gostitjes në atë shtëpi deri në atë të ngjarjes.[90]

Nëse një njeri bën vrasje dhe ikën për të shpëtuar jetën e tij dhe futet në shtëpinë e një tjetri, mik ose armik qoftë, ai është i mbrojtur. Kjo vlen edhe nëse ai strehohet në shtëpinë e viktimës së tij. Ai nuk mund të mbetet aty përherë, por për tri ditë, ai mund të jetojë aty i sigurtë, duke pasur gjithçka të mirë që ajo shtëpi mund të afrojë. Kur mbaron koha, ai ikën në rrugën e tij. Atij i garantohen njëzet e katër orë që të shpëtojë. Pas kësaj, afati i ruajtjes së besës përfundon dhe kështu i hapet rruga gjakmarrjes."[91]

Deri këtu arrin nderi dhe përgjegjësia për mikun, për njeriun që troket në derën e shqiptarit edhe atëherë kur ai është dorési ose vrasësi i dikujt nga familja ku ka trokitur. Një ndjenjë e tillë kaq e lartë për

[88] - Kështu është në original.

[89] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 166.

[90] Po aty.

[91] National Geographic Magazine, '*Notes on Macedonia'*, nëntor 1908, faqe 802.

mikun e mbulon ndjenjën tjetër të hakmarrjes. Po kështu, në revistë do të gjendet edhe ky vlerësim:

> "Perandorí dhe qytetërime kanë kaluar mbi vendin e tyre, por ata kanë ecur në mënyrën e tyre të vështirë, duke i pranuar sundimtarët sa për emër, vetëm sa për emër. Ata flasin një gjuhë që nuk është e shkruar. Kodi i tyre i jetës dhe i nderit është mesjetar dhe krenaria e tyre më e madhe është se ata kurrë nuk e kanë tradhëtuar mikun dhe kurrë nuk e kanë kursyer armikun."

VIRGJINAT

Udhëtarët e revistës *National Geographic* nuk kanë lënë pa përmendur edhe një zakon të vjetër shqiptar, atë të virgjëreshave ose të vajzave të cilat, kur familja mbetej pa mashkull në vatër, vishnin rrobat e burrave, betoheshin dhe përballonin jetën njësoj si djalë shtëpie. Interesant është se autori i revistës i referohet historianit të famshëm grek Herodoti dhe e karahason këtë zakon të malësisë shqiptare me atë të amazonave.

Fotografi e vitit 2000
Virgjëreshë e betuar shqiptare

Duke jetuar si burrë gjatë 30 vjetëve të fundit, Pashkja u kthye në *virgjëreshë të betuar* kur mashkulli i fundit i familjës së saj vdiq, dhe i la asaj emrin e shtëpisë dhe pasurinë. Duke respektuar Kanunin e Lekë Dukagjinit, ajo hoqi dorë nga jeta e saj prej gruaje dhe filloi të vishej dhe të vepronte si burrë e të thirrej me emër burri, Pashk.

"Njëri prej djemve, në të vërtetë një djalë i veçantë e bukurosh, kishte një tatuazh në krahun e djathtë të bërë sipas praktikës, që ende është e gjallë e të cilën Herodoti[92] e përmend si traditë të lashtë ilire. Pjetri e drejtoi gishtin nga njeriu me tatuazh dhe më tha: Ajo është një grua-burrë. Nuk është martuar dhe as nuk martohet kurrë.

Kjo thënie kaq interesante na bëri të njohim zakonin shumëshekullor të Malësisë së Madhe, që është, ndoshta, po aq i vjetër sa edhe ai i amazonave."

GRUAJA SHQIPTARE

Revista i ka kushtuar një vend shumë të rëndësishëm trajtimit të çështjes së vendit që zë gruaja në shoqërinë shqiptare sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit:

"Zakonet shqiptare janë të egra deri në rrezik dhe thuhet të jenë përcjellë brez pas brezi. Te shqiptarët ekzistojnë disa zakone të çuditshme. Të përshëndetësh një grua të pamartuar, për shembull, është një provokim që ndjell vdekje. Një gjaks është i falur sa kohë që është i shoqëruar nga një femër. Një femër mund të qëllojë mbi të fejuarin, i cili e prish fejesën ose i kërkon babait të djalit që ai vetë ta vrasë atë."

Në vlerësimet për gratë shqiptare, në revistë gjejmë edhe këtë pohim:

[92] Herodoti i Halikarmasit, historian i lashtësisë, i cili jetoi në shekullin V (484–425) para erës së re. Ai u bë i famshëm me përshkrimin e historisë së konfliktit midis Greqisë dhe Persisë, si dhe për përshkrimet e vendeve të ndryshme dhe të njerëzve që takonte gjatë udhëtimeve të tij të pafund. Vepra e tij më e rëndësishme është 'Historitë e Herodotit'. Ai ishte i pari që jo vetëm e paraqiti të kaluarën, por edhe e trajtoi atë si një problem filozofik që mund të ndihmojë në vetë sjelljen njerëzore.

"Gratë shqiptare lindin trima. Kam parë qindra, në të vërtetë mijëra të tilla, të zellshme dhe punëtore, të ushqyera me bukë e me djathë, disa me fëmijë të vegjël, anës rrugës me ca pleq tek thyejnë gurë tërë ditën, në të nxehtë e në të ftohtë, për të përfituar nga qeveria italiane tri lira në ditë. Edhe fëmijëve u jepet e njëjta pagë për përpjekjet e tyre, sado pak të vlefshme qofshin ato.

Në Shqipëri janë gratë ato që punojnë. Gratë ortodokse punojnë më shumë se ato myslimane. Megjithatë, të gjitha punojnë. Ato janë fisnike; nuk e njohin prostitucionin dhe një fëmijë i paligjshëm është thënë të jetë një humbje nderi si për nënën që e lind, ashtu edhe për familjen dhe për bashkësinë ku jeton ajo."[93]

Fotografi nga Luigi Pellerano (1931)
"Të drejtat e grave" janë trashëgimia e këtyre tipave të ndryshëm.

[93] National Geographic Magazine, *'Recent Observation in Albania'*, shkruar nga George P.
Scriven , gusht 1918, faqe 103.

Të pasura dhe të varfëra, në qytet ose në malësi, gratë shqiptare janë të barabarta kur është fjala për t'u respektuar si në shtëpi, ashtu edhe përpara ligjit. Për shekuj të tërë gruaja shqiptare ka gëzuar prej një zakoni që nuk mbahet mend se kur është krijuar, një status ligjor të tillë që gratë në perëndim kanë luftuar dhe ia kanë dalë ta marrin vetëm në kohët moderne.

…shqiptari është i ndershëm, në mënyrë të veçantë, në qëndrimin ndaj grave. Thuhet se para luftës, një grua e vetme dhe e pambrojtur mund të udhëtonte e sigurtë nga njëri cep i Shqipërisë në tjetrin."[94]

Një vashë e maleve shqiptare

Trimi nga Shkodra

[94] Po aty.

Ndonëse, në përgjithësi, i janë përshtatur një farë besimi mysliman që u jep atyre gjoja një lloj solidariteti me turqit, shqiptarët janë të vendosur që edhe ata të kenë qenien e tyre kombëtare. Megjithëse janë të nëmur që të mbeten në prapambetje për shkak se gjithandej, ku më shumë e ku më pak, i ka shoqëruar feja myslimane, udhëheqësit e tyre e kanë kuptuar se ata nuk janë racë lindore por racë perëndimore; se veçoritë e tyre turko-myslimane, janë një cipë e jashtme dhe se nuk u duhet më shumë se një brez i shkolluar mirë që të hidhen përpara dhe të marrin vendin që u takon midis racave të qytetëruara që udhëhiqen nga ligji dhe nga rregulli në Gadishullin e Ballkanit.

VI

FEJA TE SHQIPTARËT

Siç dihet, feja luan një rol shumë të madh në jetën e çdo kombi. Edhe te ne, shqiptarët, ajo ka pasur një ndikim të madh, kuptohet. Megjithatë, ajo për të cilën shqiptarët krenohen dhe që udhëtarët e huaj e kanë vënë re, është fakti se shqiptarët e kanë çmuar njëritjetrin si vëllezër të një gjaku, ndërsa fenë një mjet për të ushtruar besimin te Zoti. Ndoshta shqiptarët janë i vetmi popull në Evropë ku nuk ka ndodhur asnjë përplasje ndërmjet bashkatdhetarëve që ushtrojnë fe të ndryshme. Le të shohim se si e ka pasqyruar këtë dukuri të shqiptarëve revista në fjalë, duke nisur nga shkrimi i Gjeneralit Amerikan George P. Scriven:

> "Sot shqiptari është personi më piktoresk në Evropë, tepër interesant në veçoritë e tij. E një rëndësie më të madhe është e ardhmja e tij politike. Vetëdija kombëtare e shqiptarit të kohëve të fundit po del në pah dhe nuk mund të ndrydhet më. Nën qeverisjen anormale turke, raca të ndryshme të krishtera të perandorisë, siç janë armenët otomanë, bullgarët otomanë dhe grekët otomanë, kanë pasur secili qenien e vet kombëtare, një shtet brenda shtetit, ndonëse përherë të nënshtruar ndaj vullnetit të turqve."[95]

[95] National Geographic Magazine, '*The Albanians*', nëntor 1912, faqe 1093.

Fotografi nga Theron J. Damon (1912)
Të krishterët e Shkodrës

Shamia e kuqe dhe mbulesa e qëndisur e grave të shtresave të larta (ajo në të majtë) janë më të bukurat.

Fotografi e vitit 1997
Pelegrinazh te Kisha e Shën Ndout në Laç

Shqipëria nën regjimin komunist ishte zhytur në izolim të thellë. Megjithatë shqiptarët kurrë nuk e humbën tolerancën fetare. Në Kishën e Shën Ndout në Laç, myslimanët dhe të krishterët, së bashku, i falen këtij vendi të shenjtë, të cilit i besojnë se u sjell shëndet e mbarësi.

Revista ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme njërën ndër karakteristikat më të rëndësishme të kombit shqiptar, paqen fetare. Për këtë i është kushtuar mjaft vend jo vetëm pranisë së tri feve në vendin tonë, por më shumë se kaq, paqes fetare që ekziston ndërmjet shqiptarëve. Njëri ndër autorët shkruan:

> "Ndonëse, në përgjithësi, i janë përshtatur një farë besimi mysliman që u jep atyre gjoja një lloj solidariteti me turqit, shqiptarët janë të vendosur që edhe ata të kenë qenien e tyre kombëtare. Megjithëse janë të nëmur që të mbeten në prapambetje për shkak se gjithandej, ku më shumë e ku më pak, i ka shoqëruar feja myslimane, udhëheqësit e tyre e kanë kuptuar se ata nuk janë racë lindore, por racë perëndimore; se veçoritë e tyre turko-myslimane janë një cipë e jashtme dhe se nuk u duhet më shumë se një brez i shkolluar mirë që të hidhen përpara dhe të marrin vendin që u takon midis racave të qytetëruara që udhëhiqen nga ligji dhe nga rregulli në Gadishullin e Ballkanit."[96]
>
> "Për shkak të ndikimit shekullor turk, Shqipëria Jugore dhe ajo Qendrore është ende e mbizotëruar prej myslimanëve. Populsia shqiptare ishte e tëra e krishterë por, për shkak se priftërinjtë nëpër kisha nuk lejoheshin të predikonin në gjuhë të kuptueshme për masën, kjo bëri që ata të tregoheshin të gatshëm për të përqafuar islamin, i cili u premtoi mbrojtje politike. Më shumë se dy të tretat e 833.000 banorëve të Shqipërisë tani janë myslimanë, ndërkohë që pjesa tjetër i takon ose kishës ortodokse greke ose asaj romake të krishterë."[97]Ja si e përshkruan George P. Scriven fenë te shqiptarët:

[96] Po aty.

[97] National Geographic Magazine, '*Albania, Newest Kindom of Europe*', shkurt 1931, faqe 142.

"Në kohën e sundimit të turqve, pjesa më e madhe e shqiptarëve, ndoshta tre të pestat, ishin myslimanë. Shndërrimi i popullsisë së sotme shqiptare myslimane në islam duket të ketë ndodhur gjatë shekujve të gjashtëmbëdhjetë dhe të shtatëmbëdhjetë. Prej të krishterëve, rreth një e gjashta janë katolikë romakë, ndërsa pjesa që mbetet janë ortodoksë ose përkrahës të kishës ortodokse greke. Në ndryshim nga paragjykimi popullor, peshkopët dhe priftërinjtë e Kishës Katolike mbajnë mustaqe dhe kanë tipare tipike të kishës luftarake.

Përpara pushtimit italian, arsimimi në Shqipëri ishte thuajse i paqenë; të dy palët, edhe myslimanët edhe katolikët ishin, dhe të rriturit ende janë, tërësisht analfabetë. Nën pushtimin turk, mësimet në gjuhën shqipe ndaloheshin për arsye politike. Një përjashtim i vetëm qe bërë në Korçë, në një shkollë të vogël amerikane për vajzat, të cilën pata rastin ta vizitoja."[98]

Fotografi nga Theron J. Damon, 1912
Shkodranë të krishterë duke dalë nga oborri i kishës.

Melvile Chater e përshkruan me nota romantike një natë që kishte kaluar në Teqenë e Gjirokastrës, kur shkruan:

[98] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P.
Scriven , gusht 1918, faqe 94.

"Asgjë nuk mund të ishte më e këndshme sesa pritja që na ofroi kreu i bektashinjve. I ulur këmbëkryq, mbi një qilim të bukur, në një dhomë të freskët e të gjatë të mbushur me mobilje, me turbanin e gjelbërt mbi kokë, i mbështjellë me një rrobë të bardhë, me mjekrën e thinjur krejt të argjendtë dhe me sy që i shkëlqenin, Baba Sulejmani vërtiste tespiet e verdha në njërën dorë, ndërsa Kuranin e mbante në dorën tjetër.

Selámet, fjalët e mirëseardhjes, kafja…, një shërbyes gungaç me hundë tejet të madhe që të kujtonte plotësisht Netët Arabe; ai përkulej gjithnjë e më shumë, sa herë që Babai i Teqesë thërriste: "Yahu" (O vëlla). Biseduam gjatë në lidhje me tolerancën fetare dhe me të vërtetën e përbashkët të të gjitha feve."

Por nuk është vetëm mikpritja ajo që e bën atë të shkruajë kështu. Vini re sesi e citon ai babanë e teqesë:

"Vetëm ajo që beson njeriu, bën që bota të ndahet në fe të ndryshme; vetëm ajo që ne ende nuk e kemi gjetur e për të cilën të gjithë jemi në kërkim, e bën njerëzimin të jetë një.

... Nuk ka rëndësi nëse "katër engjëjt që rrethonin krevatin tim" ishin të krishterë apo myslimanë, mjafton që ata sollën gjumin e ëmbël në sytë e dy udhëtarëve të lodhur…"[99]

Më tej ky udhëtar i palodhur citon babanë e teqesë si më poshtë:

"Është mëkat të jesh i ngopur, kur të tjerët janë të uritur. Është mëkat të mburresh për veten, ndërkohë që mohon gjërat e mira që bëjnë të tjerët.

"Babai na bekoi", - thotë Melvile Chater. - "Pastaj e lamë atë në përsiatjet e tij me sytë drejt malit. Në një farë mënyre kjo na kujtoi vargje nga Bibla. Psalltët hebrenj dhe hoxhallarët myslimanë – a janë ata vërtetë në kërkimet e tyre, të ndarë kaq keq?"

[99] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 142.

Shqiptarët janë popull mesdhetar që ndoshta rrjedhin prej ilirëve, mitologjia e të cilëve është e ndërlidhur me Greqinë dhe me Romën klasike.

Revista ka nënvizuar, gjithashtu, faktin më kuptimplotë të raporteve të fesë me kombin te shqiptarët, i cili vjen më së miri në këtë fragment:

> "Njerëzit në Shqipëri më parë ndihen shqiptarë dhe pastaj fetarë. Mosmarrëveshja midis tyre, më shumë midis të krishterëve dhe myslimanëve, ka qenë një prej të këqiave më të mëdha në të kaluarën; por kjo është frenuar deri në një farë mase. Trazirat fetare, nëse nuk do të ishin nxitur prej grekëve ose prej turqve, ndoshta, nuk do të kishin qenë më të mëdha se ato në Zvicër në të kaluarën ose në Irlandën e sotme. Grupet e veçanta, nëse lejohen të ekzistojnë, shpejt do të mësojnë të jetojnë në paqe. Në të kaluarën, nën sundimin turk, ligjet e të cilëve qenë bërë për t'u shkelur, nuk ekzistonte rendi. Dora e pushtetit të dënonte, por nuk të drejtonte. Kështu ndodhte që shkollat ishin lënë pas dore dhe njerëzit, në pjesën më të madhe, mbeteshin analfabetë. Turqve të rinj, ndoshta, u lejohej ose u ndalohej të ndiqnin shkollat që dëshironin, por shqiptarëve u ndalohej rreptësisht të ndiqnin shkollat në gjuhën e tyre. Fëmijët e tyre, nëse merrnin ndonjëfarë arsimi, mësonin në shkollat turke dhe greke. Përveç kësaj, fëmijët janë të mençur dhe ata që i pashë në shkollat italiane, ishin të etur për të mësuar dhe shumë të zgjuar."[100]

[100] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918.

Tani për tani, nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim të Shqipërisë, të gjitha shtresat e popullit – myslimanë dhe të krishterë – kanë një dëshirë, e cila mund të merret edhe si pasion – shkollimin kombëtar. Të gjithë ata e kuptojnë se, ashtu si në të kaluarën shpata ishte simboli i forcës, kështu është sot shkollimi, perëndia e fuqisë, dhe ata do të shkollohen edhe kundër përndjekjes që i shoqëron.

VII

PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR ARSIM

Problemin e arsimit në Shqipëri, amerikanët e kanë parë si një çështje shumë të rëndësishme. Njëri ndër të parët që ka shkruar në këtë revistë për shqiptarët dhe që në shkrimin e tij e ka trajtuar arsimin si çështje përparësore, është Theron J. Damon i Konstandinopojës.[101]

"As druri, as pushka, as topi, as forca, as burgu, madje as vdekja vetë nuk do të mund t'i mposhtin shqiptarët."

Folësi ishte një djalë i ri shqiptar, i cili një pjesë të studimeve e kishte kryer në SHBA. Tani është kthyer në vendin e tij, ku punon me zell të pashoq për popullin e vet. Ai është një ndër të paktët njerëz të shkolluar të Shqipërisë, por ka si qëllim të bëjë që brezi i ardhshëm i bashkëkombësve të tij të mos i numërojë shqiptarët e shkolluar me 'gishta'.

Fjalët e cituara më sipër parapriheshin nga këto fjalë:

"Tani për tani, nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim të Shqipërisë, të gjitha shtresat e popullit – myslimanë dhe të krishterë njësoj – kanë një dëshirë, e cila mund të merret edhe si pasion – shkollimin kombëtar. Të gjithë ata e kuptojnë se, ashtu si në të kaluarën shpata ishte simboli i forcës, kështu është sot shkollimi,

[101] Konstandinopoja dhe Stambolli.

perëndia e fuqisë, dhe ata do të shkollohen edhe kundër përndjekjes që i shoqëron.[102]

Shqiptarët kanë ardhur deri te vetëdija e nevojës që kanë për të përparuar dhe për t'u radhitur përkrah qytetërimit perëndimor. Kundër kësaj, që nga dita e parë kur doli kushtetuta e re osmane e Turqve të Rinj, u duk se këta të fundit kërkonin që qytetërimi të arrinte te shqiptarët vetëm pasi të kishte kaluar nëpër sitën turke dhe myslimane. Por ky plan nuk do të pranohej prej shqiptarëve edhe sikur turqit të shfaqnin dëshirën dhe zotësinë për ta zbatuar atë në mënyrën e duhur.

Gjatë 125 vjetëve para se të zbulohej Amerika, republika kryelartë e Venedikut ruante supermacinë dashamirëse në qytetet bregdetare të Shqipërisë dhe në rrethinat e tyre dhe kështu e vonoi për, rreth një shekull, ardhjen e ditës së sundimit turk. Me rënien e Shkodrës dhe me përzënien e venedikasve në vitin 1478, turqit filluan zotërimin e tyre prej katër shekujsh me mashtrime, me shkatërrimin e fesë dhe me mizori të gjithëllojshme. Thelbi i sundimit turk ishte t'i zhyste shqiptarët në një varfëri dhe gjakderdhje edhe më të thellë nga ç'i kishte zhytur historia e tyre prej malësorësh. Në rrjedhën e mijëvjeçarëve, valët shtytëse të përparimit nuk kishin arritur deri tek ata, madje as kishin kaluar pranë tyre, duke i lënë ashtu siç ishin, të paprekur."[103]

Por, për të arritur që të merrnin arsimin e duhur, shqiptarëve iu desh të kalonin sakrifica të mëdha. Në revistë gjenden disa tablo të përpjekjeve dhe të sakrificave për arsim të ndërmarra nga shqiptarët. Një ndër më mbresëlënëset është kjo që po japim më poshtë, shkruar po ashtu nga Theron J. Damon.

Shkollat qenë mbyllur duke përdorur dhunë fizike

[102] National Geographic Magazine, '*The Albanians*', shkruar prej Theron J. Damon, nëntor 1908, faqe 803.

[103] Po aty.

të bashkatdhetarëve të tyre të pamësuar anë e mbanë vendit. Ata përdornin gjuhën shqipe dhe, sipas votimit të një kongresi shqiptar të një viti më parë, e shkruanin gjuhën e tyre - gjuhë tërësisht evropiane – me gërma latine. Nën Abdyl Hamitin çdo përpjekje për të shkruar, për të botuar ose për të dhënë mësime në gjuhën shqipe mbytej me zjarr e hekur. Vetëm në shkollat e misionarëve austriakë dhe italianë në veri të Shqipërisë, të cilat bënin propagandën e tyre politike austriake dhe italiane, ata i shpëtonin përndjekjes së sulltanit.

Fotografi nga Theron J. Damon (1912)
Fëmijë shqiptarë në shkollën austriake

Për sa i takon alfabetit, politikanët austriakë, të cilët janë kthyer mbrapsht nga të gjitha bëmat e misioneve të priftërinjve austriakë dhe që kurrë nuk vonojnë që të shpiem përpara skemat e tyre, e shohin me dyshim të ardhmen e Shqipërisë. Mësimdhënësit, qofshin austriakë, qofshin italianë, duhet të përdorin të njëjtën gjuhë dhe të njëjtin alfabet. Deri tani është shpikur një alfabet i gjatë dhe i lodhshëm, që u është vënë në qafë

fëmijëve në shkollat e misioneve austriake. Kjo mund të bëhet shkak për mosmarrëveshje në të ardhmen, kur

Austria mund të ndodhë, ndoshta, që të dëshirojë të trashëgojë tokën e shqiptarëve dhe, për ta arritur këtë, i del e domosdoshme të vërë në lëvizje sa tiraninë, aq edhe mjetet për austriakizimin e shqiptarëve.

Shkolla Normale e Elbasanit me alfabetin e saj latin u çlirua nga propaganda e huaj, duke u kthyer në një fanar ndriçues në mes të errësirës që pllakoste Shqipërinë. Ajo nuk anon nga feja – myslimanët dhe të krishterët janë vëllezër pa dallim. Themeluesit i kishin vënë vetëm një qëllim vetes: lartësimin e racës shqiptare. Ata nuk ishin revolucionarë në kuptimin politik të fjalës. Ata donin të bashkëpunonin me *Turqit e Rinj* dhe kërkuan vetëm që zbatimi i kushtetutës së re të sapomiratuar të kishte diçka të përbashkët me premtimet e saj themelore.

Fëmijë shqiptarë, të cilët nuk kanë vajtur ndonjëherë në shkollat austriake.

Por, kur në verën e vitit 1910 në Elbasan arritën ushtarët turq, aty menjëherë u shpall gjendje e pushtimit ushtarak; të gjithë njerëzit që kishin lidhje ose që shprehnin simpati për përparimin e bërë, u ndoqën, u çuan përpara autoriteteve ushtarake dhe u rrahën në një mënyrë tepër të neveritshme për t'u përmendur me hollësi. Rrahjet

me thupra dhe me kamxhik në shputat e këmbëve u zbatuan ndaj shumicës së njerëzve të shkolluar të Elbasanit; thesari i shkollës normale u shkatërrua përtej asaj që besohet. Drejtori dhe disa mësues arritën të shpëtonin. Autoritetet ushtarake bastisën dhe fshikulluan personat që ishin përgjegjës për një telegram të dërguar, që më parë, në Konstandinopojë,[104] ku kërkohej që mësimet në shkollat shqipe të jepeshin në gjuhën shqipe dhe të shkruara me alfabet latin. Pastaj ushtarët marshuan për të njëjtën punë, duke bërë që shkollat të 'shuheshin' dhe atyre shqiptarëve t'u jepej një mësim që do të mbahej mend."[105]

Vetëm shkolla mund t'i zbusë shqiptarët

"E ardhmja e Shqipërisë nuk varet as nga Austria, as nga Italia apo nga Mali i Zi i mbështetur nga Rusia, as nga Greqia, madje as nga Turqia vetë, të cilat janë të vendosura që çdonjëra të shkëpusë një copë prej saj dhe çdonjëra të gjejë një zgjidhje që përmbush kërkesat e saj egoiste; ajo varet në masë të madhe tek arsimimi i atij populli, i cili duhet të kryhet para se fati i 2 milionë shqiptarëve të marrë një zgjidhje, që vështirë se mund të ndryshojë më. Me përjashtim të anglezes së guximshme *Miss Edith Durham*, për të cilën pjesët më të egra dhe më të rrezikshme të Shqipërisë kanë qenë një vend i veçantë i shkelur prej saj, askush tjetër nuk di më shumë për Shqipërinë se *Mr. James D. Bourchier*,[106] i cili ishte për një brez të tërë korrespondent special i *London Times* në Gadishullin e Ballkanit. Artikujt e tij, jashtëzakonisht të qëlluar mbi Shqipërinë, në botimin e ri të Enciklopedisë Britanike, pasi flasin për luftërat e grupeve të veçanta shqiptare për t'u shkundur nga zgjedha turke, vijnë te një përfundim i tillë: *"Rritja e një ndjenje më të gjerë patriotike duhet të shkojë paralel me shtrirjen e arsimimit gjithëpopullor".* Menjëherë, sapo arsimi

[104] Siç vihet re në origjinal nuk përmendet asnjëherë fjala Stamboll por Konstandinopojë, ndonëse në kohën kur është bërë ky shkrim, Stambolli ishte kryeqytet i Peranadorisë Osmane dhe njihej me emrin që kishte marrë që në kohën kur ky qytet historik qe pushtuar nga Sulltan Mohammed II, ose i mbiquajturi Fatih – Pushtuesi.

[105] Po aty.

[106] James D. Bourchier.

të shmangë pengesat që ekzistojnë, Shqipëria dhe shqiptarët do t'i marrin në dorë fatet e veta.

Shumë prej shqiptarëve të krishterë të qytetit të Shkodrës janë arsimuar dhe janë bërë të suksesshëm falë austriakëve dhe italianëve. Ata i frikësohen fanatizmit të vëllezërve të tyre myslimanë edhe kundër faktit që vetëm pak kilometra larg prej aty, në male, familjet e paditura malësore, si ato myslimane, edhe ato të krishtera, strehohen nën të njëjtën çati patriarkale; kështu edhe ritet myslimane, edhe ato të krishtera kremtohen brenda një ndërtese të varfër.

Pikërisht, përpara se të shpërndahej parlamenti, në janar të vitit 1912, një deputet shqiptar, zëdhënës kryesor i kombit të vet dhe tani udhëheqës i rebelëve, deklaroi: "Nëse turqit vazhdojnë t'i përçmojnë joturqit, atëherë ata do ta rrënojnë vendin. E them këtë sepse unë i dua turqit, ekzistenca e të cilëve është e nevojshme për ne, dhe me qëllim që ta ruaj ekzistencën e tyre." Deputeti shqiptar po fliste për popullin e vet."[107]

Për t'i bërë edhe më të qarta vështirësitë dhe pengesat që ka hasur arsimi në Shqipëri, rreth njëzet vjet më vonë, revista nëpërmjet shkrimit të Melvile Chater, na ka dhënë këtë përshkrim për sjelljen e germave të para të shtypshkronjës në Shqipëri:

"Nëse pengesa që islamizmi i bën ngritjes së statujave do të hiqej ndonjëherë në Shqipëri, unë shpresoj se Teodori i Elbasanit do të meritonte një pavdekësi mermerike. Luftërat e hershme të shqiptarëve, për të arritur të kenë gjuhën e tyre të shkruar, kanë qenë prekëse. Është e vërtetë që disa etër të hershëm të krishterë e kanë përkthyer me kujdes të madh *Imitatio Christi*[108] në një gjuhë të përbashkët. Por Mjeshtri Teodor ishte me të vërtetë një njeri i pathyeshëm. Duke

[107] National Geographic Magazine, '*The Albanians*', shkruar prej Theron A. Damon, nëntor 1908, faqe 1100.

[108] Imitatio Christi: Një prej këshillave më të përhapura në kishën e hershme ishte 'Imitatio Christi'. Kjo është shprehur në mënyra të ndryshme. Pali i nxit korinthasit: "*të më imitoni mua, siç e kam imituar unë Krishtin*". Në libra të tjerë të shenjtë thuhet se Krishti ju donte ju dhe për këtë e flijoi veten. "*Imitatio Christi*" u bë një mënyrë e rëndësishme për të shprehur përkushtimin ndaj kishës së hershme.

mësuar rreth një shpikjeje të çuditshme të cilën, sipas prirjes që ka njeriu, ia di për nder ose Zotit ose Djallit, ai iku në Venecia për t'i hetuar këto të dhëna. Kur u rishfaq në Shqipëri, bagazhi i tij përbëhej nga një numër i madh arkash të vogla. Por çfarë kishte ai vërtetë në to, që i ruante me aq fanatizëm dhe xhelozi dhe që peshonin aq rëndë? 'Dukate veneciane!' Ishin pikërisht ato arka, për të cilat u vra Mjeshtri Teodor, ndërsa arkat u plaçkitën.

Jo flori, por pjesë të panumërta metalike u dolën vrasësve përpara. Mallkuar! Por, prit! Çfarë shkronjash të çuditshme kishte në ato kuti të vogla? Magji sigurisht! Kishin të bënin me djallin! Gangsterët supersticiozë ia mbathën, duke e lënë Teodorin me fytin e prerë të rrethuar prej gërmave të shtypit. Kështu ndodhi ardhja e gërmave të shtypit në Shqipëri."[109]

Më tej, në shkrimin e tij, Melvile Chater i kushton arsimit edhe këta paragrafë me titull:

Shqipëria ka nevojë për arsim

"…Të tilla janë problemet ekonomike të rinisë së mbretërisë, pavarësia e së cilës, ndonëse qe njohur në vitin 1912, humbi përkohësisht gjatë Luftës Botërore[110] dhe pastaj u rifitua në vitin 1920. Në vitin 1928, Republika u bë Mbretëri. Një gjë është e sigurtë: Qeveria shqiptare qëndron dhe mbështet fuqishëm vendosmërinë e rinisë shqiptare për t'u arsimuar. Tani vendi ka rreth 600 shkolla fillore dhe unike, për të mos përmendur shkollat teknike të drejtuara prej amerikanëve dhe organizatave të tjera të huaja.

Por, prapëseprapë, mund të thuhet se nevoja për arsim është tejet e madhe. Kur një zyrtar i shtetit shqiptar ta kthen me mirësjellje një letër të shtypur në makinë shkrimi, ngaqë nuk di ta lexojë, njeriut i

[109] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 156.

[110] Autori i referohet Luftës së Parë Botërore vetëm si Luftë Botërore, pasi deri atëherë kishte ndodhur vetëm një luftë e tillë.

falet nëse nuk e fsheh dot habinë. Nga ana tjetër, kur një zyrtar tjetër civil, i mësuar me punë të rëndë fizike, i hyn me zell të madh mësimit të abetares, atëherë nuk mund të rrihet pa e duartrokitur."[111]

[111] Po aty.

... Si edhe ilirët e lashtë, malësorët vazhdojnë të praktikojnë rruarjen e kokës...

VIII

EPIKA E JETËS SHQIPTARE

Udhëtarëve të revistës *National Geographic* nuk u ka shpëtuar as bukuria, por as epika dhe ashpërsia e jetës shqiptare, sidomos në Malësi.

Një ndër përshkrimet më të bukura në tërë revistën gjendet në shkrimin e Melvile Chater:

Foto nga Theron Damon, 1912
Skenë rruge në Shkodër

"Në fshatin Shkrel, pasi lamë pas fushat dhe luginat, ia morëm dalngadalë përpjetë drejt maleve të largëta, profilet e zigzakeve të të cilave puqeshin me qiellin. Gjashtë orë më vonë arritëm te kisha e Bogës, ku shumë gra dhe burra po merrnin pjesë në një shërbesë fetare. Aty armët ishin renditur njëra pas tjetrës te dera e kishës si në një armaturë reparti ushtarak.

Në oborrin e kishës takoheshin përfaqësuesit hijerëndë, madhështorë të fiseve të Kastratit dhe Kelmendit. Për syrin e vendasit, janë dallimet midis kostumeve ato që 'tregojnë' pozitën e një burri të një fisi ndaj një tjetri, njësoj siç ndodh aq pagabueshmërisht edhe me ndryshueshmëritë e fustanellës dhe të stofit, që përcaktojnë shkallën shoqërore te malësorët skocezë.

Një burrë, sa një lis me rrema i afrohet udhërrëfyesit tonë. Janë burra të fiseve të Hotit dhe të Dukagjinit. Ata shkëmbejnë përshëndetjet malësore kokë më kokë. Pas kësaj mësojmë se është bajraktari i zonës që na ka dalë përpara dhe, që prej këtij çasti, ne jemi në besën e tij."[112]



Fotografi nga Melvile Chater (1931)
Udhëtarët e revistës në luginën e Shalës

[112] National Geographic Magazine, '*Albania, Newest Kingdom of Europe*', faqe 166.

PISKAMA SI MJET 'KOMUNIKIMI' NË MALE

Piskama është vlerësuar si mjet komunikimi *pa tel* i malësorëve. Ja me çfarë force e ka përshkruar këtë dukuri udhëtari i revistës National Geographic:

> "Shumë më përpara se të na zinte nata, të shoqëuar nga një truprojë e fuqishme, e përbërë prej tetë vetësh të armatosur, ikëm nga Boga. Ata ishin djem të fuqishëm, të gjatë sigurisht, që shprehnin madhështi, gjysmë të egër, të rekrutuar në xhandarmëri sipas programit qeveritar të reformave për t'i futur njerëzit e papunë në listë - pagesa.

Foto nga Theron Damon, 1912
Malësorë Shkodranë në qytetin e Shkodrës

…Herë pas here, ata që ishin pranë nesh lëshonin nga një piskamë tipike malësore që i drejtohej xhandarmërisë, e cila ishte diku e fshehur nëpër majat e kodrave dhe maleve për rreth.

Piskama e malësorëve mund të vlerësohet si një komunikim 'pa tel' që përçohet nga një majë mali te tjetra dhe, prej andej, nëpër lugina, duke arritur që, te banorët e çdo fshati, të japë lajmin për çdo gjë me rëndësi që ata mendojnë se duhet bërë e njohur. Dhe e tëra kjo ndodh brenda një kohe të shkurtër, në një rajon që ne na mori një javë për t'i ardhur rreth.

Lulashi, një prej rojeve tona, na shpjegoi se piskama bëhet gjithmonë sipas një kodi me pak fjalë, si p.sh: Heeeeeeej, 'si jeni ju andej?', ose 'na ka ardhur një mik', ose 'është vrarë ose ka vdekur dikush', 'një familjeje të caktuar i ka lindur një djalë'. Ai na tha se zëri i malësorit, edhe nëse nuk i dallohen mirë fjalët veç e veç, prapëseprapë është i dallueshëm si zë, sepse është i ndryshëm në varësi të lajmit që përhap dhe i kuptueshëm deri në pesë kilometra largësi në vijë ajrore."[113]

KUMBARIA NË SHQIPËRI

"Pas pak Pjetri na shpjegoi se mikpritësi ynë ishte 'kumbara i tij i flokëve'. Si edhe ilirët e lashtë, malësorët vazhdojnë të praktikojnë rruarjen e kokës. Në ceremoninë e qethjes së parë, e cila bëhet kur fëmija është rreth 2 vjeç, kumbara përdor gërshërën. Nëse fëmija është i besimit të krishterë, kumbara i pret katër fije floku dhe ia vendos në formë kryqi përmbi kokë. Nëse fëmija është mysliman, atëherë kumbara pret tri fije dhe ia vendos në formë trekëndëshi, po ashtu mbi kokë. Kjo bëhet, thjesht, si gjest kumbarie. Më pas, qethjen e mëtejshme mund ta kryejë kushdo nga familja.

Personat që rrjedhin nga një paraardhës i përbashkët mashkull, pra në linjë mashkullore, e konsiderojnë njëri-tjetrin vëllezër dhe çdo lloj martese brenda fisit është e përjashtuar. Të rinjtë, po kështu, mund të betohen për vëllazërim dhe kjo pastaj i detyron burrat dhe pasardhësit e tyre për breza të tërë të respektojnë të njëjtin ligj martese që do të kërkonte edhe marrëdhënia ndërmjet njerëzve të një gjaku.

Personat që kanë lidhje nëpërmjet të njëjtit kumbar, nuk mund të martohen. Kumbarët janë dy llojesh: ai i pagëzimit dhe ai i flokëve. Kur një fëmijë, djalë ose vajzë qoftë, bëhet rreth dy vjeç dhe flokët nuk i janë prerë asnjëherë me gërshërë, qethja e tyre bëhet me festë të madhe. Kumbara bën prerjen e flokëve duke i lënë, nëse fëmija është i krishterë, një krrelë në të katër anët rrethore të kokës, duke formuar

[113] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater shkurt 1931, faqe 175.

kështu një kryq, ndërsa, kur fëmija është mysliman, tri krrela që formojnë një trekëndësh."[114]

KOSTUMET - LASHTËSIA SHQIPTARE

Revista *National Geographic*, por edhe studiues të tjerë amerikanë u kanë kushtuar vend të posaçëm kostumeve shqiptare. Pothuajse çdo udhëtar i hershëm është ndalur dhe e ka komentuar bukurinë e kostumeve tona. Në vijim po japim përmbledhje të disa prej vlerësimeve të bëra për to:

Foto nga Gjen. George P. Scriven (1918)
Valle delvinjote

Fustanella shqiptare e burrave që zbret deri në gju, me brezin e lidhur në mes dhe me tamburxhiun që aq bukur i këndon Bajroni, mund të shihet më rrallë tani, pasi njerëzit edhe këtu e gjejnë më të lirë dhe më të lehtë të vishen me stofra të sjella nga Evropa Perëndimore.

[114] Po aty, faqe 179.

"Kostumet e tyre janë nga gjërat më interesante që mund të shohë njeriu e që janë ende në përdorim. Ato të burrave përbëhen prej zhguni të bërë me punë dore, në dukje të puthitura pas trupit, me formë mesjetare, të zbukuruara me gajtana të zinj, me jelekë të hapur, me shoka të qendisura që lidhen në mënyrë të përdredhur zig- zake, me një lloj xhoke të zezë pa mëngë të bërë prej leshi, me një jakë të dytë të rrafshët dhe me kokën e mbuluar me qeleshe të bardhë. Xhoka e zezë vishet në kujtim të Gjergj Kastriotit ose Skënderbeut, njërit prej luftëtarëve më në zë të këtij vendi. Ai i bashkoi fiset dhe ia doli ta mbante vendin e vet të papushtuar deri në vitin 1467. Populli shqiptar ende edhe sot e mban të gjallë kujtimin e tij me aq dashuri, sa çdo mëngjes vesh këtë rrobe që i kujton atë. Gratë veshin të njëjtin zhgun të ashpër me funde të bardha dhe të zeza duke i ndërthurur brezat e gajtanit në xhubletat e gjata të zbukuruara me mjeshtëri. Në çdo cep të atij kostumi ngjyrat gjejnë një harmonizim të përsosur ku spikat sidomos, e kuqja dhe e kaltërta. Por edhe më e vjetër se kjo është veshja e burrave dhe e djemve të qytetit që vijnë nga shtresat e thjeshta – një bluzë e gjatë e bardhë dhe tërheqëse e ngjitur rreth mesit me brez të kuq dhe një kësulë e kuqe. Këtë kostum, pa kësulën, e gjejmë të vizatuar dhe të paraqitur si kostum i barbarëve në vazot greke dhe romake."[115]

Ja si i përshkruan revista kostumet kombëtare në një ditë pazari në Shkodër:

"Ditë pazari. Çfarë skene magjepsëse! Me siguri që nuk ekziston askund tjetër në Evropë një përqendrim kaq i madh i shumëngjyrshëm malësorësh, kostumesh dhe punëdoresh. Për t'i fiksuar tërë këto mrekulli, një fotografi i duhen, të paktën, katër duar dhe dy mendje.

Këtu edhe njeriu më i pavëmendshëm bëhet të flasë me veten, i nxitur nga gëzimi që shkakton kjo bukuri. Njerëzit janë të veshur me rroba që vijnë nga thellësitë e kohërave. Burrat veshin jelekë të zinj në nderim të kujtimit të Skënderbeut dhe mbajnë qeleshe të bardha si bora e maleve nga vijnë.

[115] National Geographic Magazine, 'W*here East Meets West*', faqe 331.

Gratë ngjeshin rripa ose më mirë korse, vende-vende të dekoruara me copëza metali të qëndisura me gajtan kuq e zi, të cilat përthekojnë trupin dhe vijnë deri te gjoksi.

Burrat përdorin, gjithashtu, një shokë zbukuruese me të cilën mbështjellin mesin e trupit. Ja, atje matanë është një burrë, i cili sjell rreth vetes një spirale me vija ngjyra-ngjyra që shkon deri në tokë; njëri cep i saj është larg tij, ndërsa tjetri është fiksuar në brez. Duke parë këtë skenë, njeriut i duket se sheh përdredhjen magjepsëse të trupit të Mbretit të Pythnos[116]. Por, sapo, afrohet zbulon se s'është gjë tjetër veçse një malësor shqiptar i veriut, i cili përpiqet të ngjeshë shokën e tij 15 këmbëshe të gjatë."[117]

Rrobat e grave shkodrane janë të pasura si në ngjyra, ashtu edhe në qëndisje. "Industria e tyre kryesore është prodhimi i kostumeve," shkruante një udhëtar i shekullit të nëntëmbëdhjetë në lidhje me shqiptarët. "Coha shpesh zbukurohet me gjëra të arta." Dhe në një rast tjetër:

"Shqiptarët e veriut janë gjithmonë të dallueshëm në rrobat e tyre kombëtare. Burrat veshin tirq, zakonisht të bardhë të ngjeshur pas trupit. Në të dyja anët shtrihen shirita gajtani të zi zbukurues. Po ashtu, zbukurimet e gajtanëve arrijnë në fund të këmbëzës së tirqve. Një shokë e bukur me vija ngjyra-ngjyra lidhet për mesi duke u bërë kështu edhe mbajtëse e pistoletës dhe e jataganit. Jeleku i shkurtër, i zbukuruar në mënyrë të përsosur, arrin deri sipër brezit, por nuk bashkohet asnjëherë përpara, duke ruajtur një largësi prej pesë gjashtë gishtërinjsh.

[116] *Pythnos*, një lloj gjarpri i përshkruar në antikitet për bukuritë e tij zbukuruese. Ai është gjarpri që rrethon kokën e Meduzës në mitologjinë greke.

[117] National Geographic Magazine, *'Albania, Europe's Newest Kingdom"'* shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 166.



Fotografi natyrale me ngjyra nga Luigji Pellerano (1931)
Kostume popullore të qyteteve malore dhe atyre fushore

Gjirokastrën e përfaqëson ky burrë në anën e djathtë, ndërsa Shkodrën kjo grua në të majtë. Të dyja qytetet vijnë prej thellësisë së lashtësive. Ka një lëvizje për t'i kthyer kostumet klasike shqiptare të përdorshme edhe si veshje të përdorimit zyrtar.

Në Shkodër kostumet popullore përbëjnë një ndër bukuritë më të mëdha të festave.

Kostumet popullore ndryshojnë, në mënyrë të dukshme, në pjesë të ndryshme të Shqipërisë. Në jug të Shqipërisë, burrat veshin fustanella të ngjashme me ato që vishen në veri të Greqisë."[118]

Ndërkohë, ja si i ka përshkruar kostumet shqiptare Goerge P. Scriven:

"Rrobat e bukura kombëtare të shqiptarëve vishen në raste festash, kur burrat vijnë me tirq të bardhë të ngjeshur pas trupit, me xhokë e xhamadan të bërë prej leshi të bardhë, opinga me xhufka dhe me kapuçë të bardhë dhe të kuq, dhe, zakonisht, sidomos në kohë me shi, me gunën të bërë prej postiqe dashi, shpeshherë të zezë. Qeleshja vihet, sidomos, në rastet kur ajo simbolizon racën dhe kombin shqiptar."[119]

Fotografi nga Luigi Pellerano (1931)

Këto veshje popullore mirditore, me ngjyrat e tyre, janë trashëguar që nga koha e Skënderbeut.

Kohët e fundit, në Muzeun e Kombeve në Washington DC, përkrah trashëgimisë më të mrekullueshme të njerëzimit, është ekspozuar edhe një jelek shqiptar. Për këtë jelek në muze është shkruar si më poshtë:

[118] National Geographic Magazine, '*Notes on Macedonia'*, nëntor 1908, faqe 796.

[119] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Schriven , gusht 1918, faqe 103.

"Në Shqipëri, jeleku është një rrobë që e veshin edhe burrat edhe gratë. Ai është pjesë e kostumit tradicional të përbërë prej këmishës, tirqve dhe shokës. Ky jelek përbëhet prej kadifeje të përshkuar nga fije mëndafshi me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë. Ai është i tëri i mbuluar me fije të thurura prej ari. Thurjet bëhen prej fijesh ari të gjata, të ndërthurura edhe me mëndafsh. Për shkak të vlerës së saj dhe të trashësisë që e karakterizon, kjo thurje i ngjitet vetëm pjesës së sipërme të jelekut, pa kaluar në anën e kundërt të tij. Ajo shtrihet në anën e qëndisur me tegela mëndafshi që përshkojnë stofin. Jeleku ka 24 komça, të cilat janë të mbështjella me fije të qëndisura prej ari dhe rruaza merxhani. Kopsat nuk shërbejnë për ta mbyllur jelekun; ato janë pjesë tradicionale e endjes dhe shërbejnë vetëm për qëllime zbukurimi.

Tregu më i afërt për malësorët e Mirditës shpaloset në trajtën e vet festive të përjavshme në qytetin e lashtë të Lezhës. Aty xhaketat e qëndisura me dorë (faqja më pas), përparëset dhe hejbet sillen për t'u shitur në qytet. Bukuria e këtyre mallrave flet vetë dhe shitësit, shumë rrallë, përpiqen të bëjnë ndonjë reklamë.

Fotografi e vitit 1931
Punë dore të shndritshme në tregun e Lezhës





Fistar në vendin e 'Bijve të Shqipes'

Ky është bajraktari, një prej krerëve patriarkalë të rendit fisnor të vendit të tij të lashtë. Emri Shqipëri do të thotë: 'Tokë e Njerëzve të Shqipes'.

Fotografi nga L. F. Hurlong (1931)
Rrobat e nuseve shqiptare janë të zbukuruara me monedha floriri.

Nuset shqiptare mbajnë në kostumet e tyre jo vetëm dhuratat e bëra për martesë, por edhe dhurata të tjera prej floriri, të cilat përcillen brez pas brezi.

Fotografi e vitit 1931 nga Luigi Pellerano
Kostume vajzash mirditore



Fotografi nga Luigi Pellerano
Kostume që vijnë prej mijëvjeçarit të kaluar.

Xhaketa pa mëngë e grave, e ngrirë dhe e stolisur me fije ari, paraqet mbijetesën e zbukurimeve të parzmoreve. Fustanella që veshin burrat, është relike e kohëve greke dhe romake.

Fotografi natyrale me ngjyra nga Luigi Pellerano
Në Shqipëri mikut i urohet mirëseardhja me llokume, kafe ose ëmbëlsira.

Megjithëse nuk është bërë ndonjë regjistrim i popullsisë, vlerësohet se shqiptarët, në tërësinë e tyre, janë rreth dy milionë e gjysmë njerëz. Atdheu i tyre është një vend i mrekullueshëm, i cili, me shpërndarjen e çrregullt të maleve, me luginat e thella dhe pjellore, si dhe me përrenjtë e rrjedhshëm - edhe pse pa shumë zona pyjore - prapëseprapë mbetet madhështor në vrazhdësinë e tij mahnitëse.

Shqipëria është vendi më romantik në Evropë, ndoshta edhe në botë.

IX

BUKURITË E NATYRËS SHQIPTARE

Autorëve amerikanë u ka tërhequr vëmendjen natyra e bukur shqiptare, prandaj edhe kanë bërë përshkrime mbresëlënëse. Po veçojmë tri prej tyre:

Fotografi e vitit 1931
Mbledhësja e vogël e shkarpave

Kjo vajzë e vogël malësore nga Shala vishet me rroba të bëra me material të leshtë të punuar me dorë në shtëpi.

Fotografi e vitit 1931
Një treg qilimash në Shqipërinë e Mesme

Gjatë pushtimit turk Shqipëria zhvilloi mjeshtrinë e endjes së qilimave, të cilët i kanë ruajtur deri vonë elementet zbukuruese vendase.

Fotografi nga Melvile Chater (1931) Një barí
nga Toskëria duke i rënë gajdes.

Kjo është një gajde antike persiane, greke dhe romake, më vonë bretone, gjermane, kalabreze dhe kelte. Historikisht ajo është përdorur si mjet thirrjeje për luftë, për mobilizim të kavalerisë, madje, edhe për të shprehur dashurinë. Zëri i mprehtë i gajdes dëgjohet edhe sot e kësaj dite aty ku çobanët toskë ruajnë tufat e tyre në Jugun e Shqipërisë.

"Megjithëse nuk është bërë ndonjë regjistrim i popullsisë, vlerësohet se shqiptarët, në tërësinë e tyre, janë rreth dy milionë e gjysmë. Atdheu i tyre është vend i mrekullueshëm, i cili, me shpërndarjen e çrregullt të maleve, me luginat e thella dhe pjellore, si dhe me përrenjtë e rrjedhshëm - edhe pse pa shumë zona pyjore – prapëseprapë mbetet madhështor në vrazhdësinë e tij mahnitëse."[120]

LIQENI I SHKODRËS

"Ne ndoqëm rrjedhën e Rjekës, fshati i liqenit, i quajtur kështu prej Ivan Beg Cernovic (rjekë do të thotë lumë), i cili sundoi në pjesën e dytë të shekullit të pesëmbëdhjetë dhe e kishte ndërtuar kryeqytetin e tij në këtë rrethinë. Këto ishin vitet më të errëta për malazezët dhe Ivani ishte detyruar t'u jepte turqve fushat pjellore të Zetës, ndërsa vetë duhej të ikte me forcë në malet e mbyllura, ku edhe themeloi Çetinjën në vitin 1484. Ai ndërtoi aty një kështjellë për mbi Rjekë, për të përforcuar kufijtë e tij të rinj, dhe u betua se do ta mbante Malin e Zi me çdo kusht. Sundimtar sa i zgjuar, aq edhe luftarak, ai themeloi aty një manastir dhe nisi të botonte libra që nga Venecia, vetëm njëzet vjet pasi libri i parë ishte shtypur në Londër prej Kakstonit.[121] Tradita popullore thotë se ai vetëm sa kishte rënë të flinte dhe do të zgjohej një ditë për të udhëhequr popullin e vet në orën e tyre të nevojës."

Para luftës, Liqeni i Shkodrës ishte ndarë në dysh me vijë kufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. I rrethuar prej malesh, shumë prej të cilave janë të mbuluara me borë, thuajse gjatë tërë vitit, ujërat e tij të pastra janë të pikëzuara prej një numri të madh ishujzësh. Liqeni i Shkodrës është njëri prej më të bukurve në Evropë dhe, nëse aty do të arrijnë ndonjëherë hekurudhat dhe hotelet moderne për turistët, ai do të jetë një rival shumë i fortë i Liqenit Como në Gjenevë. Liqeni ka 135 milje katrorë dhe është tejet i rrezikshëm për mjetet e lundrimit gjatë motit të keq.

---

[120] Po aty, faqe 94.

[121] *William Caxton* (1422-1491) ishte i pari që shtypi një libër në anglisht sipas teknologjisë së shtypshkronjës Gutenberg.

Fotografi nga Katrice Nicolson (1918)
Një udhëtim me lundër në Liqenin e Shkodrës

"Por për ne, më e rëndësishme se historia e së shkuarës, tani mbetej mënyra se si do të bënim për transportin, kështu që nxituam të mësonim nëse varka do të mund të, lundronte në liqen apo jo. "Jo, jo, ajo ishte prishur. Çfarë do të bënim?" Nëse do të ktheheshim prapa, atëherë na duhej të prisnim kushedi sesa dhe nuk do të arrinim për të parë pazarin e së mërkurës në Shkodër, për të cilin kishim bërë aq shumë rrugë, vetëm e vetëm, që të ishim aty në kohën e duhur. Pastaj na u tha se, nëse bëheshim mjaft udhëtarë, atëherë lundrën tonë do ta tërhiqte një varkë tjetër me rremtarë, të cilët e njihnin vijën ujore. Një trap për të lundruar dhe, fatmirësisht, dy zotërinj italianë dhe një numër fshatarësh e plotësuan numrin, ndërkohë që ne, të huajt, ia dolëm të vendoseshim në ballë, fshatarët në pupë të barkës dhe kështu u shkëputëm për të marrë rrjedhën dredha-dredha të rrymës së ujit përmes masës së zambakëve të bardhë, ujërave, xunkthit e kallamave, duke u përpjekur që të përparonim me guxim në këtë liqen të dashur vetmitar. Çafka të mëdha, shpendë peshkngrënës, si dhe shpendë të tjerë fluturonin mbi kokët tona duke na shoqëruar gjatë tërë udhëtimit. Ne morëm kthesën dhe u kthyem për pak kohë dhe, pasi kaluam një ishull të përforcuar, dolëm në liqen të hapur. Prapa po linim Malin e

Zi, ndërkohë që masivet malore të Bjeshkëve të Nemuna të Shqipërisë po shfaqeshin si masiv i ngjashëm me vetë retë, një peizazh irreal hapësirash të largëta."

Fotografi e vitit 1912
Lundër në Liqenin e Shkodrës

Përpara se Fuqitë Evropiane të pajtoheshin, në vitin 1912, që Shqipëria të bëhej komb autonom, Shkodra ishte kryeqyteti i Vilajetit Turk. Pavendosmëria e Konstandinopojës mbi Shqipërinë i solli asaj shumë probleme.

"U bënë disa ndalesa në Virbazar dhe Plaunitza për të marrë dhe për të lënë udhëtarë; në Virbazar mezi e bindëm kapitenin të na çonte drejt brigjeve që të merrnim postën, për të cilën ai duhej të kishte durim të na priste, të paktën, katër orë. Kështu, me kapitenin dhe me ndihmësin e tij, ne vajtëm dhe e morëm pakon e duhur. Qyteza ishte e bukur dhe u habitëm kur aty gjetëm edhe disa evropianë, veçanërisht gra, të cilat rrallë shiheshin në atë vend.



Fotografi nga Katrice Nicolson (1918)
Në ujërat e cekëta të Liqenit të Shkodrës

Fotografia nga Katrice Nicolson (1918) Ultësira e
qytetit të Shkodrës.

U ulëm në cep të një pijetoreje të vockël nën hijen e një peme të lashtë gjetherënë. Kapiteni dhe ndihmësi i tij, të mësuar me zakonet e malazezëve, filluan, pa e zgjatur, të pinin në gotat e rrethuara me plot zhul. Por çupëlina që na shërbeu, u duk se e kuptoi që ne nuk ishim

mësuar me gjëra të tilla dhe me mirësjellje u dha gotave një të fshirë rreth buzës së tyre, ndonëse edhe gishtat e saj nuk ishin më të pastër.[122]

Qyteti kishte disa pamje tërheqëse, ndërkohë që fortifikimet në kodër dukeshin se ia vlenin t'i vizitonim. Dielli po na përvëlonte pa mëshirë, por ne u dhamë pas pazarit të rrethuar prej tërë banorëve të atyshëm, ku secili, në mënyrën e vet, përpiqej të na këshillonte çfarë të blinim.



Fotografi nga Franc Bespalatk (1931)
Një urë me shumë harqe lidh dy anët e lumit Osum në Berat.

Ujërat e Osumit, një rajon pjellor i jugut, mbajnë gjallë me vaditje fushat e ullinjve dhe të fiqve, të vreshtave dhe të duhanit.

Deri në këto çaste gjithçka që kishim bërë e kishim bërë me shenja, por papritur turma i hapi rrugën një burri me trup të fuqishëm që kishte një shami në dorë me disa gjëra të mbështjella në të. Ai dinte ca fjalë gjermanisht që ia kishte mësuar i ati, i cili 'kishte parë botë', pasi kishte qenë dikur në një krahinë austriake.

Më në fund posta erdhi, kështu që ne hipëm përsëri në barkë për të vazhduar udhëtimin. Liqeni u hap, të njëjtat kodra me gurë vazhdonin ta rrethonin atë pa një shenjë banimi në atë rrugë prej afro shtatëdhjetë

[122] National Geographic Magazine, '*Where East Meets West*', faqe 327.

kilometrash. Dielli po perëndonte duke përflakur rrezet e tij të mrekullueshme si flakë të përhumbura vezulluese mbi ujin e qetë të përzier edhe me hijet e rënda të maleve në një peizazh magjepsës. Dalngadalë hëna po ngjitej dhe ne lamë pas një anije ushtarake të sulltanit, në të cilën valvitej flamuri me gjysmë hënë. Pas gjashtëmbëdhjetë orësh lundrimi zbarkuam në Shkodër ose në Scutari – Albanese – siç është vënë në hartat tona. Lundra të mëdha arritën te varka jonë dhe njerëzit na ndihmuan të shkarkonim pajisjet tona. Gjithçka bëhej me zhurmë dhe në errësirë të plotë, një skenë tipike doganore orientale. Ne ia dolëm që ta kalonim pa kontroll kodakun dhe ca libra, pasi i dhamë një farë bakshishi shumë të mirë doganierit dhe pastaj, të shoqëruar nga kapiteni ynë, u nisëm për në një han ku mund të gjenim prehje pas asaj dite të gjatë.

Shkodra gjendet në fund të liqenit në mes të një fushe të gjerë, që në atë fund gushti ishte e tharë dhe e pluhurosur. Qyteti ka një popullsi prej rreth 40.000 banorësh dhe vlerësohet prej shqiptarëve si qyteti më i bukur në botë. Ai është një qytet i zymtë, i gjithi lindor, dhe zotëron tërë magjinë e vet, sepse ne jemi në një vend dhe midis një populli, zhvillimi i të cilit është ndalur që në Mesjetë dhe nuk ka bërë përparim as në ide, as në zakone, as në format morale të asaj kohe. Këtu nuk ka shenja të perëndimit, ose të qytetërimit modern, siç mund të shohë njeriu në kontrast me Botën e Vjetër në shtete të tjera ballkanike. Shtëpitë janë fshehur pas mureve rrethuese me çati të varura mbi to me tjegulla ngjyrë kafe dhe me grila dritaresh blu ose të gjelbëra piktoreske; ca shtëpi kanë kopshte me hardhi dhe pemë që e nxjerrin kryet hijshëm përmbi mure. Qyteti ka disa xhami, por minaret duken nga larg.

Shqiptarët janë të njohur si pasardhësit e banorëve më të lashtë të Gadishullit të Ballkanit, të cilët gjenden aty që përpara grekëve dhe romakëve dhe nuk janë të lidhur me ndonjë popull tjetër ballkanik.
Perandorí dhe qytetërime kanë kaluar mbi të, por ata kanë ecur në mënyrën e tyre të vështirë duke i pranuar sundimtarët sa për emër, vetëm sa për emër. Ata flasin një gjuhë që nuk është e shkruar.[123] Kanuni i jetës dhe i nderit të tyre është mesjetar, ndërsa krenaria e tyre më e madhe është se ata kurrë nuk e kanë tradhëtuar mikun dhe kurrë nuk e kanë kursyer armikun. Të luftuarit është vetë jeta për ta dhe për këtë arsye ata kanë qenë shumë të përdorshëm për sulltanin. Duke luftuar në ushtrinë e tij, ata kanë marrë si shpërblim paprekshmërinë nga taksat në vendin e vet. Në qoftë se

[123] Edhe ky autor duket se nuk e njeh historinë e të shkruarit të gjuhës shqipe.

do të pyesësh për duhanin që futet kontrabandë për t'u shitur në pazarin e Shkodrës, do të thonë: "Ne shqiptarët nuk paguajmë taksa, pse duhet ta bëjmë këtë?"

Jo vetëm guximtar, por edhe burrë i zoti, shqiptari mëson shpejt kur i jepet mundësia ta bëjë këtë, siç është i mprehtë dhe i suksesshëm edhe në biznes, sapo t'i shpëtojë mallkimit të turkut, i cili e mban atë në një gjendje naive e mizore.

Pazari është vendi më tërheqës i Shkodrës. Ai shtrihet përgjatë lumit, një vend i ngatërruar e i ngushtë, me rrugë të shtruara keq, me lugje që i ndajnë mes për mes ku ecin kafshët e ngarkuara, me baraka të vogla që shpesh nuk janë më të gjera se gjashtë këmbë. Skena e tregut është e papërshkrueshme dhe të mahnit tërë kohën me ngjyrat që vezullojnë, me rrugicat e ngushta që gumëzhijnë nga një jetë të cilën stërgjyshërit tanë, gjithashtu, duhet ta kenë përjetuar në periudhën e zgjimit nga errësira mesjetare.

Këtu secilës rrugë i është dhënë një zanat i veçantë, bie fjala, njëra është rruga e furrtarëve, tjetra e kasapëve, tjetra më tej e armëtarëve, tjetra e veshjeve e kështu me radhë. Më tej gjendet një kabinë e veçantë e ruajtur për malësorët. Dyqanet e pajimeve janë të stërmbushura me lëkurë të çdo lloj ngjyre, me kostume festive, me kapistra dhe zbukurime me rruaza që u vihen në ballë kuajve për të prishur syrin e keq. Aty gjenden gjithfarë zbukurimesh të bëra me dorë për gratë, ku përfshihen gjerdanë prej argjendi, copëza metali, monedha të ndryshme, të cilat si askund në botë, përdoren prej grave për zbukurime. Kallajxhinjtë bëjnë tregti të madhe këtu, duke i dhënë pazarit një prej zhurmave më interesante. Por vendi më i zënë me punë mbetet një kënd që mbahet për kafe e ku, gjithçka, gëlon si në një koshere bletësh.[124]

Dhe më pas gjejmë këtë përshkrim:

> "Masivi malor i Shqipërisë sfidon çdo lloj përshkrimi sado i gjetur të duket se është ai. Të thuash që sistemi Alpin i Dalmateve zgjatet drejt jugut, duke i shtrirë vargmalet e veta, të cilat formojnë tre kufijtë e Shqipërisë dhe që kjo mbretëri e vogël me një sipërfaqe, jo më të madhe se Nju Hemshiri dhe Vermoti së bashku, përmban edhe

[124] National Geographic Magazine, '*Where East Meets West*'.

vetë një mori vargmalesh, është si të përpiqesh të shpjegosh elementet aq të ndryshme të topografisë së saj."[125]

[125] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater shkurt 1931, faqe 139.

Shqiptarët janë një racë e ashpër malësore, të cilët kanë mbetur të varfër dhe me toka djerrë prej luftërave shkatërruese që kanë përjetuar që kur raca myslimane ua pushtoi vendin.

X

SHQIPËRIA NË PRAG TË PAVARËSISË E NË FUND TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Revista *National Geographic* na ka dhënë dy pamje shumë interesante të gjendjes së Shqipërisë në dy nga periudhat më kritike, jo vetëm për vendin tonë, por edhe për mbarë Ballkanin e, madje, edhe për botën. Në shkrimin

Fotografi e vitit 1912

Kjo është një fotografi e varrezave në Üsküdar të Stambollit. Meqenëse turqit e quajnë Shkodrën Üsküdar, autori e ka vendosur këtë forografi në revistë për analogji.

e parë jepet një përshkrim kuptimplotë rreth hipokrizisë së turqve të rinj dhe shtypjes së egër që ata ushtruan ndaj kryengritësve shqiptarë, ndërsa tek i dyti autori përshkruan trupat e huaja të vendosura në Shqipëri në fundin e Luftës së Parë Botërore. Ja si përshkruhet në shkrimin 'Turqit e Rinj' i botuar në janar të vitit 1912.



Fotografi e vitit 1918
Kjo urë e këputur në mes mbi Lumin Vjosa në Këlcyrë është dëshmi e pasojave të luftës.

Lumenjtë e Shqipërisë nuk ndihmojnë për të zgjidhur problemet madhore të transportit, pasi janë të palundrueshëm. I vetmi lumë i lundrueshëm është Buna në Shkodër në një gjatësi prej më shumë se 20 km nga Liqeni i Shkodrës në Detin Adriatik.

TRAZIRA NË SHQIPËRI

"Nuk ka vend në botë që të ketë fituar ndonjëherë lirinë pa një çmim dhe pa dhënë prova të mëdha.

Në tetor të vitit 1910, provinca shqiptare, një prej kolonive më perëndimore të Turqisë, e cila kufizohet me Detin Adriatik, filloi të ngrihej kundër Stambollit, duke tërhequr vëmendjen e mbledhësve evropianë të lajmeve, të cilët, për hir të së vërtetës, ishin i vetmi burim që informonte për atë që ndodhte në rajonet e mbajtura nga Turqia.

Duhet mbajtur mirë në mend se gjatë viteve të fundit të sundimit të Avdyl Hamitit, shqiptarët ishin përkrahësit më të besuar të ushtrisë. Me qëllim që të ruhej besnikëria ndaj këtij personi, ai e kishte liruar koloninë shqiptare të Turqisë nga taksat dhe i lajkatonte ata duke u ofruar shumë favore, në dallim nga pjesët e tjera të perandorisë, sidomos në mënyrën e marrjes nën armë. Në këtë mënyrë, ai vazhdoi të gëzonte besnikërinë e tyre feudale. Por, kur rendi i ri i gjërave u vu në vend dhe *liria* dhe *barazia* u bënë fjalët më të përdorura, shqiptarët mirëpritën çdo gjë që vinte prej tyre, por nuk deshën të dorëzonin qoftë edhe një prej privilegjeve të gëzuara deri atëherë. Ata kërkuan menjëherë jo vetëm që gjuha shqipe të përdorej në shkollat e tyre, por edhe që raca sunduese e perandorisë – që ishin turqit – e që e kishin vënë atë vend në zotërim me anë të pushtimit – të mos i sundonte më, duke paraqitur kështu kërkesën më të fortë që mund të paraqesë ndonjë popull – të mos kishte të bënte asgjë me turqit për sa i takonte qeverisjes së brendshme të vendit të tyre.

Natyrisht që fuqitë sunduese të perandorisë nuk mund të pajtoheshin me asnjë prej këtyre kushteve që vunë përpara shqiptarët dhe, si rrjedhojë, pasoi një revoltë kundër autoritetit kushtetues. Shqiptarët janë një racë e ashpër malësore, të cilët kanë mbetur të varfër dhe me toka djerrë prej luftërave shkatërruese që kanë përjetuar që kur raca myslimane ua pushtoi vendin.

Shumë simpatizantë të panumërt revolucionarë evropianë kishin deklaruar se turqit nuk do të mund ta pushtonin kurrë Shqipërinë. Por, përkundër kësaj përshtypjeje gjerësisht të përhapur, Muhamet Shefqet Pashai, i cili tani ishte bërë Ministër i Luftës, shkoi me një pjesë të ushtrisë në vendin e revoltës dhe, në më pak se gjashtë javë, i theu ata.

Gjeneral Shefqet Pasha u pagëzua me emrin *kasap* për shkak të masave të tmerrshme të zbatuara prej tij për të shuar rebelimin e shqiptarëve. Një njoftim i kobshëm për një 'masakër të ndyrë të ndërmarrë prej të krishterëve' mori dhenë nëpër tërë Evropën. Asnjë vëmendje nuk iu kushtua faktit që shumica e banorëve të Shqipërisë janë myslimanë të

pabindur dhe që konflikti nuk rridhte as për shkak të fesë, as të racës, por për shkaqe politike.

> Revolucioni shqiptar me vështirësi u shua, por fill pas tij pasoi një shpërthim tjetër në Jemen, në pjesën juglindore të Turqisë, në Azi. Fiset beduin[126] në shkretëtirën arabe sulmuan stacionin ushtarak periferik, diçka shumë e ngjashme me atë që indianët kishin bërë në Shtetet e Bashkuara. Kjo kryengritje ishte e atyre përmasave, sa të bënte të domosdoshme përforcimet në pjesë të tëra të perandorisë turke dhe, si rrjedhojë, postat ushtarake evropiane i zvogëluan trupat. Shqiptarët, duke u treguar mendjehollë si përherë, përfituan nga kjo gjendje për të rrokur armët përsëri. Megjithatë, duhet thënë se kjo kryengritje ishte kaq jetëshkurtër, sa mezi arriti deri te njoftimet e gazetave.[127]

Le të shohim tani se si ishte, gjendja e Shqipërisë në prag të fundit të Luftës së Parë Botërore.

Në shkrimin e tij 'Vëzhgime të kohëve të fundit në Shqipëri', botuar në gusht të vitit 1918, Gjeneral Brigade i Ushtrisë Amerikane George P. Scriven na jep këtë tablo të ndarjes së territorit të Shqipërisë nga ana e pushtuesve në vitin 1918:

> "Shqipëria, në përgjithësi, po të kemi parasysh hartën që përcakton kufijtë e saj të paraluftës, mund të thuhet se, tani është nën kontrollin e gjermanëve, austriakëve dhe të bullgarëve në veri të gjerësisë gjeografike të Beratit, ndërsa pjesa tjetër në jug është nën kontrollin e trupave franceze dhe italiane.
>
> Grekët ende nuk kanë kontroll brenda kufijve të vendour prej Konferencës së Londrës, ndërsa teatri i veprimeve i forcave angleze dhe serbe shtrihet në Maqedoni.
>
> Pjesa perëndimore e jugut të Shqipërisë (së shpejti ndoshta e

[126] Beduinët kanë qenë popullsi e Malit të Sinait dhe u takojnë disa fiseve siç janë tarabinët, mazainët etj. Secili fis jetonte i pavarur nga tjetri dhe secili kishte folklor të pasur dhe të larmishëm.

[127] National Geographic Magazine, '*The Young Turks*', janar 1912, faqe 71.



Foto nga Gjen. George P. Scriven (1918)
Traktor plugu amerikan vihet në përdorim në një fermë eksperimentale në Vlorë.

Kjo fermë, e cila zhvillohet nën kujdesin e qeverisë italiane, është ndërtuar në fillim si eksperiment për qiramarrësit shqiptarë dhe për pronarët, të cilët priren më shumë të përdorin plugun primitiv.

Fotografia nga Katrice Nicolson (1918)
Ultësira e qytetit të Shkodrës

gjithë pjesa perëndimore e Shqipërisë, nëse italianët vazhdojnë të jenë njësoj të suksesshëm) është seksioni më i rëndësishëm për sa u takon pasurive të luginave dhe të vlerave që shfaqin gjinjtë detarë në

Adriatik. Ky territor është në duart e italianëve dhe përbën atë pjesë të Shqipërisë që ka vlerë më të madhe në gjithë territorin. Natyra e tij do të jetë përcaktuese për fatin e të ardhmes së vendit, sepse besoj se andej nga do të shkojë ky rajon, do të marrë udhë edhe vetë Shqipëria. Do të ishte punë boshe, aq sa edhe e gabuar, po të përpiqeshim të shpërbënim copë-copë këtë racë malësorësh numerikisht të vogël, por tejet homogjene.

Përpara se Fuqitë Evropiane të pajtoheshin në vitin 1912 që Shqipëria të bëhej një komb autonom, Shkodra ishte kryeqyteti i Vilajetit Turk. Pavendosmëria e Konstandinopojës mbi Shqipërinë i solli asaj shumë probleme.

Në kohën kur po shkruhen këto radhë, sektori i pushtuar nga trupat italiane zë fill në veri të lumit Vjosa, pret, thuajse, te kthesa e lumit Seman dhe mbyllet në perëndim prej Adriatikut, për të vijuar në kufirin me Greqinë në jug dhe për të shkuar më tej drejt brinjës së majtë të Armatës Franceze d'Orient në lindje, duke u ndarë pastaj me Ersekën përgjatë vijës së komunikimit nga Saranda në Selanik.

Sektori francez është më i vogël se ai italian dhe numëron më pak njerëz, megjithëse brenda kufijve të tij janë përfshirë Liqeni i Ohrit dhe Maliqi, si dhe lugina pjellore e këtij të fundit, në të cilin gjendet Korça, ndoshta qyteti më i pasur i vendit.

Në tërë jugun e Shqipërisë – në të vërtetë, ndoshta, në mbarë Shqipërinë – këto ditë qeverisja administrohet prej ushtrive pushtuese. Njerëzit kanë fare pak se ç'të thonë për çështjet e tyre dhe janë, thuajse, tërësisht të çarmatosur.

….Francezët kanë shkuar një hap më larg se italianët në çështjet shqiptare duke shpallur, vitin e kaluar, një Republikë Shqiptare të Korçës. Megjithatë, në kohën e vizitës në Korçë, unë nuk munda të gjeja ndonjë gjurmë të asaj republike. Republika duket të ketë vdekur dalngadalë dhe natyrshëm. Ajo ndoshta nuk kishte mbështetje nga populli dhe ishte një përpjekje e sforcuar, të cilën shqiptarët gjithmonë e panë me dyshim. Ç'është e vërteta, Republika e Korçës as që kishte ndonjë arsye që të ekzistonte.

Duket se një shqiptar, i quajtur Germani, ishte nxitur që të vinte nga kampi austriak për t'u bërë drejtues i policisë, një nga postet më të larta në Republikën e Re, por diçka nuk shkoi mirë me të dhe ai u zhduk.

Në të gjitha ngjarjet, Korça dhe fshatrat që e rrethojnë mbetën nën kontrollin francez. Një prefekt civil e ushtron detyrën mesa duket nën komandën e përgjithshme, ndërsa një këshill i përbërë prej katërmbëdhjetë vendësish e ndihmojnë atë në cilësinë e këshillëdhënësve.[128]

Fotografi nga L. F. Hurong (1931)

Këta dy fëmijë shkodranë janë shumë kureshtarë përse fotográfi i ka marrë ata në fotografí. Fëmijët shqiptarë janë të ruajtur mirë dhe rrallë shihen në rrugë.

[128] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven , gusht 1918, faqe 90.

Straboni shkruan për ilirët dhe për epirotët se ata jetonin në drejtim të jugut dhe të veriut, të ndarë nga një vijë që, praktikisht, përkon me rrjedhën e Shkumbinit; prej kësaj është e arsyeshme që të vijmë në përfundimin se gegët rrjedhin prej të parëve, ndërsa toskët prej të dytëve.

XI

NATYRA SHQIPTARE , PASURITË NATYRORE, PEIZAZHI, KLIMA

Duke u nisur edhe nga qëllimi i saj i shprehur në emërtimin e revistës dhe të vetë shoqatës që e lindi atë, revista është ndalur veçmas tek elementet natyrore që përbëjnë Shqipërinë. Le t'i shohim ata, shkurtimisht, sesi janë shprehur në revistë.

Fotografia nga Theron J. Damon (1912)
Pamje e një rruge në qytetin e Shkodrës

Pasuritë natyrore

"Asgjë nuk është thënë për mineralet, të cilat sigurisht që presin për t'u zbuluar në malet e Shqipërisë. Pak dihet në lidhje me këtë, sepse ato, praktikisht, janë të pashkelura. Nuk është e pamundur që, me ardhjen e ushtrive, të bëhen kërkime sistematike për minerale të çmuara.

Sera ose asfalti, ka qenë e njohur që në kohën e romakëve. Afër Vlorës unë kam parë mostra të pastra, të zeza dhe të forta, që premtojnë shumë. Gjurmë vajguri, gjithashtu, janë gjetur prej italianëve dhe thuhet se shpimet kanë filluar ose janë gati në të filluar. Bakri dhe hekuri besohet se gjenden në Luginën e Maliqit, kurse qymyri, argjendi dhe plumbi në male të tjera të vendit.

Metali i floririt është punuar këtu që në kohët e lashta dhe argjendi shqiptar ishte i njohur prej venedikasve, por i tërë rajoni malor ka mbetur pas dore. Nuk ka dyshim se, me ardhjen e ushtarëve, ndërtimi i rrugëve dhe zhvillimi i vendit, që është në udhë e sipër, veçanërisht në rajonet e pushtuara nga italianët, do të sjellë ndryshime në Shqipëri dhe në popullin e saj."[129]

Po kështu, ky gjeneral amerikan ka vëzhguar me vëmendje pjellorinë e tokës, por edhe pronën mbi të, kur shkruan:

"Tokat në Shqipëri janë prona të pronarëve të mëdhenj. Përpara luftës, shumë prej pasurive ishin në duart e turqve. Pronarë të tjerë janë vetë shqiptarët, ndërmjet të cilëve familja e fuqishme e Vlorajve në Vlorë, që zotëron mbi 243 kilometra katrore tokë. Kjo familje, Vlora (që do të thotë lule), i jep emrin qytetit. Për të ilustruar shkatërrimet e luftës në Shqipëri, është interesant të përmend që njëri prej djemve të kësaj familjeje historike tani është i internuar në Sardenjë; një tjetër është në ushtrinë italiane; një është në Zvicër dhe i katërti në Konstandinopojë. Shtëpia e madhe stërgjyshore qëndron e vetmuar dhe e lënë pas dore – e kthyer në çerdhe të madhe lejlekësh.

Tokat bujqësore punohen, thuajse, në çdo skaj prej argatëve, por disa janë marrë në pronësi dhe janë kultivuar prej vetë fshatarëve të bashkësive që e rrethojnë atë dhe pronësia e tyre është e siguruar. Por çfarë të thuhet për tokat që janë pronë e turqve të ikur ose shqiptarëve të cilët, si në rastin

[129] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918, faqe 109.

e familjes Vlora, janë simpatizues ose të aleatëve, ose të turqve, ose të austriakëve? Një çështje e tillë e zgjat hijen e saj deri larg, tek e ardhmja.”

Fotografi nga Melvile Chater (1931)
Duke vështruar një kopsht ullinjsh

Shqiptarët u përmbahen metodave të vjetra në punët bujqësore. Parmenda, në disa raste e përforcuar me fletë hekuri, shërben edhe sot për të pluguar tokën me një pendë mëzash ose me një ka dhe një buall që e tërheqin atë. Një shat i madh përdoret prej grave për të thyer plisat. Toka është pjellore, veçanërisht në luginat e jugut të vendit ku prodhohen thekra, tërshëra, tagjia, elbi dhe misri. Por delet dhe dhitë janë, thuajse, e vetmja pasuri e njerëzve që jetojnë në shpatet e maleve.

Pyjet janë të pakta dhe malet, kryesisht, janë shkëmbore, jopjellore dhe të ashpra. Ato shpesh janë të mbuluara me shkurre dhe kaçube të ulëta. Ndodh që lart në male të shihen pisha dhe bredha, madje edhe atje ku bora jeton gjatë.

Turqit kurrë nuk i kanë ruajtur pyjet dhe, si rrjedhojë, Shqipëria edhe Maqedonia janë, thuajse, të zhveshura. Madje, në luginat pjellore, lisat, ahu, plepi dhe arra nuk gjenden në numër të madh. Rrapi, ndoshta, është druri më i pranishëm. Prej frutave gjenden manat, qershitë, vishnjet dhe dardhat, ndërsa në Himarë, në bregdet, portokallet dhe limonat janë të mrekullueshëm; rreth e rreth Vlorës ullishtet lulëzojnë dhe gëzojnë

përkujdesjen e italianëve. Hardhitë, të cilat prodhojnë verë të mirë, rriten më së miri në Shqipëri dhe



Fotografi nga Katrice Nicolson (1918)
Kështjellë mesjetare që e vështron që nga lart Shkodrën

Në mesjetë, gjatë pushtimit venecian të Shqipërisë, ky shkëmb i lartë i ngritur përmbi Shkodër ishte fortifikuar jashtëzakonisht mirë. Me ta pushtuar, turqit e ndërtuan pjesërisht fortesën e vjetër. Kreshta u bë skenë e luftimeve të ashpra midis forcave të sulltanit dhe shqiptarëve kryengritës, që i paraprinë shpalljes së pavarësisë dhe njohjes së saj prej Fuqive Evropiane më shumë se 5 vjet më parë.

po ashtu kultivohet edhe duhani."[130]

Dhe më tej ai vijon:

"Me zbatimin e metodave të sotme të punëve në bujqësi, luginat në Shqipërinë e jugut mund të shndërrohen në kopshte të bukura. Italianët kanë filluar t'i stërvitin bujqit shqiptarë në fermat eksperimentale. Ferma më e mirë që kam parë, gjendet në Vlorë. Ajo

[130] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P.
Scriven, gusht 1918, faqe 113.

është e vendosur në një luginë, në veri të qytetit, e shtrirë në 400 ha tokë, nën mbarështim bujqësor, që prodhon grurë dhe perime të tilla, si: qepë, lakra dhe sallata.

Gjeografia e tregtisë së jashtme, fotografi e vitit 1922
Festa e Gjelit të Detit në Shqipëri *Gëzuar Krishtlindjet!*

Këta shpendë janë mbledhur anë e mbanë vendit për t'u sjellë për tregti në Durrës me rastin e festës së Krishtlindjeve.

Metodat e sotme të kultivimit janë vënë në përdorim me qëllim që fshatarët të mësojnë si ta punojnë tokën, aq sa edhe për qëllime praktike të vetë prodhimit bujqësor. Po ashtu janë vënë në punë makineri bujqësore, ndër të cilat ia vlen të përmenden një plug amerikan dhe një makinë bujqësore motorike që punon me benzinë.

Bujqësia, ndonëse në këtë pranverë mbush vetëm vitin e dytë të mbarështimit modern, arrin të fitojë mesatarisht 4.000 lira në muaj, të siguruara prej shitjes së prodhimit, kryesisht dhe pa dyshim nëpër tregjet e Vlorës, për nevojat e ushtrisë. Ushtarët bujq, gjithashtu, rritin derra, pula, puladeti dhe pëllumba, madje eksperimentojnë edhe me

lepuj."[131]

PEIZAZHI NATYROR

"Në ditën tonë të dytë të udhëtimit u ndeshëm me rrjedhën e Lumit Vjosa, e cila kalon mespërmes shkëmbinjve si në anën e Shqipërisë, ashtu edhe në atë të Greqisë. Dy ushtarë që ruajnë postat përkatëse kufitare, njëri nën ngjyrat kombëtare greke, ndërsa tjetri nën flamurin kuq e zi me shqiponjën dykrenare, që vjen që nga kohët e betejave të Skënderbeut, përpiqeshin të bënin ç'ishte e mundur për t'u dukur tepër të pashoqërueshëm, të largët dhe të pakompromentueshëm ndaj njëri-tjetrit.

Pas rreth një ore, ne po ndiqnim një rrugë që gjarpëronte nëpër grykën e malit në një pamje mahnitëse. Makina merrte kthesa të plota, kalonte buzë shkëmbinjsh madhështorë, pastaj hynte nën çatinë e shkëmbinjve që qëndronin të varur mbi kokë, dhe, papritur, shfaqeshin pamje të vërteta alpine që zbukuroheshin nga gjelbërimi i harlisur i drurëve mijëravjeçarë, që kishin mbi vete vetëm qiellin dhe livadhet ende të mbuluara me dëborë.

Nga Përmeti, Këlcyra, Tepelena dhe më pas nga kështjella e rrënuar e këtij qyteti të shoqëruar nga kujtimet e luftëtarit të paepur, Ali Pashait, mbërritëm në Gjirokastër në kohën e perëndimit të diellit. Më tej kodrës dhe poshtë luginës në trajtë V-je, çatitë krijojnë një pamje të bardhë si dëborë, që duket sikur e plotëson relievin shkëmbor të maleve që e rrethojnë. Pazari i këtij qyteti të rrallë është i mbushur me dyqane të vogla, por me dritare të mëdha e të hapura, me vitrina mallrash dhe zejesh; në këtë qytet njeriu sheh dervishë me xhybe të gjata, një shitës cigaresh tek fle sipër banakut, tellallët që shpërndajnë haberet me çanga e klithma, njerëz me qeleshe të bardha, të gjata e të leshta mbi kokë, tregtarë metrazhesh, gra myslimane, me kokë të mbuluara me shami të bardha, të holla dhe elegente. E tëra kjo paraqet Gjirokastrën – qytetin shumëngjyrësh dhe të larmishëm të Toskërisë."

[131] Po aty.

Duke shkuar drejt veriut, përgjatë bregdetit midis porteve të Sarandës dhe atij të Vlorës, rend një rrugë e cila të lë pa frymë me bukuritë e vendeve që i përshkon. E ndërtuar nëpër malet që ngrihen përmbi det, ajo gjarpëron nga një shpat në tjetrin për afro 160 kilometra nëpër vende të mbuluara me ullinj e pisha, nëpër breza plazhesh e korije që të shfaqen sikur i sheh nga kabina e një aeroplani. Tani shohim disa porte të mrekullueshme gjysmë të rrethuara, të cilat presin që tregtia t'i shndërrojë nga ajo gjendje e virgjër natyrore në gjendje urbane.

Ndaluam ndanë rrugës për të ngrënë drekën nën hijet e ullinjve të një fshati me shtëpi të mbuluara me çati të kuqe, duke soditur detin e kaltër, nën një diell përvëlues qershori që vezullonte mbi valët e lehta të detit të asaj dite. Vetëm një 'anije e stolisur' që lëvizte mbi detin e kaltër, sikur ia prishte qetësinë asaj pamjeje magjike.

Dita filloi të ngrysej dhe ne kalonim nga një vend në tjetrin, ku spikasnin ujërat e rrjedhshme natyrore të çdo fshati, dhe shpesh shihnim gra të ngarkuara, që ngjiteshin atyre kodrave me buljera uji në shpinë, për të shuar etjen e familjeve të tyre.

U ngjitëm nga avanposti i Himarës në një vijë të skajshme si për ta gjetur veten në cepin e një kepi. Ishte Mali Glosa, Akroceraunia e lashtë. Tani ishim në Himarën klasike dhe, sigurisht, të frikshme; vigani zjarrlëshues, i quajtur kështu në fabulën greke, nuk kishte të bënte aspak me makinën tonë, motori i së cilës hungërinte duke lënë pas tym e mjegull nëpër kthesat e panumërta të përvijuara nga inxhinierët që e projektuan dhe e ndërtuan këtë rrugë në kohën e luftës. Më në fund arritëm në majë të malit. Tani do të fillonim zbritjen drejt bregdetit, duke lënë prapa freskinë e pishave dhe duke iu afruar detit të kaltër dhe vetë qytetit të Vlorës.

Gjatë dy ditëve të tjera shkuam në Berat dhe në Elbasan. Ishin malet që i mbanin ata larg njëri-tjetrit, duke u dhënë rrugë pamjeve të fushave të pathyera, të mbushura me gjë të gjallë, me plot hije pemësh, me dy lumenj të vegjël, por plot ujë që kalonin mespërmes – pamje aq e këndshme dhe freskuese. Pa dyshim që uji është pasuri në Shqipëri. Ajo ka vetëm dy lumenj të lundrueshëm dhe këta janë të tillë vetëm pjesërisht dhe vetëm në stinë të caktuara. Përrenj plot me ujë në dimër dhe të tharë gjatë verës – këto janë problemet e ujit të një vendi, ku mbledhja e ujit nëpër liqene artificiale do të ishte një përfitim shumë i madh.

Berati është i vendosur në disa kodra të cilat qëndrojnë nën hijen e Malit të Tomorrit, mbi të cilin edhe në verë shkëlqen bora e bardhë. Elbasani shfaqet nga mesi i kopshteve të vaditura. Këtu, si edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë, qiellin nuk e çajnë oxhakët e fabrikave, por minaret e xhamive. Bijtë e saj, të kthyer nga Amerika, janë të etur për industrializimin e vendit të tyre, i cili banohet prej një popullsie, pothuajse, tërësisht bujqësore, ku çdo zot shtëpie merret me punë të tilla, si: përpunim leshi, fijeve të lirit dhe të lëkurëve.

Nga Elbasani për të shkuar drejt Durrësit duhet ndjekur rrjedha e Lumit Shkumbin, i cili e ndan me vijë natyrore gegërinë nga toskëria. Gegët janë në veri, ndërsa toskët në jug. Straboni[132] shkruan për ilirët dhe për epirotët se ata jetonin në drejtim të jugut dhe të veriut, të ndarë nga një vijë që, praktikisht, përkon me rrjedhën e Shkumbinit; prej kësaj është e arsyeshme që të vijmë në përfundimin se gegët rrjedhin prej të parëve, ndërsa toskët prej të dytëve."[133]

KLIMA

Klima e Shqipërisë është vlerësuar si e shëndetshme në lartësitë e vendit, ndonëse ndryshimet janë aq të mëdha, sa për një të huaj, në stinë të caktuara, ato bëhen të bezdisshme edhe nëse ai qëndron vetëm në një krahinë të caktuar. Por, kur një udhëtar që lëviz me shpejtësi me një mjet të motorizuar nga një pjesë e vendit në një tjetër – e vetmja mundësi praktike e të udhëtuarit në ditët tona – përshkon disa mijëra metra nga lartësitë e maleve të ftohta dhe me erëra që fryjnë, shpesh herë të mbuluara me dëborë, dhe zbret në një luginë të ngrohtë

[132] *Straboni* (afërsisht 64/63 p.e.r. – 23 e.r.), historian dhe filozof grek i lindur në Azinë e Vogël në një familje të edukuar. Ai studioi pranë Aristedemosit përpara se të shkonte në Romë në vitin 44 p.e.re për të studiuar në shkollën e Aristotelit dhe më pas u shndërrua në stoik. Prej 47 vëllimeve të veprave të tij historike të botuara në vitin 20 p.e.r. kanë mbetur vetëm disa citime, ndër të cilat dallohen ato që kanë të bëjnë me grekët dhe me romakët gjatë mbretërimit të Qezarit August.

[133] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 151.

ku shkëlqen dielli, dhe, pastaj, brenda një ore, kthehet përsëri atje ku ishte, është vërtetë për të pasur kujdes.

Maji është muaji më i këndshëm i vitit dhe luginat me gjelbërimin e tyre e vërtetojnë këtë më së miri. Dëbora, pa dyshim, shndrit nëpër male gjatë tërë pranverës, por rrallë zgjat deri në verë, pasi majat e maleve nuk arrijnë lartësi më të madhe se deri në 2500 metra.

Ethet e malarjes prekin edhe Shqipërinë edhe Maqedoninë. Raporti mjekësor që më është dhënë nga ushtria, paraqet një shifër prej 25 përqind që në pushtimin e Shqipërisë – ndoshta një mesatare, sepse unë kam dëgjuar prej një komandanti të kishte 80 përqind të burrave të vet të sëmurë me ethet e malarjes në të njëjtën kohë. Megjithatë, shëndeti i trupave në kohën kur unë po shkruaj, pranverë e vitit 1918, ishte shumë i mirë.

Ethja e Ballkanit është e qëndrueshme, por jo edhe aq vdekjeprurëse. Prapëseprapë, është për t'u frikësuar prej saj për shkak të pasojave të zgjatura dhe ligështisë së madhe trupore e fizike që shkakton. IIaçi i veçantë është kinina që jepet bashkë me gjellën dhe që duhet të mbahet në xhep.

Në Maqedoni, veçanërisht në veri të Selanikut, në Luginën e Straumës ku prodhohen, ndoshta, duhanet më të mira në botë, vërehet një klimë që thuhet se është e ngjashme me bregdetin perëndimor të Afrikës.

Dimri është i shkurtër, i ftohtë, me reshje të shumta dhe rrugët nëpër fshatra bëhen, thuajse, të pakalueshme prej gropave me baltë, nëpër të cilat mjetet e kanë vështirë të kalojnë. Si rrjedhojë, veprimet ushtarake janë të kufizuara dhe shtrihen vetëm në zonat pranë rrugëve të shtruara me çakull."[134]

[134] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918, faqe 109.

Edhe njerëzit edhe vetë Shqipëria të kujtojnë aq shumë Zvicrën siç do të ketë qenë në kohët e hershme kur ishte më e këndshme dhe më e papopulluar sesa tani në kohët moderne, e kthyer në një shesh lojërash për Evropën. Një ditë, pa dyshim, Shqipëria do të zbulohet prej botës; dhe kur të vijë ajo ditë, i madh do të jetë ndryshimi aty dhe e madhe do të jetë edhe etja e njerëzve për t'ia parë mrekullitë dhe për t'iu gëzuar hijeshisë së saj. Shqipërisë i nevojiten njerëz, sipërmarrje dhe para; nëse këto tri gjëra i ka, atëherë zhvillimi i saj do të jetë i sigurtë.

XII

TRANSFORMIMI I SHQIPËRISË NË FILLIMIN E SHEKULLIT XX

G"Përpara arritjes së Aleatëve, një prej gjërave që duhej t'i

eorge P. Scriven në vitin 1918 shkruan:

kushtohej kujdes ishte përmirësimi i rrugëve. Të tilla ekzistonin vetëm pak në Shqipëri dhe në Maqedoni, përjashtuar këtu rrugët e vjetra të bëra në kohën e Turqisë, që lidhnin Sarandën me Selanikun me degët e saj në drejtim të jugut për në Janinë dhe të veriut për në Berat.

Gjatë qëndrimit tim në Shqipëri, udhëtova me një mjet motorik dhe përshkova shumë kilometra në rrugët e ndërtuara nga italianët – jo vetëm rrugë ushtarake jetëshkurtra, por rrugë të përhershme, të vendosura mbi trase të pëlqyeshme dhe të ndërtuara me mjeshtëri. Flas, në veçanti, për rrugën prej 55 miljesh, që lidhte Vlorën me Tepelenën dhe rrugën prej Sarandës në Vlorë. Kjo e fundit ndoshta është shembulli i njërës ndër rrugët më interesante që mund të gjenden në tërë botën. Ajo është ndërtuar nën drejtimin e Gjeneral Ferraros me punën e ushtarëve italianë dhe disa mijëra të burgosurish austriakë të ndihmuar nga fshatarët shqiptarë të cilët paguheshin nga qeveria italiane. Ajo shtrihet në një largësi prej 125 km thuajse gjithkund përgjatë detit, por lart, nëpër male dhe gjatë vijës bregdetare. E ndërtuar sa për përdorim të përhershëm për popullin shqiptar të jugut, aq edhe për qëllime ushtarake, ajo ngjet me rrugët e lashta romake të bëra për

t'u bërë ballë shekujve. Në këtë pikëpamje, kjo është një ndër rrugët madhështore të botës si nga ana e ndërtimit, ashtu edhe të pamjes që ofron. Ajo është ndërtuar me një trase të mjaftueshme për mjetet motorrike dhe në një kohë rekord prej 67 ditësh.

Fotografi nga Alice Shalek (1931)
Punëtorët e ngarkim-shkarkimit në portin më të mirë detar të Shqipërisë

Vlora shtrihet midis zabeleve me ullinj dhe kopshteve të bukura rrëzë maleve, rreth dy kilometra larg nga deti Adriatik.

Sot ka një rrugë të shtruar mirë që fillon në Vlorë dhe i bie Gadishulllit të Ballkanit mespërmes deri në Selanik në një gjatësi prej afro 550 km. Kjo është rruga e vjetër turke, e cila për një kohë të gjatë qe lënë pas dore, duke u bërë vende-vende thuajse e pakalueshme, por që tani është nën një përmirësim të shkëlqyer me trupat dhe paratë e Italisë, Francës dhe të Britanisë së Madhe.

Është, thuajse, e pamundur të them ndonjë fjalë për praninë e hekurudhave në Shqipëri; sidoqoftë, me zhvillimin e vendit, hekurudhat do të vijnë dhe a mund të dyshojë ndokush se kjo luftë, e tmerrshme dhe

shkatërrimtare, siç është në të vërtetë, nuk do të sjellë me vete në rajonet e humbura të botës pishtarin ndriçues të mendjes dhe të përparimit."[135]

NJË SHQIPËRI E NDRYSHUAR

> "E tillë është pamja e vizatuar e shqiptarëve siç ishin ata një dhjetëvjeçarë më parë. Siç e pashë disa javë më parë, kjo përbën një dallim të theksuar, të habitshëm me realitetin e sotëm nën kontrollin e ushtrive franceze e italiane. Ndryshimi është veçanërisht i dukshëm në atë pjesë të Shqipërisë, e cila është nën administrimin italian. Aty fëmijët dërgohen në shkollë; vendasit marrin rroga më të mëdha nga sa u duhen për të jetuar, për një punë që shpesh është në përfitim të vetë njerëzve; vendi është efektivisht i ruajtur nga ushtria dhe asnjë vendas i armatosur, me përjashtim të bandave, nuk shihet në territoret e pushtuara të zonave të ndryshme.
>
> Nëse armiqësitë ende ekzistojnë, ato janë prej atyre që nuk janë përmbushur dhe kanë mbetur të fshehura, pasi armët u janë marrë malësorëve."[136]

Si rezultat i Luftës Botërore, kur rrugët dhe transporti automobilistik e transformuan vendin, Shqipëria përparoi nga forca tërheqëse e kuajve, te kuajt e fuqisë. Kjo ndodhi brenda një dhjetëvjeçari.

Një ndër qëllimet më të larta të revistës është pasqyrimi i transformimeve të ndodhura në vende të ndryshme të botës, të realizuara prej dorës së njeriut. Shqipëria ka pasur një proces shumë të vështirë transformimi të natyrës nga ana e njeriut, për shkaqe që dihen. Pushtimi osman la pas kullën shqiptare ku ai vetëmbrohej, kështjella të rrënuara të mesjetës dhe qytete, të cilat ishin, thuajse, të shkatërruara. Melvile Chater e fillon shkrimin për udhëtimin e tij me një detaj të thjeshtë: me kontaktin

[135] National Geographic Magazine, '*Recent Observation in Albania*', shkruar nga George P. Scriven, gusht 1918, faqe 111.
[136] Po aty.

Fotografi nga Melvile Chater (1931)
Lufta, të paktën, krijon rrugë

Në foto, pamje e një pjese rruge në bregdetin shqiptar afër Vlorës.

me konsullin shqiptar, i cili i habit ata kur u thotë se Shqipërinë mund ta përshkonin me makinë në vend të kalit. Ja si fillon tregimi i tij:

"Po përse me kalë?", - pyeti konsulli shqiptar duke na i kthyer pasaportat bashkë me vizat në to.

"Por", - iu kthyem ne, - "meqë Shqipëria nuk ka hekurudha…"

"Por merreni me mend! Një vend me një sipërfaqe prej 28.000 kilmetrash katrorë të përshkohet me kalë? Po pse jo me makinë?

U stepëm. Shqipëria me makinë?! Çfarë ndryshimi me traditën! Në të rënë të diellit, e mbreha kalin duke vështruar horizontin e mrekullueshëm malor. E tillë është fraza bajronase e udhëtarëve të hershëm në atdheun e Skënderbeut dhe të Ali Pashait. "Me kalë nëpër lartësitë shqiptare – e tillë është tema e zakonshme e udhëtarëve të kohëve të fundit që shkojnë në atë vend. Dhe kështu, jo pa arsye, ne e kishim marrë në sy Shqipërinë si një masiv të plotë malor të përcaktuar nga ana inxhinierike, e populluar prej fisesh të rrepta që shtijnë sa hap

e mbyll sytë. Dhe përsëri më del përpara syve ai konsull tërë gjallëri, që na tregoi 1.200 km rrugë në një hartë qeveritare, duke na përmendur dy shprehje që u kujtojnë amerikanëve se "Koha është flori", por "fjalën tani e ka benzina."

"Do ta shohim", - thamë. "Dhe e pamë."

SHQIPËRIA E ZBRITUR NGA MESJETA TE MODERNIZMI

Një javë më vonë ne rendnim me tren nëpër malet e Maqedonisë drejt Follorinës. Prej andej, me një makinë, kaluam një gjelbërim mahnitës malesh të bukura dhe më pas përmes një pllaje të gjerë.

"Po Shqipëria," - e pyetëm shoferin ndërkohë që po e vështronim horizontin e majave të thepisura të maleve, - "kur fillon ajo?"

"Ju tashmë jeni në Shqipëri," - u përgjigj ai, duke bërë me dorë drejt asaj fushe pjellore.

"Përpara nesh u shfaq një hambar i madh që priste të strehonte misrin e verdhë, i cili ende valëvitej në arë nga puhia e erës si në një fushë të gjerë të paanë të një toke buzë detit – një deti të rrethuar prej malesh të larta, që në vend të ngjyrës blu, merrrte ngjyrat e purpurta të perëndimit të diellit. Atje shtrihet qyteti i Korçës me korijet e gjelbëra dhe me minaretë që shkëlqejnë. Mespërmes kësaj pamjeje fshatare, kaq të ndryshme nga pamja e pafund e vargmaleve që ekzistonte në imagjinatën tonë, gjarpëronte një rrugë e bërë mjaft mirë, ku një karvan kamionësh transportonin postën dhe ngarkesat e tjera nga njëri cep i Shqipërisë në cepin tjetër.

Luftërat shkatërrimtare të paktën lënë rrugë prapa. Kur në vitin 1918, gjëmimet e topave të rëndë e mekën Shqipërinë, e cila një herë e një kohë u bë jo vetëm fushë beteje, por edhe korridor i saj, papritur u pa se ajo kishte përftuar bërthamën e një sistemi rrugësh të studiuara mirë nga ana inxhinierike dhe ishte njohur me transportin motorik. Kështu, në vend që të kalonte dalngadalë nga epoka e avullit tek ajo e benzinës, ashtu si edhe pjesa tjetër e Evropës, ajo zbriti nga mesjeta te modernja, nga fuqia tërheqëse e kuajve, te kuajt e fuqisë. Dhe e tëra kjo ndodhi brenda një dhjetëvjeçari.

Në ditët tona qeveria shqiptare shpenzon 200.000 dollarë amerikanë në vit për zgjerimin e atyre rrugëve, që i lindi lufta. Fshatari i zonave të ulëta nxitet nga një ndërgjegje urbane rrugësh e përcaktuar me një ligj, i cili e bën atë drejtpërsëdrejti të detyruar që, ose me para ose me punë, të mirëmbajë 20 këmbë rrugë. Ai është zgjuar papritur, njësoj si Rip Van Rinkle,[137] që vë re postën, ushqimet e freskëta, ose materialet bashkëkohore të ndërtimit tek ngrenë mbi tokë ndërtesa aq të bukura e aq shpejt."[138]

KORÇA – PASQYRË E SHQIPËRISË NË NDRYSHIM

Ndryshimet e thella shoqërore i bien në sy udhëtarit ngado që shkon. Të thuash tani e 'frenova makinën', i bie si të thoje përpara, 'ia rrudha frenin kalit'.

"Korça, e cila njihet si qytet i kategorisë së parë bashkë me Shkodrën, Tiranën dhe Gjirokastrën, që kanë një populsi prej 12.000 deri në 32.000 banorë, paraqet një pamje interesante të Shqipërisë në tranzicion. Ndërtesa moderne dalin përmbi shtëpitë e vjetra të tipit fortesë në rrugicat antike të shtruara me kalldrëm dhe të rrethuara me mure, pas të cilave fshihen kopshte me lule të mrekullueshme, të ruajtura me aq kujdes prej familjeve, një traditë që të sjell ndër mend diçka nga ekzotika lindore.

Qerret e mbushura plot e përplot, të tërhequra prej qeve, bllokojnë rrugën kryesore, duke u bërë shkak i britmave të dëshpëruara të shoferëve që rendin me makinat e tyre.

---

[137] *Rip Van Rinkle* fle për më se njëzet vjet. Kur zgjohet, gjen një botë që ka ndryshuar aq shumë, sa ai nuk arrin ta kuptojë më. Kjo përrallë klasike e shkruar nga Washington Irving, është bërë popullore prej më se dyqind vjetësh në Amerikë. Ai personifikon njerëzit, të cilët ballafaqohen papritur me ndryshime të mëdha në shoqëri.

[138] National Geographic Magazine, '*Albania, Europe's Newest Kingdom*', shkruar nga Melvile Chater, shkurt 1931, faqe 132-133.

Fotografi nga Luigi Pellerano (1931)
Luginat e gjelbra shtrihen midis majave të larta të maleve.

Duke iu afruar Korçës nëpërmjet fushave anës së luginës së Lumit Vjosa, njeriu ndien shijen e ajrit të freskët që vjen nga majat e mbuluara me dëborë. Dikur ato ishin të kalueshme vetëm me kuaj. Tani Shqipëria ka një sistem, i cili mundëson udhëtimet me mjete të motorizuara nëpërmjet pjesës më të madhe të rajoneve të saj, që të mahnitin me larminë e tyre.

Lagja myslimane ka një hijeshi orientale, me gra të mbuluara me të zeza. Lagjia e të krishterëve dallohet për fundet allafranga që veshin gratë, për çorapet ngjyrë mishi dhe flokët e shkurtra. Elemente të përparimit shfaqen edhe me praninë e instruktorëve të atletikës, të përfaqësuesve vendas të një sistemi mbarë-kombëtar. Dhe këtu shfaqet konservatorizmi i lidhur si mishi me kockën me nënat shqiptare, të cilat sportin e luajtur me vrapime të shkurtëra dhe të shoqëruar me banjo të ftohta e quajnë si rrugën më të shkurtër për të arritur deri te vdekja.

Por le të vijmë te historia e tharjes së Kënetës së Maliqit. Një qeveri ambicioze, që sapo merr veten, duke dashur të bonifikojë mijëra hektarë tokë të kultivueshme, e ka shitur atë me koncension te një firmë e huaj. Inxhinierët e firmës po projektojnë hapjen e kanaleve shkarkuese. Për ta bërë këtë, ata kanë sjellë në Shqipëri dhe kanë vënë në punë të parën makinë gërryese të këtij lloji.

Disa breza më parë këneta qe krijuar prej vërshimit të përrenjve, të cilët i sillnin ujërat që prej kodrave, duke shkaktuar kështu përmbytjen e fshatrave të Toskërisë. Ekziston një besim tradicional se një ditë Këneta e Maliqit do të tërhiqet dhe do t'u kthejë stërnipave tokën që dikur ua kishte marrë stërgjyshërve.

Një mrekulli e vërtetë, siç ndodhi, Këneta e Maliqit u tërhoq duke nxjerrë në sipërfaqe, për habinë e fshatarëve toskë, bashkë me tokën pjellore të stërgjyshërve, edhe poçet e tyre të mbuluara që prej kohëve të lashta. Me thirrje dhe falënderime të pafundë ata nxituan për te toka e liruar nga uji dhe filluan punët bujqësore.

Është e kotë që njerëzit aty të mundohesh t'i bindësh se janë mësimi, shkolla dhe përpunimi ato që kishin bërë mrekullinë, dhe jo fuqia hyjnore. Pra, fundi i kënetës i takonte një kompanie bonifikuese, e cila do të bënte që njerëzit të shkelnin mbi tabanin e saj, aty ku dikur kanë shkelur strëgjyshërit e tyre. Kjo është e tëra. Por, nëse ndonjëherë të bie që të shkosh dhe të vizitosh Kënetën e Maliqit, mos ua mburr toskëve vendas bonifikimin nëse nuk do të biesh në telashe me ta.

Korça e ndryshon trajtën në çdo ditë pazari. Aty grumbullohen mijëra fshatarë, secili i veshur në rrobat karakteristike kombëtare të krahinës së vet. Ata ecin në këmbë ose me kalë një ditë të tërë nëpër male, me shpresë së do të shesin ca nga drithërat e tyre, ndonjë dele ose kalë, në tregun plot gjallëri.

Tregu i kuajve, më i madhi në Shqipëri, është thuajse, tërësisht, i mbushur me kafshë dhe me njerëz që bëjnë gjithfarë gjestesh. Këtu, në panairin e kuajve të qarkut, njeriu bëhet dëshmitar i çdo lloj dredhie ose prove të përdorur prej xhambazëve. Janë të shumta provat që përcaktojnë nëse 'kali qëndron pa vështirësi në këmbë', 'nëse vuan nga ndonjë sëmundje', nëse 'çalon' etj.



Fotografi e vitit 1931
Romë të veshur me rroba kombëtare shqiptare

Edhe në Shqipërinë e pastër nga ana etnike gjenden romë, të cilët janë të pranishëm anë e mbanë vendit. Joshja e kostumeve të vendasve i ka transformuar këta romë nga një çift i zakonshëm i racës së vet, në një tip ezmer toskësh të jugut të Shqipërisë.

TIRANA NË RRUGËN DREJT PERËNDIMIT

"Duke lënë prapa puhinë dehëse të Durrësit, morëm rrugën për t'i hedhur një sy Tiranës, kryeqytetit të Mbretërisë, në të cilën të zinte frymën zagushia. Në të vërtetë, qëndrimi në Tiranë nuk do të kishte qenë asgjë tjetër përveç se një hedhje syri shkarazi, pasi betejën për shtratin e fundit në hotelin e fundit e kishim humbur, - sikur mikpritja amerikane të mos kishte hapur derën, duke zbuluar në formën e guzhinës, të banjove të ngrohta, të krevateve të pastra, të botimeve periodike, të incizimeve me këngë të vjetra, e një shtëpie të tillë të bekuar që të prekte aq shumë, kur mendoje se askush nuk do të priste ta gjente një të tillë në Shqipërinë e largët.

Natyralistët e Tiranës kalojnë në paradë me flamurë dhe me muzikë (1931).

Kjo organizatë e përbotshme për djemtë ka gjetur truall të përshtatshëm në Shqipëri me një program për forcimin e karakterit dhe të natyrës studiuese, me veprimtari të ndryshme, si ngritje kampesh, punime druri etj.

Tirana zbulon një pamje të Shqipërisë në rrugën e kthimit të vetvetes në një vend perëndimor. Rrugët e gjera, të ndriçuara me elektrik, ndahen në rrugica pazaresh të ngatërruara magjepsëse. Një rresht taksish të reja, një varg mushkash të grumbulluara dhe një varg kamionësh gjenden në të njëjtin shesh. Shoferët myslimane, me brekushet e gjera si thasë, kanë hequr dorë prej hostenit, yshtës të mushkave, për të luftuar me pompën fryrëse të gomave të makinave. Diku larg, hoxha, në vetminë e tij, falet me zë të lartë. Por njerëzit as që ia vënë veshin tek rrufisin kafe të shoqëruar me pije alkoolike dhe diskutojnë për tregti me Evropën. Zëri i tij i ngjan një qarjeje në shkretëtirë.

Madhëria e tij erdhi në fron në vitin 1928 kur Shqipëria ndryshoi formën e vet të qeverisjes nga republikë në monarki. Ai udhëhoqi një popull prej më se 800.000 banorësh.

Rrugët e ndriçuara me llampa elektrike po zëvendësojnë rrugicat e errëta të pazarit; taksitë zëvendësojnë mushkat, shoferët me brekushe ngasin mjete me goma, që zëvendësojnë gomerët. Tirana u zgjodh si kryeqytet i Shqipërisë, sepse shtrihet, thuajse, në mes të rrugëve midis veriut dhe jugut të vendit.

Fotografi nga Melvile Chater (1931)
Ndikimi perëndimor ndihet kudo në kryeqytetin shqiptar

Kjo mbretëri e vogël nuk ka arritur ende një bilanc të favorshëm tregtar. Eksportet e saj – produkte baxhosh, drithëra, lëkurë, lesh, serë, qymyr druri – kapin një shumë vjetore prej rreth 2.500.000 dollarë. Nga ana tjetër, vlerat e importit të saj janë sheqeri, pambuku dhe stofëra leshi, vajguri dhe makineri, afërsisht, në një shumë të dyfishtë. Si mund të ngushtohet ky dallim? Malet mendohet të jenë të pasura në minerale – flori, hekur, qymyr, bakër dhe të tjera – por në vend nuk janë bërë kurrë kërkime gjeologjike për këtë. Ka burime vajguri, por, prodhimi i tij i sotëm, në raport me kërkesat për cilësi dhe për fuqinë blerëse janë në raporte të zhdrejta.

"Paraja flet vetë." 300.000 dollarët e thatë dërguar çdo vit nga shqiptarët e Amerikës, përbëjnë provën e pakundërshtueshme se sa nevojë ka vendi për industrinë e vet. Është torturuese tek dëgjon, në mënyrë të përsëritur, thënien: "Këtu nuk ka punë. Isha pesë vjet në Amerikë. Sikur të kthehesha përsëri atje!"

Qytetarët shqiptarë pëlqejnë dy lloje mbulese të kokës – një me qeleshe të bardhë dhe një me shall të bardhë të mbështjellë rreth e rreth kokës deri poshtë mjekrës. Rritja e gjësë së gjallë është burimi kryesor i jetesës në fiset malore. Tufa e vogël e gomerëve të ngarkuar me dru,

që shihet në mes të fotografisë, tregon se për shkak të rrugëve të pakalueshme makinat me rrota ndeshen rrallë në rajonet malore. Në Shqipërinë e Jugut, ushtria pushtuese italiane tani po ndërton shumë kilometra rrugë deri tani të pakalueshme.



Fotografi nga Melvile Chater (1931)
Treg drithërash në Shqipëri

Shkodra është tregu rajonal për malësorët dhe drithërat janë malli më i shitshëm këtu.

Tregu në qytetin e Tiranës (1918)

Fotografi e vitit 1931

Nëntëdhjetë këmbë katrorë cohë vlejnë vetëm sa për një palë dimí në Shqipëri.

Përpjekja për t'u kthyer në Amerikë, herë pas here, bëhet një qëllim i jetës së njeriut dhe një dëm i madh në jetën e tij në vendin e tij: "Xhaxhai im po përpiqet të shkojë në Amerikë që prej tetë vjetësh" - na tha me naivitet

një shqiptar, - "dhe ai nuk ka bërë as përpjekjen më të vogël për të bërë ndonjë punë tjetër gjatë tërë kësaj kohe që pret."[139]

Ja si e kanë parë amerikanët Shqipërinë që në vitin 1908, kur ajo ende ishte nën pushtimin e Perandorisë Otomane:

Fotografi nga Meri La Voy (1931)
Dëfrimi nëpërmjet kësaj loje në Shqipërinë e Mesme

[139] Po aty, faqe 159.

Në vitin 1893 një lojë fshati e quajtur 'rreth e rrotull' frymëzoi G.W.Ferris që të ndërtonte rrotën e Mamuthit të Çikagos, e cila merrte më shumë se 1.000 pasagjerë. Disa dhjetëvjeçarë më vonë, prototipi i tij primitiv është parë të emocionojë të rinjtë e Shqipërisë së re.

"Edhe njerëzit edhe vetë Shqipëria të kujtojnë aq shumë Zvicrën siç do të ketë qenë në kohët e hershme kur ishte më e këndshme dhe më e papopulluar sesa tani në kohët moderne, e kthyer në një shesh lojërash për Evropën. Një ditë, pa dyshim, Shqipëria do të zbulohet prej botës; dhe kur të vijë ajo ditë, i madh do të jetë ndryshimi aty dhe e madhe do të jetë edhe etja e njerëzve për t'ia parë mrekullitë dhe për t'iu gëzuar hijeshisë së saj. Shqipërisë i nevojiten njerëz, sipërmarrje dhe para; nëse këto tri gjëra i ka, atëherë zhvillimi i saj do të jetë i sigurtë."[140]

[140] National Geographic Magazine, '*Notes on Macedonia'*, nëntor 1908, faqe 796.

…mijëra pasardhësve të fiseve tradicionalisht të njohura si ilire janë mbajtur në këtë vend maja-maja në malet që në turqisht njihen si Ballkanike…

XIII

PERIUDHA KOMUNISTE NË SHQIPËRI

Siç vihet re në këtë vështrim të përgjithshëm për revistën *National Geographic*, Shqipëria *zhduket* nga faqet e saj që nga viti 1931 deri në vitin 1981. Vetizolimi dhe urrejtja ndaj perëndimit që shfaqnin komunistët në Shqipëri, kishin arritur nivelin e paranojës. Natyrisht, komunistët shqiptarë kujdesin më të madh e bënin që në Shqipëri të mos hynte asnjë agjent i shërbimeve të huaja, por jo më pak 'kujdeseshin' ata që të mos hynin gazetarë, të cilët mund të 'jepnin një pasqyrë të deformuar të realitetit të shkëlqyer socialist' në sytë e botës. Që të hynte ndonjë gazetar perëndimor e aq më tepër një gazetar që punonte për një revistë presitigjioze amerikane si kjo, as që bëhej fjalë. Prapëseprapë ndodhi që gjatë periudhës komuniste dhe, pikërisht, në vitin 1961 të hynte një ndër gazetarët më të shquar të kanalit televiziv ABC, Peter Genings. Hyrja e tij është realizuar nëpërmjet një grupi marksist-leninist me pasaportë kanadeze. Xhenings ka transmetuar atëherë një tablo të frikshme të situatës së atëhershme në Shqipëri dhe perspektivën edhe më të zymtë nëse vendi do të vijonte në atë drejtim. Për fat të keq ajo frikë u bë realitet.

Në vitin 1980, siç do të shohim, dy gazetarë turq, Sami Kohen dhe Mehmet Biber ia dolën, pas shumë mundimesh, që të merrnin viza për të vizituar Shqipërinë në kohë të ndryshme me njëri-tjetrin. Siç do ta shpjegonte botuesi i revistës:

"Vizitat e gazetarëve janë të rralla. Vitin e kaluar Mehmet Biberaj, një fotograf turk, i cili jetonte në atë kohë në Stamboll, arriti të merrte një vizë vetëm disa muaj pasi gazetari Sami Kohen, një gazetar tjetër po nga Stambolli, pati bërë një vizitë në atë vend. Nga biseda me Z.Kohen dhe bazuar në përvojën e tij, Z. Biber na solli këtë

reportazh të plotë, të parin që kishte ardhur nga Shqipëria e që po vihet në faqet e shtypit amerikan që prej shumë vitesh."[141]

Prej shumë vitesh. Po, kishin kaluar plot 50 vjet që kur Melvile Chater kishte botuar shkrimin e radhës për Shqipërinë. Është për t'u vënë re se, megjithë kujdesin e jashtëzakonshëm që bënte qeveria komuniste për t'i fshehur gjërat ndaj të huajve, Z. Biber ka arritur që, në tërësi, të na japë tablonë e përgjithshme të jetës në Shqipëri. Për hir të së vërtetës duhet thënë se edhe këtu, kjo revistë amerikane është treguar dashamirëse ndaj popullit tonë. Ajo e ka pasqyruar realitetin me aq sa gazetari turk e ka perceptuar, ndier dhe kuptuar, por në asnjë çast nuk ka prekur dinjitetin dhe nderin e popullit shqiptar. Një gjë të tillë ajo e ka shfaqur gjatë tërë historisë së shkrimeve të saj për Shqipërinë.

Me që ky shkrim ngjall kureshtje, jo vetëm për përshkrimin e saktë, por edhe për kurajon e Z. Biber, unë i telefonova atij në Virgjinia ku i kalon vitet e pleqërisë në SHBA dhe e pyeta sesi arriti të futej në Shqipëri. Ai m'u përgjigj: "Thjesht, sepse isha shtetas turk, përndryshe nuk do të kisha arritur ta bëja këtë. Turqia, edhe atëherë, çmohej nga Shqipëria si një shtet mik".

Por le të ndalemi tek 'eksperimenti' që ka vënë re revista në Shqipërinë komuniste në faqet e saj të botuara në muajin tetor të vitit 1980 me titull:

Shqipëria, e vetmja kundër gjithë Botës[142]

"T'i plotësojmë të gjitha detyrat dhe ta çajmë bllokadën, është parulla që i bën thirrje popullit të Shkodrës si dhe gjithë Shqipërisë. Po izolimi i Shqipërisë nga bota është rezultat i politikës së saj të brendshme dhe të jashtme dhe jo i qëndrimit të botës ndaj saj. Pa asnjë aleat dhe e rrethuar prej shtetesh të cilat kanë, historikisht, pretendime territoriale ndaj saj, Shqipëria është mobilizuar që të çajë e vetme nën diktatin e ashpër të Enver Hoxhës, i cili është në fuqi që prej 36 vjetësh. Simboli i kazmës dhe i pushkës sundon skenën publike. Enver Hoxha, një marksistleninist dogmatik, i prishi marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, të cilin ai e konsideron 'revizionist', që në vitin 1961, ndërsa me Republikën Popullore të Kinës ai i shkëputi

[141] National Geographic Magazine, *'Albania Alone Against the World'*, tetor 1980, faqe 530 – 557.

[142] National Geographic Magazine, *'Albania, Alone Against the World'*, tetor 1980, faqe 530 – 557.

marrëdhëniet dy vjet më parë. Rruga e mbështetjes në forcat e veta është, shpesh, e vështirë. Automobilët privatë janë të ndaluar, kështu që Shqipëria ecën me biçikletë."

Duke fluturuar mbi Shqipëri dhe duke soditur nga dritarja e avionit, autori ndalet pak në historinë e vendit dhe shpjegon:

"Në lashtësi, legjionet romake, duke ardhur prej Alpeve për në Brindisi drejt themrës së çizmes italiane, kalonin Ngushticën e Otrantos që më pas të shkarkoheshin këtu dhe të marshonin drejt Lindjes në rrugën e gjerë për në Selanik e më pas në Konstandinopojë. Gotët dhe normandët e pushtuan. Bizantinët, bullgarët, serbët dhe venecianët patën ndikimin e tyre. Më pas turqit osmanë e sunduan për afro pesëqind vjet dhe e bënë Shqipërinë të vetmin vend me shumicë sunduese myslimane në Evropë. Pastaj erdhën ushtritë e Musolinit e të Hitlerit."

Më pas ai kalon te transformimet e pakta që ka bërë Shqipëria:

"Sot një rrugë automobilistike ndërkombëtare i bie mespërmes Shqipërisë. 300 kilometrat e saj hekurudhorë nuk e kalojnë kufirin e vendit. Asnjë aeroplan i huaj nuk lejohet të fluturojë mbi hapësirën e saj ajrore. Fluturimet e aeroplanëve të udhëtarëve, siç është ky i yni, gjysmë i zbrazur, që fluturon nga Beogradi dy herë në javë, duhet të bëhen vetëm nga deti dhe vetëm gjatë ditës."

Edhe vetë avioni i përshkruar nga gazetari është i shkretë, si dhe vendi në të cilin po shkonte:

"Unë pashë në avion një pasagjere – një grua të vjetër, diplomate, profesoreshë austriake e gjuhës shqipe (e lidhur prej së largu me gjuhët

tjera evropiane) dhe një biznesmen që po vinte për të blerë minerale ose të shiste makineri. Si i plotësova unë kushtet e vëna nga diktatori i Shqipërisë Enver Hoxha për të marrë vizë që të vizitoja këtë vend? Një vend që ai e kishte shpallur, 'vendin e mbyllur ndaj armiqve, spiunëve, hipive dhe huliganëve, por të hapur për revolucionarët (marksistë ose jomarksistë), si dhe për demokratët përparimtarë, turistët e ndershëm…, të cilët nuk ndërhynin në punët e brendshme.'

Fotografi nga Mehmet Biber, Berat 1980

Komenti më me vend ishte ai i një agjenti udhëtimesh: "Vetëm të çmendurit, diplomatët dhe gazetarët vijnë në Shqipëri". Unë isha gazetar turk dhe kisha pritur, gati një vit, për të marrë një vizë hyrjeje në Shqipëri.

Po fluturonim përmbi plazhin dhe fushat bregdetare të Durrësit dhe pamë, përtej kodrave me taraca, një varg të dhëmbëzuar majash të mjegulluara, që rendnin drejt horizontit si një elektrokardiogramë gjigande. Unë pyesja veten, çfarë do të gjeja në këtë vend të vogël me 2,7 milionë banorë, me madhësi sa Maryland, por me popullsi më të vogël, aq pak i njohur sa edhe Tibeti. Sepse mijërat e pasardhësve të fiseve tradicionalisht të njohura si ilirike janë mbajtur në këtë vend maja-maja në 'malet', që në turqisht, njihen si Ballkanike. Majat më të larta arrijnë deri në 2.764 metra lartësi; këta njerëz janë udhëhequr nga një kanun

fisnor nderi të paepur, që fshin nga faqja e dheut familje të tëra nëpërmjet gjakmarrjes që shtrihet në gjenerata të tëra njëra pas tjetrës.

Sot ky Vend i Shqiponjave është tërësisht i kolektivizuar. Si bastioni i fundit stalinist, ky është vendi më komunisto-dogmatik i Evropës; vend i mbyllur, i zënë peng prej një udhëheqësi, i cili e ka shtrënguar kombin më të prapambetur të kontinentit, të dalë nga hiri i Luftës së Dytë Botërore, të marrë një udhë modernizimi nga parmenda e dorës, për te traktori, nga puna e krahut dhe kandili te fabrikat dhe dinamot.

Këtu unë do të gjeja një eksperiment të pazakonshëm social: një gjeneratë e tërë që rritet krejtësisht e mbyllur brenda një laboratori të tmershëm socialist, duke sfiduar botën, e vetëizoluar, e pandikuar as nga Lindja, as nga Perëndimi.

Në mënyrë të pandërgjegjshme e përdrodha mjekrën time majuce – dhe u tremba me ta marrë vesh se mund ta humbisja atë! Shqipëria ndalon hyrjen e burrave me flokë të gjatë ose me mjekra të plota, ndërsa për gratë fundet e shkurtër, pantollonat me qëndisje dhe ndonjë gjë tjetër që manifeston dekadencën borgjeze. Tregime për vizitorët e gjorë që nuk kishte kush t'i ndihmonte e që dërgoheshin te berberi i aeroportit për t'i qethur, këtu gjenden me shumicë."

Pasi përshkruan udhëtimin nga Aeroporti i Rinasit për në Tiranë në një rrugë pa trafik, gazetari na jep një tablo të qartë të jetës në kryeqytetin shqiptar:

Polic trafiku… pa trafik…

"Jeta në Tiranë përqendrohet rreth Sheshit Skënderbej. Aty gjendet monumenti i heroit dhe emri këtij sheshi i është vënë në kujtim të Heroit të shekullit XV, i cili luftoi kundër Perandorisë Osmane. Pallati modern i Kulturës i qëndron përbri sikundër shumë ndërtesa mbretërore të Mbretit Zog, i cili sundoi në fund të viteve 1920 dhe gjatë viteve '30. Një prej tyre tani është vendi ku botohet revista satirike Hosteni; një tjetër, ndërtesë e vjetër është ajo e parlamentit, që tani është kthyer në teatër fëmijësh.

Në një gjatësi rreth një kilometër nga Sheshi Skënderbej deri tek Universiteti, shtrihet Bulevardi Dëshmorët e Kombit me statujat gjigande të Leninit e të Stalinit, të cilat qëndrojnë në të dyja anët, me Komitetin Qendror të Partisë, me ministritë kryesore dhe me stadiumin e futbollit. Në mbasditen e hershme, sheshi duket i shkretuar; një makinë zyrtare, një makinë ushtarake, një autobus, disa biçikleta, gra që kalojnë nga një trotuar

në tjetrin... E, megjithkëtë mungesë lëvizjeje, në qendër të sheshit qëndron një polic trafiku, i cili me solemnitet drejton trafikun.

Shqipëria nuk lejon makina private dhe kryeqyteti i vendit ka vetëm një vend taksish, pronë e shtetit. Më shumë ato prehen diku pranë sheshit. Shqiptarët hipin rrallë në taksi. Ne ndaluam përpara Hotel Dajtit, i ndërtuar nga italianët në fillim të viteve ’40 kur bulevardi pati marrë emrin Viale Savoja. Ky është njëri prej dy hoteleve të Tiranës, ku lejohen të flenë të huajt, ndërsa për vendësit,



Fotografi nga Mehmet Biber, 1980
Universiteti i Tiranës

Fotografi nga Mehmet Biber, 1980
Bregdeti shqiptar

Dhoma ime kishte ballkon dhe ishte e zbukuruar me një qilim të bukur. Në katin e parë, në dyqanin e dhuratave, një metër katror e një qilimi të tillë shitej për 20 dollarë në monedhë të huaj. Hapa televizorin që gjendej në dhomë. Munda të zë vetëm programin e televizionit vendas. E studiova njoftimin e shtypit që ishte shpërndarë nëpër tavolina në një sallon të madh dhe mbeta pa frymë nga ajo paraqitje që bënte revista 'Shqipëria e Re'.

'Zëri i Popullit' ishte gazeta e partisë dhe një mostër e të përditshmeve shqiptare, të gjitha të njëjta në përmbajtje. Veprat e Enver Hoxhës gjendeshin në disa gjuhë të huaja – por asnjë gazetë, revistë ose libër. Ishte krejt sikur bota përtej këtij vendi nuk ekzistonte.

Duke dalë nga mugëtira e hotelit, u ktheva përsëri te Sheshi Skënderbej. Çfarë ndryshimi! Dukej sikur gjysma e popullsisë prej 200.000 banorësh ishte mbledhur këtu pas punës. Disa shëtisnin poshtë e lart rrugës përgjatë Bulevardit Stalin, që i ngjante një parku, të tjerë bisedonin në grupe të vogla ose mblidheshin afër ndonjë kioske për të blerë cigare të prodhimit shqiptar, pije të buta dhe gazeta. Të rinjtë dhe të rejat flirtonin. Prindërit derdheshin për te Pallati i Kulturës për ndonjë koncert, lojë ose ekspozitë, ndërkohë që studentët mbushnin Bibliotekën

Kombëtare. Dhe në mes të kaosit të shkaktuar prej autobusëve, biçikletave dhe këmbësorëve, polici i trafikut çirrej me bilbilin e tij për të mbajtur rregullin në trafik.

Për gati dy orë, zemra e Tiranës pulsonte nga jeta dhe pastaj binte në qetësi përsëri. Madje edhe polici i trafikut kishte shkuar në shtëpi."

KOMBI KUNDËRSHTON GJIGANDËT 'REVIZIONISTË'

"Mëngjesin tjetër përkthyesi im që më drejtonte, më çoi nëpër mjediset e Pallatit të Kulturës. Shqiptarët janë krenarë për këtë ndërtesë të filluar prej kohës së rusëve dhe e lënë përgjysmë kur ata ikën në vitin 1961 si rezultat i një çarjeje ideologjike. Ciceroni im më tha: "Revizionistët sovjetikë dhe imperialistët i prenë tërë ndihmat ndaj nesh dhe na imponuan bllokadë ekonomike, duke shpresuar se ne do të merrnim fund shumë shpejt. Por ne i mobilizuam forcat tona dhe e përfunduam ndërtesën. Kjo sot qëndron si simbol i triumfit tonë".

Duke u ndarë nga 'Grupi renegat i Hrushovit', Hoxha u kthye nga armiku më i egër i Bashkimit Sovjetik, Mao Ce Duni i Kinës.

Shqipëria u bë miku më i ngushtë i Kinës, u bë kampioni i saj në Kombet e Bashkuara dhe mori prej saj midis një ose dy miliardë dollarë ndihma ekonomike dhe ushtarake. Kjo zgjati deri në vitin 1978 kur, përmirësimi i marrëdhënieve të Kinës me Shtetet e Bashkuara, përçanë, 'miqësinë e përjetshme shqiptaro-kineze'. Duke pretenduar që të shihte përtej "qeshjeve hipokrite" të pasardhësve të Maos "pabesinë …e atij që ta fut thikën pas shpinës natën dhe të varros ditën", Shqipëria tani pëlqeu të mbetej e vetmja kështjellë e 'Marksizëm-Leninizmit' të vërtetë.

Ku do të shkonte Shqipëria këtë herë?"



Fotografi nga Mehmet Biber
Shkodër 1980
Pa koment

Autori i shkrimit na çon kësaj here te dekori komunist që skuqte tërë Shqipërinë nëpërmjet parullave të pafund që zinin çdo fasadë.

"Nga Tirana për te fshati më i vogël, rrugët, ndërtesat, fabrikat, shkollat, dhe fermat ishin të mbushura me parulla që i jepnin përgjigje kësaj pyetjeje.

"Ne mbështetemi në forcat tona pa asnjë kredi dhe as ndihmë të huaj". Në Komitetin e vjetër Ekzekutiv: "Ne do ta çajmë bllokadën dhe rrethimin imperialisto-revisionist." Sipër taracës së Kryeministrisë shkruhet: "Rroftë Populli ynë trim punëtor dhe liridashës!" Në një dërrasë të zezë të një shkolle ku mësohej gjuhë e huaj, shkruhej parulla e Enver Hoxhës në gjuhën angleze: "Ne ndërtojmë socializmin duke mbajtur në njërën dorë kazmën e në tjetrën pushkën"

"Si do të mund ta bëjë këtë?" - është pyetja që bën autori dhe përgjigjet:

"Dukë vënë në lëvizje tërë prodhimin. Uzinat shpesh punojnë me tri turne, në mënyrë që t'i përdorin makineritë 24 orë në ditë. Pashë traktor nëpër fusha me drita të ndezura e pastaj me mjete transporti tek shkonin nga një fermë në një tjetër për të arritur që të fillonin plugimin e tokës që në mëngjes. Si pjesë e 'revolucionit teknik' disa inxhinierë, teknikë dhe punonjës të tjerë i shtonin ditës së tyre tetëorëshe të punës edhe disa orë tjera..."

"A ju paguajnë gjë për kohën e tepërt të punës?" - Këtë pyetje ia bëra një punëtori në fabrikën e traktorëve në Tiranë.

"Jo, ne nuk kërkojmë që të na japin gjë. Ne punojmë vullnetarisht, sepse besojmë se kjo është mënyra e vetme për të çarë bllokadën, ky shpirt revolucionar do të na udhëheqë drejt fitores."

"Punonjësit e shërbimit civil, studentët, madje edhe kuadrot e partisë dhe diplomatët, detyrohen që të punojnë një muaj punë fizike çdo vit në një fermë ose fabrikë. Brigadat e punës konkurrojnë me njëra-tjetrën për tejkalimin e planeve të prodhimit. Kjo shpërblehet me medalje, përmendje emri, emulacion socialist dhe me ndonjë ditë leje për pushime në kampet e punëtorëve. Qendrat e emulacionit janë të mbushura me fletëlavdërimi ose me fletërrufe, të cilat kanë si qëllim përmirësimin e moralit socialist dhe rritjen e prodhimit. Leva që e vë këtë në lëvizje është kritika dhe autokritika."

E ashtuqujtra 'Bllokadë ekonomike imperialisto-revizioniste ndaj Shqipërisë' përshkruhet në revistë si më poshtë:

"Në kombinatin e autotraktorëve 'Enver Hoxha' në Tiranë, kolegut tim Sami Kohen i treguan traktorin e parë të prodhuar në Shqipëri. Kur Kina ndërpreu ndihmat, ky kombinat, një digë hidrocentrali, miniera të ndryshme dhe projekte të tjera madhore mbetën të pambaruara."

"Teknikët kinezë morën me vete të gjitha projektet", - na tha drejtori i kombinatit plot mllef…, - "Pastaj ata deshën që të sabotonin kombinatin, duke refuzuar që të sillnin makineritë e premtuara. Por ne e përfunduam uzinën duke i marrë makinat dhe pjesët në vende të tjera. Jo si ndihmë e huaj apo kredi. Ne u velëm me këto ndihma prej rusëve dhe kinezëve. Nëse diçka na duhet, atëherë atë gjë e blejmë

prej një vendi tjetër me para në dorë. Ose bëjmë tregti me klering. Kjo është mënyra me të cilën ne e ruajmë pavarësinë."

Në të vërtetë Kushtetuta Shqiptare e vitit 1976 e ndalon edhe marrjen e kredive, edhe të borxheve qoftë nga bankat e Lindjes, qoftë nga ato të Perëndimit."

TË JETOSH MIRË SIPAS STILIT SHQIPTAR

Shumë pak vende të tjera mund të kishin zgjedhur këtë rrugë të vështirë për t'u zhvilluar. Por Shqipëria udhëhiqet nga një dorë e hekurt. Dhe shqiptarët janë mësuar me mungesat. Mjerimi që shkaktoi tërmeti dhe përmbytjet si rezultat i reshjeve të mëdha, pasuan tmerret e luftës. Kur ikën rusët, një thatësirë e zgjatur e pllakosi vendin duke e sjellë atë në gjendje urie; edhe gjërat e thjeshta morën trajtën e luksit.

Çuditërisht, sot, Shqipëria edhe pse është larg së qeni e përparuar nuk ka mungesa serioze dhe racionim ushqimesh.[143] Njerëzit janë të veshur thjesht, por nuk mund të thuash se janë të leckosur. Familjet jetojnë në apartamente të vogla ose në shtëpi private të pajisura në mënyrë të varfër po të krahasohen me standardet perëndimore. Por të krahasuara me mizerjen që kanë lënë pas, shqiptarët nuk dyshojnë se janë më mirë sot se dje. Dhe ata krenohen me dëshirën e tyre për të mbijetuar në mënyrën e vet: "Ne, më mirë hamë bar nëse nevojitet, se sa tua shtrijmë dorën imperialistëve"- dëgjon të thuhet në këtë vend.

Regjimi i Hoxhës e nisi reformën agrare në vitin 1945 duke u marrë tokat pronarëve dhe duke ua shpërndarë atë fshatarëve. Kolektivizimi u përfundua në vitet '60. Rezultatet: drenazhimi dhe kontrolli i përmbytjeve në lugina, vaditje për fermat dhe tarracimi i

[143] Nga kjo del e qartë se, megjithëse autori i shkrimit ka mundur të vëzhgojë dhe të marrë në shënim me imtësi fakte nga jeta e përditshme shqiptare e asaj kohe, prapëseprapë 'çobani' që e ruante atë, ka mundur t'i fshehë një fakt që është më i rëndësishmi në jetën e atyre viteve. Autori i kësaj përmbledhje i këtij materiali në atë kohë ka qenë 29 vjeç dhe e mban mend mirë se racioni ishtë vënë për ushqimet kryesore, ku, veçanërisht, përfshiheshin mishi, mishi i pulës, qumështi dhe tërë prodhimet blegtorale. Motoja e vetme në atë kohë ishte: 'Lufta për bukë është luftë për socializë' dhe tërë forcat ishin lëshuar në këtë drejtim, për të shmangur një uri masive që mund të pllakoste vendin.

kodrinave. Tokat malore të lërueshme, që një herë e një kohë, zinin vetëm 10% të sipërfaqes tani janë dyfishuar, malarja është zhdukur, ndërsa shërbimi mjekësor është përmirësuar dukshëm. Katër dhjetëvjeçarë më parë, jetëgjatësia e pritshme e shqiptarëve ishte 38 vjet. Sot ata presin të jetojnë 68.

Në sfidën e saj ndaj botës, Shqipëria, gjithashtu, mund të mbështetet në burimet e saj minerale dhe energjitike. Pas Afrikës së Jugut dhe Bashkimit Sovjetik, Shqipëria renditet e treta në prodhimin e kromit. Duke pasur parasysh sesa pak konsumon për vete, asaj i mjaftojnë energjia, vajguri, disa qymyre dhe energjia elektrike e prodhuar nga hidrocentralet. Pashë linja tensioni të lartë gjithkund nga shkova në atë vend. Edhe fshatrat më të vogla malore ishin elektrifikuar, madje, Shqipëria shet teprica të energjisë elektrike në Jugosllavi dhe në Greqi.

Prodhimet industriale, minerale dhe bujqësore mbushin ekspozitën 'Shqipëria Sot'. "Çdo gjë është prodhim i punonjësve dhe i sakrificave të njerëzve tanë", - më tha drejtori i ekspozitës. "Ne, madje, prodhojmë mjaft ushqime edhe për eksport. Kriza botërore e energjisë nuk ka ndonjë efekt te ne. Ne prodhojmë çdo gjë, që prej radios deri te enët e guzhinës. Të gjitha këto i bëjmë me forcat tona pa ndihmën e askujt nga jashtë".

Kaq fanatikë janë në idenë e tyre të mbështetjes në forcat e veta, sa shqiptarët nuk i pranuan ndihmat e ofruara nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar kur një tërmet e shkatërroi rajonin e Shkodrës në veri të vendit, në prill të vitit 1979.

Nëpër tërë Shqipërinë pashë djem e vajza studente duke ndërtuar rrugë, duke ngritur shtëpi, duke lëruar ara, duke punuar në fabrika. Sistemi hekurudhor i Shqipërisë po zgjatet drejt veriut bazuar më së pari në punën e studentëve.

"Puna fizike u lejon studentëve që të njohin vendin dhe njerëzit tanë më mirë, rrit njohuritë praktike, ndihmon në arsimimin praktik dhe, kështu, ndërtojmë socializmin."

Pashë studentë të historisë në Universitetin e Tiranës. Përveç gjashtë ditëve të javës në mësim, studentët bënin edhe një ditë të plotë stërvitje ushtarake.

"Çfarë bëni pas mësimit?"

"Studiojmë leksionet e marra në mësim".

"Po në kohën tuaj të lirë?"

"Shëtisim…shkojmë në teatër ose në kinema…dëgjojmë muzikë klasike…"

Viti shkollor zgjat 8 muaj. Pastaj, për studentët, vjen muaji i punës fizike e më pas muaji i stërvitjes ushtarake si për djemtë, ashtu edhe për vajzat. Të gjithë ata që mbarojnë shkollën e mesme duhet që të punojnë një vit në fabrikë ose në fermë përpara sesa të zënë punë ose të hyjnë në universitet.

"Dhe pas diplomimit çfarë ndodh?"

"Një vit stërvitje përpara se të zësh punë. Një i diplomuar në mjekësi shërben në një spital, ata të inxhinierisë në fabrika, ndërsa të filozofisë ose të filologjisë, zakonisht, japin mësim."

Drejtuesit e administratës së Universitetit na thanë se 80 % e popullsisë në vitin 1938 ishte analfabete; sot 80% e popullsisë shkruajnë dhe lexojnë. Universiteti u hap në vitin 1957 me 3.600 studentë. Sot janë të regjistruar 16.000 studentë në shtatë fakultete: inxhinieri, shkenca politike, gjeologji, histori, ekonomi, mjekësi dhe shkenca të natyrës.

Revista *National Geographi*c botohet në vendin më demokratik në botë. Ajo nuk mund të anashkalonte mungesën e plotë të respektimit të të drejtave të njeriut dhe, për këtë, autori është ndalur te një fakt shumë kuptimplotë:

"Por për avokatë nuk ka fakultet! Përse ndodh kjo?" Pyet ai dhe merr këtë përgjigje:

"Sistemi ynë nuk ka nevojë për avokatë. Qytetarët tanë nuk kërkojnë një person të tretë për t'i mbrojtur. Gjykatësit e gjykatave popullore, të zgjedhur nga populli, i marrin të drejtat e tyre në konsideratë. Në mënyrë të frikshme, Ministria e Drejtësisë u zhduk nga administrata e shtetit në një prej reformave të Enver Hoxhës."

Në përpjekjet e saj për të nxjerrë në pah çdo arritje të popullit tonë, revista ndalet tek arsimimi, por për fat të keq në këtë rast ajo vë re si më poshtë:

"Marksizëm-leninizmi është shtylla kurrizore e të gjithë sistemit mësimor në të gjitha fakultetet, që çon deri te *'formimi ideologjik'* i studentëve. Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, ekonomia politike e kapitalizmit dhe e socializmit, materializmi dialektik,

'revizionizmi', filozofia dhe, sigurisht, veprat e Enver Hoxhës janë lëndët bazë. Plani pesëvjeçar përfshin pranimet në universitet me kuota të përcaktuara sipas rrethit dhe punëve që bëjnë familjet – një e treta e së cilës janë punëtorët, punonjësit e fermave dhe intelektualët. Ata, familjet e të cilëvë kanë qenë pronarë tokash ose tregtarë gjatë regjimeve të mëparshme ballafaqohen me vështirësi të mëdha."

"Çfarë ndodh nëse studenti rrëzohet në provim?"

"Rinia jonë është idealiste. Në fund të vitit, 96% e studentëve e kalojnë klasën. Ata që rrëzohen në provime, dërgohen në fermë ose fabrikë. "Mos harroni se plani ynë pesëvjeçar përcakton sesa mjekë, inxhinierë, gjeologë, shkencëtarë dhe mësues i nevojiten vendit çdo vit. Universiteti nuk mund të përgatisë më pak sesa ka nevojë vendi. Neve na duhet që të kemi të rinj të mirë dhe të përgatitur, me qëllim që të realizojmë detyrat e planit."

Në atë sistem të çuditshëm, në të cilin ka jetuar brezi im, revista zbulon përpara opinionit botëror atë që shteti është zot i gjithçkaje. Nuk ka sektor të jetës që të ketë mbetur privat, nuk ka veprimtari jetësore që të mos kontrollohet nga shteti dhe të mos planifikohet nga shteti. Ja si vijon Mehmet Biber në shkrimin e tij të tetorit 1980:

'Plani', fjala që duket se ndjell frikë sa herë shqiptohet. Në të vërtetë, në një ekonomi të tillë të centralizuar siç është kjo e Shqipërisë, plani është i shenjtë. Plani është i bazuar në pronësinë e plotë të shtetit mbi mjetet e prodhimit. Çdo dyqan, restorant, madje, edhe kioskë i përket shtetit. Çdo shofer taksie, berber, kamarier, furrtar dhe artist punon për shtetin. Punonjësit e bujqësisë punojnë ose për fermat shtetërore ose për kooperativat bujqësore.

Duke ardhur prej një vendi që vuan nga murtaja e inflacionit si Turqia, unë gjeta një joshje të pamohueshme në aspekte të caktuara të ekonomisë shqiptare. Nuk ka taksa. Nuk ka inflacion. Nuk ka varësi nga burimet e jashtme. Dhe derisa çdo gjë është ngushtësisht e kontrolluar prej shtetit, nuk ka as rritje çmimesh, as rritje rrogash.

Punëtorët e fabrikave dhe të bujqësisë, zakonisht, marrin 600 deri në 700 lekë në muaj (një dollar vlen pesë lekë); një profesor

universiteti rreth 1.000 lekë. Niveli i rrogës ka një tavan që nuk shkon më lart se 1.200 lekë, përveç zyrtarëve më të lartë të partisë.

Sipas standardeve perëndimore pagesat janë të ulëta. Por kështu janë edhe çmimet. Në dyqan unë gjeta mish prej 12 deri 18 lekë kilogramin. (2.35 cent per kilogram); një paketë cigare e prodhimit vendas kushton 2 lekë (40 qindarka të dollarit).

Të veshurit është shpenzimi që merr thuajse pjesën më të madhe të buxhetit familjar. Pashë për kostume të prodhimit shqiptar që kishin çmim sa një rrogë mujore, por që nuk desha ta blija. Këpucët janë 100 lekë, këmishët 50 lekë – por cilësia është e dobët. Plani e kufizon importin e Shqipërisë në 250 milionë dollarë e që më shumë shpenzohet për makineri kryesore, pjesë këmbimi, lëndë të para, të balancuara prej eksporteve.

Shqipëria i mban qiratë e ulëta – zakonisht jo më shumë se 5% të të ardhurave të familjes. Por autoritetet e pranojnë se ka mungesë apartamentesh, në veçanti për çiftet e reja të sapomartuara.

Shërbimi mjekësor dhe arsimimi janë pa pagesë, ndërkohë që Shqipëria shpenzon pak në transport dhe në argëtim. Madje edhe vetë Tirana ofron pak zbavitje: ca teatro, filma me përmbajtje ideologjike, drama, opera dhe programe folklorike, por jo klube nate të cilat vijnë erë dekadencë borgjeze.

Tirana ka më shumë restorante se qytetet e tjera, por vetëm pak njerëz mund t'ia dalin që të darkojnë në to. Shqiptarët kanë rakinë e tyre të fortë të bërë prej rrushi, si dhe konjakun, verën dhe birrën. Por ata nuk janë pijanecë. Në Tiranë një djalë mund ta marrë të dashurën e tij te një park nëse e lejon moti ose të shohë një film me një temë të preferuar – Luftën antifashiste nacionalçlirimtare.

Periudha kur gazetari e vizitoi Shqipërinë është mjaft kritike. Deri dy vjet para arritjes së tij në Tiranë, Shqipëria ishte mike e ngushtë me Kinën. Për fat të keq, miqësia shqiptaro-kineze kishte reflektuar në zbatimin e një politike kineze në kulturën shqiptare, e njohur tashmë si *revolucioni Kkulturor*. Ajo kohë përfshiu me dhjetra artistë e kuadro të kulturës nëpër burgje, internime, madje edhe ekzekutime. Është periudha kur nga skena e artit shqiptar janë zhdukur, tashmë, emra si Kujtim Spahivogli, Lluk Kaçaj,

Mihallaq dhe Edi Luarasi, Ali Oseku, Justina Aliaj…

Ja si e përshkruan autori:

> "Sami Kohen shkoi në një mbrëmje vallëzimi të organizuar nga kolektivi i një fabrike në Pallatin e Kulturës. Çiftet e reja vallëzonin të qeta tango the foks, të luajtura nga një orkestër amatore. Gjithkund mbretëronte disiplina.
>
> Në fakt, *revolucioni kulturor* i Shqipërisë është ai që i jep tonin sjelljes dhe dukjes së rinisë. Jo vetëm flokët e gjata dhe minifundet por gjithashtu edhe blu-xhinset, pantallonat e ngushtë dhe tualeti janë tabu. Nuk ka drogë, seks para martesës, shaka të pakuptimta ose çamçakëz. Muzika rrok dhe xhazi shkaktojnë mërzinë e autoriteteve."

Shqipëria e atyre viteve duket si vendi më i shkretë që njeriu mund të mendojë sot. Në të vërtetë, për një njeri si autori i këtyre radhëve, i cili për vite të tëra ka kaluar, thuajse, çdo mëngjes dhe mbrëmje para Hotel Dajtit, por që ka guxuar të pijë një kafe brenda tij vetëm në vitin 1991, nuk është aq e çuditshme. Por për brezat e rinj të Shqipërisë, që e shohin kryeqytetin e tyre të mbuluar nga reklamat perëndimore, nga diskot dhe nga pubet, kjo do të ishte vërtetë diçka e çuditshme. Dajti ishte i vetmi vend ku të huajt gjenin pak prehje. Ndërkohë ata mundoheshin të shfrytëzonin ndonjë lidhje në ambasadat e huaja ku të argëtoheshin, si dhe të mësonin diçka më shumë për këtë vend. Ja tabloja që na paraqet Mehmet Biber në shkrimin e tij:

> "Vizitorët e huaj, zakonisht, i kalojnë mbrëmjet në barin e Hotel Dajtit, në tavernë dhe në restorant ku guzhina është relativisht e mirë. "Përveç pritjeve që japin ambasadat, është vështirë të gjesh ndonjë vend tjetër ku të shkosh, të bësh ndonjë gjë ose të gjesh ndokënd me të cilin të flasësh", - ankohet një diplomat perëndimor, posti i mëparshëm i të cilit kishte qenë Parisi."
>
> "Unë e ktheva shërbimin tim diplomatik në një mundësi për të mësuar më shumë rreth rrënjëve të dyshimit shqiptar ndaj botës, jashtë kufijve të saj.
>
> "Nëse do të isha shqiptar, edhe unë do të dyshoja," - fillon informacioni im. -Shpesh fqinjët grabitqarë e kanë pushtuar

Shqipërinë: Serbia, Mali i Zi dhe Greqia kanë marrë pjesë të mëdha të territorit shqiptar. Mos harroni, një milion e gjysmë shqiptarë jetojnë sot në Jugosllavi, sa gjysma e atyre që gjenden në Shqipëri. Që prej 70 vjetësh Greqia pretendon të marrë Epirin, i cili s'është gjë tjetër veçse Jugu i Shqipërisë. Ndërkohë, para kësaj gjendjeje diplomatët perëndimorë s'bëjnë gjë tjetër vetëm kërcasin gishtërinjtë. Musolini marshoi dhe e pushtoi krejt vendin në vitin 1939. Titoja deshi ta bënte Shqipërinë republikë të shtatë jugosllave. Një histori si kjo, padyshim, që lë pas vragë të thella.

Shqipëria sot nuk ka marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bashkuara, Britaninë, Gjermaninë Perëndimore. A do të ndryshojë kjo politikë tani që Shqipëria është ndarë edhe nga Bashkimi Sovjetik edhe nga Kina?"

"Shtetet e Bashkuara janë superfuqi imperialiste, po aq kërcënuese sa edhe Rusia, social-imperialiste dhe sa Kina revizioniste," - i tha Sami Kohenit një punonjës i lartë i Ministrisë së Jashtme. - "Amerikanët u përpoqën të na afroheshin pas shkëputjes sonë me kinezët, por ne nuk duam të kemi të bëjmë aspak me ta."

"Britania ende na i mban 40 milionë dollarët e floririt shqiptar të rrëmbyer pas Luftës së Dytë Botërore," - ankohet një gazetar. - "Gjermanët refuzojnë që të na paguajnë dëmshpërblimet e Luftës të llogaritura 4.5 miliardë dollarë. Ne kurrë nuk do të pranojmë marrëdhënie diplomatike me ndonjërin prej këtyre vendeve, pa na i paguar ato që na kanë borxh."

Në rrjedhën e vlerësimeve dhe të konstatimeve të bëra, Mehmet Biber vë re se Shqipëria edhe për disa kohë do të ishte peng i së shkuarës së saj. Në të vërtetë, vetëm pak vjet pas botimit të këtij shkrimi, Enver Hoxha vdiq, por vendi u përpëlit edhe për disa vite të tjera nën sllloganet e vazhdimësisë së veprës së tij, duke e shëmtuar edhe më keq tërë peizazhin e dukshëm e të padukshëm të vendit tonë, shkaktuar prej një këmbënguljeje të njerëzve të atëhershëm në fuqi, që i bënte ata të ishin figurat më tragjikomike të historisë së vendit tonë:

"Shqipëria e ka marrë trajtën e sotme sipas imazhit që i ka dhënë asaj Enver Hoxha, i cili tani është në të shtatëdhjetat. Po pas tij? I përmenda botuesit e një reviste humoristike të quajtur Hosteni, ndryshimet në Bashkimin Sovjetik pas Stalinit, dhe të Kinës pas Mao Ce Dunit. A ka ndonjë mundësi që edhe Shqipëria të zbutet pas Enver Hoxhës", - i thashë.

"Ju na krahasoni ne me ato vende revizioniste?" - m'u kthye ai aspak i kënaqur. -"Jo, asgjë nuk do të ndryshojë pasi shoku Enver të vdesë. Partia dhe kombi janë të bashkuar fuqimisht. Mësimet e tij na rrëfejnë udhën. Ne kurrë nuk do të devijojmë prej saj."

Në vend që të hapen ndaj botës, shqiptarët e vetizoluar mbahen në mënyrë të vazhdueshme në një balancë lufte. Përveç dy viteve të shërbimit ushtarak, të rinjtë dhe gratë, si dhe të gjithë trupat e aftë qytetarë, pa dallim profesioni, duhet të shërbejnë një muaj ose edhe më shumë për çdo vit në forcat e armatosura. Shumë shpesh bëhen stërvitje ushtarake në fabrika, ferma dhe zyra, për t'i përgatitur njerëzit në rast sulmi.

Kudo që udhëtova – në bregdet, në luginat e maleve, në fusha, në parqet e qyteteve, midis blloqeve të pallateve – pashë bunkerë për mbrojtje civile. Ata duken dhe rriten si kërpudha, që është edhe emri i tyre popullor. "Më shumë hekur dhe çimento shkon për bunkerët sesa për shtëpitë," - më tha një diplomat.

E dija se Enver Hoxha ishte i shqetësuar për të ardhmen e Jugosllavisë pas Titos – dhe ankthi i pushtimit sovjetik e mban atë në frikë të përhershme.

A ndihet vërtetë Shqipëria e kërcënuar?

"Ne duhet të jemi të përgatitur për më të keqen," - më tha një gazetar shqiptar.

Por Shqipëria a mund t'i rezistojë një sulmi të një fuqie madhore?

Armatimi shqiptar, më shumë i prodhimit kinez është i demoduar dhe diplomatët në Tiranë thonë se qeveria shqiptare mund të jetë duke kërkuar armë në Evropë.

Edhe nëse armiku është numerikisht superior, ne mund ta ndalojmë atë. I tërë kombi mund të mobilizohet menjëherë. Malet dhe lumenjtë e bëjnë Shqipërinë një fortesë natyrore. Çfarëdo lloj sulmi që do të ndërmerrnin armiqtë tanë, atyre mund t'u kushtojë rëndë.

Mendova për ato shtëpi guri në Gjirokastër dhe në qytete të tjera malore, ato për mure pa dritare dhe frengji që u japin atyre pamjen e fortesave - trashëgimi e shekujve të gjakmarrjes - dhe m'u kujtua kështjella e shekullit XV në Krujë - një kështjellë prej nga Skënderbeu drejtoi për 25 vjet luftën e tij të paepur kundër otomanëve.

I lindur me emrin Gjergj Kastrioti dhe i marrë peng që në fëmijëri në oborrin e sulltanit, ai u ngrit në komandën e lartë të Perandorisë Osmane, i riquajtur Aleksandri i Madh (Iskander në turqisht), të cilin turqit e admironin. Skënderbeu dezertoi dhe, në krye të 300 kalorësve shqiptarë, rivendosi nderin e vendit të tij në vend. Ai braktisi islamin dhe ndali furinë turke në Evropë deri sa vdiq në vitin 1468.

Ai jetoi si simbol i rezistencës. Ishte flamuri i Skënderbeut - me shqiponjë të zezë dykrenare - ai që i udhëhoqi partizanët e Enver Hoxhës për të farkëtuar Shqipërinë e sotme."

Autori i shkrimit ndalet edhe te një ndër dukuritë më të çuditshme që qeveria komuniste u imponoi shqiptarëve, te mohimi i besimit ndaj Zotit. Në të vërtetë, në atë kohë ishin botuar në Shqipëri librat *'Gjyq Zotit',* autori i të cilit mburrej rrugëve të Tiranës se, për këtë, Papa i Romës e kishte dënuar me vdekje. Ndërkohë, i vetmi muze atesit në botë ishte ngritur në qytetin me traditat më të shkëlqyera fetare të Shqipërisë, në Shkodrën e Vaso Pashës, Fishtës, Mjedës, Jubanit, Koçit etj. Autori me të drejtë thekson se feja dhe besimi te Zoti në Shqipëri janë dënuar në emër të një feje tjetër, të asaj Marksiste-Leniniste dhe të një 'Zoti' tjetër, Enverit. Ja si e përshkruan ai këtë:

"Shiu i hedh një tis të hirtë Liqenit të Shkodrës. Shteti e ndalon *opiumin për popullin* dhe e shpërndan atë në malet e egra të Alpeve të Shqipërisë, të cilat i bëjnë rojë kufirit me Republikën Malazeze të Federatës Jugosllave. Brigjeve të liqenit, i cili rend drejt Adriatikut në një kurm të lundrueshëm, shtrihet Shkodra, kryeqyteti i lashtë i Ilirisë. Duke bluajtur në mendje karakteristikat e një kryeqyteti të tillë mesjetar, më kujtohen mjeshtrit venedikas. Një monument në parkun e qytetit nderon pesë heronjtë partizanë që e sakrifikuan vetveten duke

zmbrapsur 300 pushtues nazistë. Afër tyre gjendet Muzeu Ateist i Shkodrës, të cilin më dërguan që ta vizitoja.

Aty, nën një parullë që mbante poshtë saj emrin e Marksit, 'Feja është opium për popullin', drejtori, një burrë me flokë të thinjura, me zë të trashë dhe me një natyrë të ftohtë, më tha se feja ia kishte mbyllur rrugën pavarësisë së Shqipërisë.

Për shkak se turqit e njësonin kombësinë me fenë, shqiptarët e fesë myslimane (rreth 70% e popullsisë) konsideroheshin turq. Të krishterët ortodoksë (20% e popullsisë) quheshin grekë, ndërsa katolikët (rreth 10 %) quheshin latinë. Në këtë mënyrë, shërbesat fetare nuk kryheshin në gjuhën amtare, e cila ishte e ndaluar dhe, për më keq, nuk kishte as alfabet latin deri në vitin 1908, por në tri gjuhë të huaja: arabisht, greqisht dhe latinisht. "Gjatë luftës për të ndërtuar kombin tonë," - vazhdoi ai, ndërsa po më tregonte eksponatet mbi abuzimet e klerikëve, - "kishat shërbyen si kolonë e pestë për fashizmin, imperializmin dhe kundërrevolucionin." Autori më poshtë thekson:

Regjimi i Hoxhës e ekzekutoi klerin, e dënoi atë me punë të detyruar në kampe përqendrimi ose e çoi në 'punë prodhuese'. Edhe vende të tjera komuniste e mbajtën fenë nën fre; Shqipëria e ndaloi atë në vitin 1967, duke e shpallur veten 'të parin shtet ateist në botë'. Të gjitha 2.169 xhamitë, kishat, manastiret dhe 'qendrat e tjera të obskurantizmit dhe të misticizmit' qenë mbyllur, shkatërruar ose transformuar në qendra argëtuese, klinika, depo mallrash ose në stalla. Katedralja e madhe e Shkodrës kumbon nga zërat e 2.000 tifozëve të basketbollit.

Gjenerata e re e shqiptarëve di vetëm ateizëm. Feja marksiste-leniniste zëvendëson besimin fetar. Veprat e Enver Hoxhës të serializuara në gazeta, të cituara në radio, të përdorura për parrulla, shërbejnë si një *Testament i Ri.* Enver Hoxha vetë vlerësohet si 'profet - i zgjuar' deri në gjenialitet, largpamës dhe dashamirës, por, gjithashtu, i papajtueshëm me armiqtë e tij.

> Edhe pse jeton i ndarë nga populli i tij në një kompleks tejet të mbrojtur me roje, në perëndim të Bulevardit Dëshmorët e Kombit, edhe pse endet në Mercedes me perde të mbyllura, prapëseprapë Enver Hoxha është i gjithëpranishëm. Portretet e tij të vështrojnë prej çdo muri dhe ngado që të sillesh, madje edhe prej traktorëve ose kamionëve. Emri i tij është i skalitur nëpër faqe kodrash e malesh me

germa disametroshe të gjata. Shtëpia e tij e lindjes – një shtëpi guri dykatëshe në Gjirokatër – është kthyer në një vend të shenjtë kombëtar. Ai është një mjeshtër i vetëmbrojtjes staliniste. Si i tillë, ia ka dalë që të eliminojë, pa as më të voglën keqardhje, tërë kundërshtarët e tij.

Në tërë këtë përçudnim që ka pësuar vendi nën komunistët, revista nënvizon atë që, ndoshta, ishte më e dhembshmja: formimi i të ashtuquajturit *njeriu i ri shqiptar* me tiparet dhe vetitë e moralit komunist.

"Elita revolucionare, e bindur që natyra njerëzore mund të formohet nëpërmjet indoktrinimit të pareshtur, ka si qëllim që të farkëtojë *njeriun e ri shqiptar*, i cili në mënyrë të padiskutueshme bën çdo sakrificë në luftën e kombit të vet kundër 'rrethimit të egër imperialisto-revizionist', për të ndërtuar një shoqëri socialiste të çliruar nga herezia e individualizmit, e mendimit të pavarur ose e moralit të huaj.

Ndërkohë që orvatet të formojë një qytetar të ndryshëm nga e gjithë bota, ky komb i vogël ia ka lidhur këmbët vetes në mënyrën më të habitshme. Kombinati i madh metalurgjik të Elbasanit, i njohur me emrin *Çeliku i Partisë*; hidrocentrali i Fierzës i pagëzuar me emrin *Drita e Partisë*; një numër prej 700.000 nxënësish e studentësh, të regjistruar në shkolla kundrejt 56.000 prej tyre në vitin 1938; dy radio transmetuese në vitin 1945, në 52 në dy dhjetëvjeçarë; jetëgjatësia e pritshme gati e dyfishuar në katër dhjetëvjeçarë - sigurisht që janë arritje të habitshme.

Regjimi është duke u përpjekur, gjithashtu, që të heqë qafe strukurat patriarkale fisnore, që kanë shkaktuar kohezion social në malet e egra të Shqipërisë. Duke e bërë këtë, po e zhduk gjakmarrjen, e cila, jo më larg se në vitin 1920 shkaktonte në çdo katër meshkuj një vdekje. Po ashtu, gjakmarrjes për tradhti bashkëshortore po i jepet fund. (Tradita në malësi i jep burrit të drejtën që ta qëllojë të shoqen dhe të dashurin e saj. Familja e saj, me miratim ritual, i jep atij një fishek).

Në të vërtetë autori me dashamirësi ka theksuar faktin që shqiptarët ndërmorën reforma të thella për çrrënjosjen e disa zakoneve dhe dokeve të

këqia që ekzistonin, siç ishte fejesa e vajzave që në djep. Por, edhe pas kësaj, ai vë re dorën e Enver Hoxhës dhe të partisë së tij. Ai shkruan:

> Reformatorët i dhanë fund fejesave dhe shitjes së vajzave 12vjeçare dhe i goditën zakonet që i lidhnin gratë shqiptare me zinxhirë, tradicionalisht të konsideruara 'flokëgjata dhe mendjeshkurtëra'. Nuk ka kënd të jetës në Shqipëri, qoftë materiale ose shpirtërore, që t'i ketë shpëtuar etheve të Enver Hoxhës për ta kontrolluar. Njerëz me emra 'të papërshtatshëm' në pikëpamje politike, ideologjike ose morale duhet t'i ndërrojnë ata. As të vdekurit nuk i shmangen zellit për reforma të Enver Hoxhës. Varrimet, të paguara nga shteti, bëhen në varreza të përbashkëta, pa rite tradicionale fetare.
>
> Ktheje nga ana tjetër medaljen e shndritshme të arritjes në fushën e shkrimit e leximit dhe do të shohësh faqen e zezë të asaj që ka emrin *kontroll mbi mendimet e çdonjërit.* Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës përcakton gjithçka që njeriu duhet të lexojë, pikërisht sikundër shteti përcakton se kush do të punojë në një punë të caktuar e kush jo, kush do të dekorohet dhe me çfarë dekorate, kush do të dënohet dhe kush do të lirohet nga burgu.

Në fund të udhëtimit të tij autori bën një përmbledhje të dhembshme. Ky shkrim i jep lexuesit një tablo shumë të qartë të realitetit të fillimit të viteve '80. Edhe më shumë se kaq, ai na mëson ne, që e kemi përjetuar atë kohë dhe sidomos të rinjve që jetojnë sot në një sistem tjetër, që t'ua dimë vlerën gjërave. Ja si e mbyll Mehmet Biber shkrimin e tij në revistën National Geographic, të botuar në tetor 1981:

"Dora e ashpër e historisë ka mbjellë dyshim në psikologjinë e shqiptarit. Pas tri javësh në Shqipëri, unë kuptova sesa pak kisha qenë në gjendje të depërtoja përtej fasadës së këtij eksperimenti shoqëror kaq ogurzi.

Kurrë ndonjëherë, në udhëtimet e mia rreth e rreth botës, nuk kisha parë një shoqëri kaq të mbyllur, nuk isha ndier kaq shumë si në një ishull. I shoqëruar dhe i vëzhguar në mënyrë kaq të kujdeshme, të vazhdueshme dhe kaq nga afër, ndjeva se vetura e famshme me ngjyrë të verdhë, me të cilën udhëtoja, ishte si një boçë këmbane që paralajmëron arritjen e lebrozës mesjetare.

Udhërrëfyesi im më vinte nga prapa për të parë se çfarë po incizonte kamera ime. Ai më lejonte që të fotografoja jashtë kompleksеve industriale, por jo t'i shihja ata tek punonin, të vizitoja një digë hidrocentrali, por jo të shihja vetë centralin elektrik. Në një fabrikë pijesh alkoolike më dhanë të pija raki, por nuk munda ta shihja atë duke u prodhuar. Kërkesat e mia për të vizituar ndonjë familje ose shtëpi injoroheshin ose shmangeshin me mirësjellje.

Nuk lejoheshin marrje fotografish të bunkerëve, as të gomerëve, sigurisht asgjë primitive. Por ai më ndaloi edhe që të dubloja pamje nga kartolinat shqiptare. Një qytetar kundërshtoi që t'ia fotografoja fëmijët përpara Teatrit të Kukullave të Tiranës. Përkthyesi më prapësoi kur desha që të merrja fotografinë e një dasme. Regjimi i shtypte të tilla festa tradicionale. As nuk më kujtohet që, ndonjëherë, të kem parë një qen shtëpiak ose mace gjatë atij udhëtimi. Ky do të ishte luks borgjez.

Njëherë, kur fillova një bisedë të drejtpërdrejtë me një fshatar në gjuhën turke, shoqëruesi ndërhyri menjëherë dhe e ktheu bisedën në shqip, duke i përkthyer fjalët në të folurën e zakonshme partiake.

Sa për mbrojtjen, as që mund të hapja ndonjë bisedë me të. Ai ishte korrekt dhe i përzemërt, siç ishin të gjithë shqiptarët. Vetëm një herë munda të hasja në thyerje të traditës mikpritëse – kur një i ri në një fermë vreshtash afër Shkodrës pështyu përpara meje dhe më hodhi një fjalë kundër të huajve mu në fytyrë.

> Pasi i tregova për jetën time në Stamboll, për gruan dhe djalin tim, u përpoqa që ta nxisja përkthyesin të më tregonte edhe ai për familjen e tij. Por ai kurrë nuk e ngriti perden e jetës së tij, atë perde që më ngjante më atë të Mercedesit të Enver Hoxhës, që të mos më lejonte të hidhja një sy sado të shpejtë mbi jetën dhe mendimet e tij vetjake, private. *Në të vërtetë, ai dukej se mishëronte po atë qëndrim, po atë maskë që kombi i tij e vesh në mënyrë aq mospërfillëse.*"[144]

[144] National Geographic Magazine, *'Albania Alone Against the World'*, faqe 530-557.

...shpirti mospërfillës i Shkodrës ndaj pushtetit, ndoshta trashëgimi e krenarisë që e bëri këtë qytet kryeqendrën e Ilirisë, mbreti i fundit i së cilës ishte Genti, i mundur dhe i marrë në burg prej romakëve në vitin 168 p.e.r. bënë që historia e qytetit të jetë historia e zigzageve të vetë Shqipërisë.

Pas Romës, Bizanti pati ndikimin e vet, i pasuar prej valës së pushtimeve të gotëve, serbëve, bullgarëve, normandëve, venecianëve, turqve osmanë, italianëve dhe gjermanëve...

XIV

SHQIPËRIA MENJËHERË PAS RËNIES SË KOMUNIZMIT

Ishte ajo maskë mospërfillëse që do të çirrej në verën e vitit 1990, më pak se nëntë vjet pas botimit të shkrimit të Mehmet

Biber në revistën *National Geographic*. Pikërisht atë vit, Shqipëria u ballafaqua me revolta të brendshme, të cilat kërkonin, në mënyrë masive, ndryshime të ngjashme me ato që, tashmë, kishin filluar të ndërmerreshin në vendet e tjera të Evropës Lindore ose të ashtuquajturat vendet revizioniste. Në fund të atij viti formohet alternativa e parë demokratike, fillojnë ndryshime të rëndësishme politike, bëhen zgjedhje, më pas fillojnë reformat e thella ekonomike dhe dalin në pah tërë shkatërrimet e ndodhura në vendin tonë në një periudhë të stërzgjatur tmerresh komuniste. Revista kësaj radhe zgjedh të vendosë në faqet e veta shënimet e udhëtimit të një publicisti shumë të njohur, i cili e viziton Shqipërinë disa herë gjatë viteve 1991-1992. Ky ishte Dushko Doder, korrespondent i gazetës *Washington Post* në Moskë, autor i librave *'Hijet dhe pëshpërimat'*, *'Fuqitë politike brenda Kremlinit – Prej Brezhnjevit te Gorbaçovi'* dhe i biografisë së Gorbaçovit *'Heretik në Kremlin'*. Një ndër librat e tij më të fundit ai e ka shkruar në bashkëautorësi me Luise Branson: *'Milosheviçi: Portreti i një tirani'*.

Shkrimi i tij na jep një pasqyrë të qartë të katrahurës që ka lënë pas komunizmi në Shqipëri. Ai me dashuri të veçantë, por edhe një sens sa emocional aq edhe kritik, paraqet atë tablo të fillimit të transformimeve që po ndodhnin me tërë padurimin, zemërimin, mungesën e përvojës,

shpresën, dëshirat e zjarrta për të *'kapur'* botën, që demonstronin shqiptarët. Ja si e përshkruan ai Shqipërinë e atyre ditëve në shkrimin *'Shqipëria i hap dyert'*, i cili jo për rastësi ngjan të jetë vijim i shkrimit të

mëparshëm të revistës, me titull *'Shqipëria e vetme kundër tërë botës'*, që sapo u komentua më lart.

> "Duke lënë pas autobanën e mbushur plot e përplot me makina, hyra në rrugën që të çonte në një vend të mbyllur. Po ndiqja shenjat e vjetëruara, duke lënë pas një re pluhuri, si dhe botën e zhurmshme jugosllave. Po ecja drejt tokës së ashpër shqiptare. Në çdo kilometër që përshkoja, rruga sa vinte bëhej me më shumë gropa e pengesa. Shekujt largoheshin.
>
> Unë e quaj atë një rrugë për his të volisë. Druhem se ajo është mbajtur me qëllim në atë gjendje aq të keqe të pariparuar, në mënyrë që të dekurajojë pushtuesin, një problem që e ka shqetësuar Shqipërinë që në agimet e kohëve. Vetëm disa llokume dinamiti do të mjaftonin për të përmbysur ca gurë që do ta bllokonin kufirin.
>
> Ishte prag i vitit të ri 1990. Arrita në Shqipëri për herë të parë duke ndier një përzierje pasigurie dhe drithërimi. Si korrespondent i huaj kisha jetuar në disa vende komuniste, por ky vend kishte namin të ishte vendi më shtypës dhe më paranojak i të gjithëve.
>
> Një vend pak më i madh se Meryland, me një popullsi prej 3.4 milion banorë, ishte pikërisht në çastet kur po i hapte dyert botës së jashtme.
>
> Nën regjimin e Enver Hoxhës, i cili e udhëhoqi si feudal që nga viti 1944 deri në vdekje në vitin 1985, vendi u kthye në një prej diktaturave më të ashpra, ku bashkëshortet e anëtarëve të përjashtuar nga partia, urdhëroheshin që t'i ndanin burrat, ku njerëzit nuk mund të mbanin mjekra, ku të gjithë huatë, kreditë dhe bizneset e huaja ishin të ndaluara, ku feja ishte jashtë ligjit, ku po të kritikoje cilësinë e bukës, mund të përfundoje vetë dhe familja në burg… Madje edhe turistët nuk ishin të mirëseardhur. Sikundër vetë Hoxha thoshte: "Pse ta kthejmë vendin tonë në një han me dy porta, ku të hyjë derri e dosa?"
>
> E ngava makinën në një largësi sa ishte ajo e zonës neutrale midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, në pikën kufitare të Hanit të Hotit, dhe aty ndalova. Diku këtu ishte epiqendra e botës time. Pas meje, në lartësitë e Malit të Zi ishte vendi i fëmijërisë së babait tim; më tej, drejtpërsëdrejti rreth 30 kilometra më në jug, ishte qyteti i Shkodrës ku gjyshërit dhe gjyshet e nënës sime jetonin një herë e një kohë.

Ajri ishte i ngopur me erën e luleve të Adriatikut. Qetësia ime u prish prej një grupi udhëtarësh rrëmujaxhinj nga Jugosllavia. Ata po tërhiqnin

çantat dhe valixhet e tyre zvarrë përgjatë një rruge të pajetë e të ngushtë në drejtim të një rrjete telash me gjëmba dhe rojeve fytyrë-vrazhda që ruanin kufirin shqiptar. Mbeta duke i parë ata udhëtarë ngultas për një kohë të gjatë.

Nëse gjyshja ime nga ana e babait, e mbetur vejushë, nuk do të kishte shkuar në St.Luis me djemtë dhe vajzat e saj, unë fare mirë do të kisha qenë tani njëri prej këtyre njerëzve që po tërheqin zvarrë ato valixhe për në kufi. Por a do të isha unë përsëri ai që jam? A do të isha edhe unë një prej tyre? Kjo pyetje kishte për të më shoqëruar periodikisht gjatë udhëtimeve të mia në Shqipëri, të cilën do ta vizitoja gjashtë herë, pikërisht, kur ajo po bënte tranzicionin e dhembshëm nga komunizmi dhe nga trashëgimia e çmendur e Enver Hoxhës.

Roja e kufirit e tërhoqi mbrapsht një derë hekuri dhe më buzëqeshi. Ai më tregoi se ku duhej të parkoja dhe pastaj i ngjiti shkallët në stacionin e errët doganor. Unë i shkova pas.

Një grup tjetër burrash e grash po kalonte në anën tjetër – i pari grup vizitorësh që shkonte me leje të shtetit në Jugosllavi dhe ku do të shihnin të afërmit e tyre prej të cilëve ishin shkëputur për më shumë se katër dhjetëvjeçarë.

Pa thënë asnjë fjalë, roja kufitare i shpalosi të 30 faqet e pasaportës sime të mbushura më vula vendesh ku kisha shkelur duke i vështruar ato me ngulm sikur donte të zbulonte prej tyre ndonjë kod sekret. Kur mbaroi punë, ai e kaloi dokumentin tim te një burrë tjetër dhe pastaj më habiti duke m'u drejtuar me një anglishte të përsosur.

"Eja të pimë një pije ndërkohë që ju prisni për pasaportën". Ai e kishte mësuar anglishten duke dëgjuar këtë gjuhë të huaj nëpërmjet radios, një krim i dënueshëm me burgim nga Enver Hoxha.

Roja më priu për te kafja. Aty rrufitëm së bashku kafe të ëmbël dhe një Riesling të ëmbël shqiptar në dhomën tjetër. Ai nguli këmbë që të paguante, një instinkt i lindur ky i quajtur *'mikpritja shqiptare'*, të cilin unë do ta përjetoja shpesh e më shpesh. Nuk kundërshtoi kur i vura një karton me paketa cigaresh në tavolinën e tij. Brenda pak minutash pas hyrjes sime në Shqipëri, zbulova se, madje, edhe *diktatori më Onvellian* nuk do të kishte mundur që ta shtypte natyrën njerëzore plotësisht. Këtu kishte shpresa.

Duke dashur që të isha në qendër të gjërave, shpejtova rrugës për në kryeqytet, në Tiranë, duke ndier keqardhje që dija kaq pak për të parët e mi. Unë kurrë nuk isha interesuar të dija se përse prindërit e nënës sime

shkuan në Austro-Hungari, por ndoshta ata ikën për të njëjtat arsye që ikin edhe sot mijëra emigrantë shqiptarë, në kërkim të një jete më të mirë.

Prindërit e nënës dhe katër vëllezër kishin vdekur në kohën kur ajo ishte adoloshente dhe ajo kurrë nuk e vuri këmbën në Shqipëri. Asaj iu desh që të zhyste në harresë identitetin e saj, pasi u martua në një familje serbe dhe pasi komunizmi e mori fuqinë, nuk pati më kontakt me Shqipërinë.

Madje edhe pas vdekjes së Enver Hoxhës, kur komunizmi u fshi nga faqja e dheut në Evropën Lindore në vitin 1989, Shqipëria mbeti një vend kokëfortësisht i ndarë, ende komunist, një vend, i cili kishte bredhur kot më kot larg botës së qytetëruar dhe donte prapë të qëndronte atje. Trashëgimtari i Enver Hoxhës, Ramiz Alia iu përmbajt traditës dragoniane të paraardhësit të tij.

Vetëm në vitin 1990 vala revolucionare filloi të shpërthente në *Vendin e Shqiponjave*, siç e thërrasin shqiptarët vendin e tyre. Në korrik një turmë prej 5.700 vetësh shpërtheu selitë e misioneve të huaja në Tiranë, duke kërkuar që qeveria t'i lejonte të emigronin. Në dhjetor studentët mbushën rrugët, duke kërkuar të bëheshin reforma, protestat shpërthyen, dhe ekonomia u shpleks e tëra. Alternativa e parë politike u formua dhe disa të burgosur politikë u liruan. Qeveria e Ramiz Alisë u detyrua që të inskenonte zgjedhje shumëpartiake; në mars 1991 u zgjodh një parlament pluralist.

Ankthit të shkaktuar prej Enver Hoxhës po i vinte fundi. Por shpejt zbulova se do të duheshin vite, ndoshta breza të tërë, që shqiptarët të arrinin botën moderne. Edhe pse kisha një orë që po e ngisja makinën nëpër ca fshatra, nuk arrita të shoh veturë tjetër. Aty-këtu ndonjë makinë transporti e prodhimit kinez, me kabinë në trajtë koke deleje shfaqej në një shtjellë pluhuri përpara. Lopë, derra, pata dhe pula – që lëviznin nëpër rrugë pa mbajtur aspak anën – të bënin të ndaloje shpejtësinë. Kështu bënin karrocat e dorës dhe ato të qeve, të cilat të zinin rrugën bashkë me fshatarët që ecnin në këmbë ose mbi gomarë.

Pashë tre fëmijë shkolle, jo më të mëdhenj se dhjetë vjeç, duke qëndruar anës rrugës dhe ndalova që t'i merrja në veturën time. Ata kishin veshur një lloj uniforme shkolle, fustane të zeza dhe shami të kuqe rreth qafës. I paaftë që të flisja gjuhën e tyre i ofrova secilit prej tyre nga një banane. Ata qeshën nën hundë me nervozizëm dhe nuk pranuan t'i merrnin. Dyshova nëse ata e kishin parë ndonjëherë më parë atë lloj fruti. Po ashtu pata përshtypjen se ata nuk kishin hyrë kurrë brenda një makine

pasagjerësh. Nuk dinin sesi të uleshin, si të hapnin derën. Një prej vajzave më shikonte e hutuar me gojë hapur.

Sapo ndalova dhe ua hapa derën e makinës për t'i lënë të dilnin, ata vrapuan me shpejtësi teposhtë malit sikur të kishin zbritur nga një anije kozmike.

Qytezat nëpërmjet të cilave kalova, kishin një pamje të çrregullt që manifestonte pikëllim; dyqanet ishin të lëna pas dore dhe, thuajse, të zbrazura. Në një dyqan, krejt ajo çfarë gjeta ishin dy thasë me patate, katër lakra të mykura dhe ca konserva peshku.

Përvoja që kisha më bënte të kuptoja sesa shumë propaganda e përparimit socialist të Enver Hoxhës përbënte një akt teatror ballkanik. Ndonëse diktatori kishte vdekur prej më shumë se pesë vitesh, shpirti i tij jetonte. Në fillim të vitit 1991 statuja e Enver Hoxhës ende dominonte çdo qytet dhe qytezë, pamja e tij ishte bërë e tillë që të dukej i pashëm, i zgjuar, i kujdesur dhe prindëror…

Hyra në Tiranë pikërisht kur kryeqyteti po zgjohej nga gjumi i tij i gjatë. Midis madhështisë së tretur të sheshit dhe të rrugës kryesore njerëzit flisnin me shpresa për shumë pak gjëra përveç politikës… Sharrëxhinjtë, punëtorët e fabrikave, studentët dhe klerikët qëndronin në mes të rrugës duke biseduar sesi t'ia bënin për gjithë kohën që kishin humbur.

Qindra prej tyre mblidheshin përditë para zyrave të Partisë Demokratike. Kjo vilë e akullt që qeveria komuniste i kishte dhënë kësaj partie të re nuk kishte ngrohje, ishte e mbushur me diskutimet më të zjarrta që njeriu mund të ketë parë rreth lirisë së fjalës, një koncept i huaj midis njerëzve, të cilët për dhjetëvjeçarë të tërë nuk mund t'u besonin fqinjëve ose miqve mendimet e tyre vetjake. Punonjësit vinin që të kërkonin ndihmë në organizimin e grevave edhe ky një nocion i huaj në Shqipërinë e kohës së Enver Hoxhës.

Një ditë po dridhesha nga të ftohtët në zyrë kur një aktivist i ri i quajtur Arsen Kaustic hyri brenda, më rrëmbeu për krahu dhe nuk donte të më lëshonte deri sa më kërciti kockën nga zemërimi duke u ankuar për rrugaçët komunistë, të cilët ishin ende në punë nëpër fshatra. Ata kishin ishin munduar që t'i pengonin përpjekjet e tij për të organizuar Partinë Demokratike në qytetin e vogël të Laçit. E kishin kërcënuar për vdekje çdonjërin prej reformatorëve që rendnin për të zënë zyra shteti. Nuk njihnin njerzillëk.

Një grua e vjetër me sy të perënduar erdhi të më tregonte sesi Enver Hoxha e kishte imponuar ateizmin. "Ai ma mori burrin më shumë se 30

vjet më parë për shkak se po lexonte Biblën. Burri më vdiq në burg", - tha ajo me ngashërim, - "shumica e priftërinjëve qenë vrarë ose kishin vdekur në burg. Ne e mbajtëm fenë tonë të mbyllur në zemrat tona – por kjo nuk mund të bisedohej me askënd".

Iku. Një grup burrash hyri brenda furishëm dhe një figurë e dobët me një kapele ngjyrë kafe nisi të bërtiste. Ai u prezantua: "Unë jam Gjelosh Gega. Jam i burgosur politik! U lirova! Desha të vij dhe të falënderoj Partinë Demokratike".

Buzëqeshi prej gëzimit të dlirtë duke zbuluar dhëmbin e vetëm që i kishte mbetur. Dhëmbët e tjerë kishin rënë nga rrahjet e rojeve kufitare më tha Gega kur ai dhe një shoku i tij u përpoqën që të shpëtonin nga Shqipëria gjashtë vjetë të shkuara. Gega, atë kohë 20 vjeç, kishte marrë një dënim prej 18 vjetësh. Ai ishte fatlum që shpëtoi, por rojet ia kishin vrarë shokun.

Ky brez i ri, siç mësova, donte të fshinte çdo gjë që lidhej me Enver Hoxhën. "Veç hidhi një sy fqinjëve tanë. Ata të gjithë janë më mirë", - më thotë Azem Hajdari një student i filozofisë nga Tropoja, që më vonë do të bëhëj deputet i parlamentit. Pak javë pas takimit që pata me të, Azemi udhëhoqi studentët që e përmbysën statujën e Hoxhës në sheshin qendror të Tiranës, jo aq larg prej muzeut grotesk të mbushur me vogëlsirat e jetës së diktatorit.

"Unë dua që ta kthejmë këtë muzeum të Enver Hoxhës në disko gjigande", - më thotë Gramoz Pashko, pedagog i Fakultetit të Ekonomisë dhe bashkëthemelues i Partisë Demokratike.

Sapo shqiptarët u ndjenë të lirë për të folur, transformimi prej komunizmit lëvizi menjëherë. Që nga shkurti i vitit 1991 grevat kishin shpërthyer, ndërsa veprat e Enverit, të cilave më parë u referoheshin si biblës, digjeshin kudo që gjendeshin

"Enver", - bërtiste turma, - "ti je hajdut! Ku janë paratë tona?"

"Fjala se nëna ime kishte qenë shqiptare, u përhap me shpejtësi. Njerëzit vinin tek unë duke më kërkuar që të recitoja fraza dhe ninulla nga fëmijëria ime. Kurdo që e bëja këtë, reagimi ishte i njëjtë – qeshje me të madhe deri në ulurima që pasoheshin pastaj nga një ortek fjalësh që unë

nuk mund t'i kuptoja. Më duhej të jepja prova të mjaftueshme dhe të garantoja plotësisht për këtë njerëzit të cilët kishin kaluar dekada të tëra duke e përsosur mosbesimin. Ata do të më buzëqeshnin sikur donin të thoshnin, po, ai është i huaj, por është një prej nesh. Një prej nesh. Ai ka jetuar jashtë burgut dhe, ndoshta, edhe ne tani do të jetojmë jashtë tij.

"Ma thuaj ndershmërisht", - më tha një burrë në fillim të tridhjetave, - "çfarë mendon bota jashtë për ne? A jemi ne vërtetë kaq të prapambetur? A janë gjërat vërtetë kaq të tmerrshme këtu po të krahasohen me jashtë? Të lutem ma thuaj hapur". Ai u mbështoll në pallton që kishte veshur për t'i shpëtuar të ftohtit duke pritur përgjigjen.

Ishte e vështirë t'i thoja atij, "po, vendi yt është shumë i prapambetur dhe shumë i varfër".

"Dhe a mund të bëhemi ne pjesë e Evropës; a është dallimi kaq i madh?" Kjo pyetje erdhi prej një gruaje. Sigurisht, i thashë asaj, me kohë do të arrihet edhe kjo. Unë e vlerësova atë të ishte në të dyzetat, por nuk mund të isha i sigurtë pasi fytyra e saj e bukur kishte shenjat e vijave të krijuara prej shqetësimit. Ato dukeshin të ishin vragë të thella.

Midis miqve të rinj që kisha zënë, ishte edhe Bushi, kamarieri që mbante gjithmonë një kravatë ngjyra-ngjyra si ylber dhe ishte gjithmonë i gatshëm për të bërë shaka. "Mua ma kanë vënë emrin si të Presidentit Bush", më thoshte. Aty ishte operatorja e telefonave, Rajmonda, e veshur në mënyrë elegante, sepse burri i saj Sofokliu kishte transportuar disa herë mallra me makinë në Jugosllavi dhe kthehej prej andej plot me gjëra të vlefshme. Pastaj e shkathëta



Dushko Doder: Nusja dhe dhëndri, 1992

Flutur, që planifikonte të bënte një dasmë në vjeshtë.

"Ju dhe bashkëshortja juaj jeni të ftuar", - më tha ajo.

Këta shokë të rinj më ndihmuan që ta kuptoja më mirë Shqipërinë. Bashkimi, një aktivist i Partisë Demokratike më ftoi të shkoja te greva e parë e minierës së qymyrit në Valias, jashtë Tiranës. Kur arrita me Mercedesin tim, minatorët m'u kthyen me gëzim, brohoritje e fishkëllima. Ata iu drejtuan makinës duke bërë me gishta shenjën e tyre 'V' për fitore.

"Çfarë dreqin u the", - e pyeta Bashkimin më vonë.

"U thashë: Unë e ëndërroj atë ditë kur ky oborr të jetë i mbushur me makina si kjo, të gjitha të ngara prej jush, minatorëve!"

Eksod, 1991

Por aktivistët tjerë kishin një koncept më realist për ekonominë e trazuar shqiptare. "Nuk do të jetë e lehtë të ndryshojmë një sistem që ka qenë tërësisht i kolektivizuar", - më thonë ata.

Nuk ka qoftë edhe një kafe private që të ndriçojë në rrugët gri të Tiranës, ndërkohë që dimri i vitit 1991 po zvarritej drejt pranverës. Në të vërtetë, duke parë vjedhurazi nëpër dyert dhe dritaret e punishteve të kryeqytetit, shpesh pashë gra të kërrusura mbi punën e tyre njësoj si figurinat e Dikensit, duke punuar mbi makina qepëse në errësirë, duke pedaluar me vrull për t'i vënë gjilpërat në lëvizje.

Ndoqa zgjedhjet e para shumëpartiake në Shqipëri, kur vendi po hynte në një fazë të re pa u ndarë si duhet deri në fund me sistemin e vjetër.

E megjithëse komunistët fituan 65 për qind të votave në pranverën e vitit 1991, zgjedhjet paralajmëruan rënien e komunizmit në Shqipëri. Opozita thuajse pushtoi çdo qytezë e qytet. Vetëm nëpër fshatra fituan komunistët. Ramiz Alia ishte ende president, por ai dukej se e dinte që ishte figurë tranzitore dhe mund të bënte pak më shumë sesa të siguronte një ndjenjë stabiliteti duke e kaluar regjimin prej së shkuarës tek e ardhmja.

Në pjesën më të madhe të jetës së saj, nëna ime nuk ndihej e qetë për namin e Shqipërisë si një shtet me një politikë të çuditshme dhe të kobshme dhe rrallë e përmendte vendin e saj. Por kur i mbushi të shtatëdhjetat, ndodhi një ndryshim. Atëherë ajo filloi të fliste rreth dëshirës së saj të zjarrtë për të vizituar Shkodrën, qytetin e prindërve. Në imagjinatën e saj, Shkodra u bë më tërheqëse dhe më ekzotike sesa çdo vend tjetër që ajo kishte vizituar gjatë jetës së saj, si Muri i Madh Kinez, Vatikani, Kanioni i Madh. Shkodra ishte kategori më vete, për të cilën duhej folur me krenari të madhe, një vend me lulëzim të veçantë.

Ajo nuk arriti ta bënte atë udhëtim.

Në kohën kur unë arrita aty, në fillim të prillit, qyteti ishte një shkatërrinë e vërtetë. Protestuesit bllokonin rrugët duke arsyetuar se komunistët i kishin fituar zgjedhjet nëpër fshatrat ku jetonin dy të tretat e popullsisë, për shkak të frikës që u kishin imponuar atyre.

Policët hapën zjarr duke vrarë katër aktivistë të Partisë Demokratike dhe duke plagosur shumë të tjerë. Turma u zemërua dhe shkoi e i vuri flakën ndërtesës së Komitetit të Partisë. Tym i zi i doli ndërtesës, ndërkohë që unë po e ngisja makinën nëpër qytet, duke lënë pas një makinë të blinduar të kthyer përmbys dhe të rënë në kanal.

Më pëlqeu shpirti mospërfillës i Shkodrës ndaj pushtetit, ndoshta trashëgimi e krenarisë që e bëri këtë qytet kryeqendrën e Ilirisë, mbreti i fundit i së cilës ishte Genti, i mundur dhe i marrë në burg prej romakëve në vitin 168 p.e.r. Historia e qytetit është historia e zigzageve të vetë Shqipërisë. Pas Romës, Bizanti pati ndikimin e vet, i pasuar prej valës së pushtimeve të gotëve, serbëve, bullgarëve, normandëve, venecianëve, turqve osmanë, italianëve dhe gjermanëve.

Një nga trashëgimitë e sundimit otoman është, Shqipëria vendi me shumicë myslimane në Evropë. Në vitin 1967, kur Enver Hoxha e deklaroi Shqipërinë një shtet ateist, afërsisht 70% e popullsisë ishin myslimanë, 20% shqiptarë ortodoksë dhe 10% katolikë. Përpjekjet e egra për të çrrënjosur të gjitha fetë shërbyen për të përforcuar tolerancën që kishte ekzistuar për shekuj të tërë.

Unë i gjeta njerëzit në Shkodër të dashur dhe mikpritës. Bëra një bisedë me Marash dhe Domenika Selmanin dhe i pyeta për gjyshin tim të quajtur Gjurgju.

"Nuk e kemi dëgjuar kurrë atë emër," - më tha Marashi duke më dhënë të njëjtën përgjigje dëshpëruese që më kishin dhënë gjithkund nëpër qytet.

"Mirë, po për Kosmaçin?" - e pyeta duke përmendur mbiemrin e hallës së nënës.

"Sigurisht," mu përgjigj Marashi me buzëqeshje. "Mësuesi Pjerin Kosmaçi, në shkollën tonë. Do t'ju çoj unë tek ai."

Duke ndjekur një rrugicë, erdhëm te një shtëpi e re e vockël në rrugën Skënderbej. Nuk gjeta asgjë të ngjashme me njerëzit e mi në fytyrën e Pjerin Kosmaçit, mësuesi që jetonte aty me të shoqen, me djalin e vogël dhe me nënën e vet. Mikpritësi ynë ishte i shqetësuar. Na sollën kafe, folëm për gjëra të rëndomta dhe, gradualisht, gjendja erdhi deri te tretja në zhgënjim.

"Unë vërtetë nuk jam kushëriri juaj", - më tha Pjerini më në fund. "Unë besoj se kushëriri juaj mund të jetë Jak Kosmaçi, i cili jeton afër Durrësit".

A mund të ma jepni numrin e telefonit të Jakut?

Fjala *telefon* gjeneroi një të qeshur shpërthyese e të vrullshme. Mikpritësi im, nëna e tij 71-vjeçare dhe miqtë e mi, Marashi dhe Domenika, u përgjigjën si aktorë në një skenë komike televizive duke përsëritur fjalët, duke qeshur dhe duke rrotulluar sytë. Telefoni – prej të cilëve tërë vendi kishte vetëm 6.000 – ishte simbol i privilegjeve të larta. Asnjëri prej këtyre këtu nuk e kishte pasur atë privilegj. Por Pjerini ma hoqi zhgënjimin duke më shkruar adresën e Jak Kosmaçit në një copë letër dhe duke ma zgjatur."

"Unë do të shkoja atje sa më parë të qe e mundur, por, së pari, isha i etur të takoja fqinjin e Pjerinit dhe kushëririn e tij, një prift katolik i quajtur Simon Jubani.

Ai ishte 65 vjeç dhe shumë i dobët nga që kishte kaluar 26 vjet në burgjet më të vështira të Shqipërisë. Por At Jubani ishte ende i aftë, po të kemi parasysh egërsinë me të cilën ishte trajtuar e që e bëri atë një hero kombëtar. Jo shumë pas lirimit të tij nga burgu, në vitin 1990, ai e kundërshtoi hapur qeverinë për fenë, duke udhëhequr dhjetëra njerëz të qytetit të tij tek një kishë aty pari. I mbrojtur nga të rinjtë shkodranë me thika në brez, At Jubani qëndroi i veshur në rroba të zeza përmbi gurët e varrit të lënë pas dore prej shumë kohësh dhe filloi të drejtonte meshën e parë publike në Shkodër që prej më shumë se dy dekadash. Me të mbaruar meshën, mijëra njerëz, katolikë, aq edhe myslimanë, që e kishin mbushur varrezën, shpërthyen nëpër rrugët e qytetit. Autoritetet u tërhoqën dhe kisha e At Jubanit u rihap.

Një shok shqiptar më ndihmoi të shkoja nëpër male me makinë dhe më shërbeu si përkthyes, duke më treguar shpesh rrënojat e shtëpive të atyre që thyenin besën. Themelet e tyre të gurta ishin shpërndarë aty këtu, siç e kërkonte ligji i pashkruar. Shqiptarët nuk e dënojnë më njëri-tjetrin në atë mënyrë, por kjo, gradualisht, u shfaq tek unë në formën e asaj që njerëzit ngurronin që të premtonin ndonjë gjë, paçka se mund të ishte shumë e vogël, siç mund të jetë, për shembull, të ndërronin një llampë në dhomën e hotelit, ndoshta, sepse kishin frikë që po të jepnin fjalën, ajo nuk do të mbahej për rrethanat në të cilat jetonin.

Duke e ngarë makinën që nga malet e thepisura drejt Adriatikut, Çimi dhe unë më në fund erdhëm në Shijak, qyteza ku shpresoja të gjeja Jak Kosmaçin. Ai do të mund të ishte e vetmja lidhje e gjallë e imja në Shqipëri.

Me një shishe konjaku francez dhe me ca çaj të mirë në dorë, të blerë në Tiranë në një dyqan ku tregtohej vetëm me devizë, kalova nëpërmjet sheshit të qytezës për të filluar kërkimin. Njëri prej njerëzve që takova aty, e njihte atë njeri. “Ah, Kosmaçi, ai muratori”, - tha ai njeri i gjendshëm dhe bëri me dorë për te ndërtesa e tij.

Unë i ngjita shkallët prej çimentoje ku në çdo hap ndieja një peshë të re që më shtynte drejt vendit ku banonte Jak Kosmaçi. E vëzhgova atë me kujdes për të gjetur ndonjë shenjë të përbashkët familjare. M’u duk sikur i kisha parë në familjen time ato vetulla, atë hundë me flegra të mëdha. Ai shfaqte një dinjitet të tillë që u ngjante fotografive të vjetra të varura në muret e banesës së tij.

Vështrova me kujdes një fotografi me portretet e 15 vetëve. Në qendër ishte një oficer ushtrie me gajtan të hedhur rreth uniformës dhe me

dekorata, i moshuar, i veshur me pantollona të stilit bollka allaturka dhe me jelek me një zinxhir floriri; dy dhëndurë të rinj i qëndronin afër me xhaketa ceremoniale. Gratë ishin veshur me rroba të tilla që mund të kishin qenë moda e fundit pariziane.

Ndërsa Çimi u shpjegoi për praninë time, sytë e Jakut u shkëputën prej Çimit dhe u kthyen nga unë, pastaj tek ai përsëri dhe, më në fund, u fiksuan tek unë. Njiheshim. Ai tundi kokën dhe m'i shtrëngoi duart përsëri. Këtë herë më shumë. U shoqëruam menjëherë. Gjyshja e Jakut nga babai ishte një Gjurgju, motër e gjyshes sime nga mamaja. Jaku ishte kushëriri im.

Biseduam tërë mëngjesin. Rrëfimi i Jakut më dha një përmasë krejt tjetër të tmerreve të kohës së Enver Hoxhës. Unë isha kthyer tani tek e kaluara e njërit prej burgjeve më famëkeq, te një vend i quajtur Burrel, që tani ishte transformuar e kthyer në një vend të zakonshëm sikundër edhe burgu tjetër i Spaçit. Pjesëtarë të familjes sime kishin kaluar kohë të tëra në ato dy burgje.

Jaku e kujtonte ditën kur ia kishin marrë babanë, Anton Kosmaçin. Ishte viti 1944 dhe bota ishte ende në luftë, por gjermanët e kishin braktisur Shqipërinë. Tirana ku jetonin Kosmaçët ishte tashmë në duart e Enver Hoxhës dhe të komunistëve. Jaku ishte atëbotë vetëm 15 vjeç.

Ushtarët trokitën në derë dhe pyetën për Antonin. Ai e përqafoi të shoqen, nënën e Jakut. E përqafoi edhe Jakun. Nuk pati kohë për lot.

"E shkreta nënë," - u kujtua Jaku. "Ajo e dinte, ndaj më tha që t'i shkoja pas babait, por gjithsesi të ruaja largësinë". Rruga që të çonte te policia ishte vetëm një minutë larg dhe çdo detaj i asaj nate mbeti i ngulitur thellë në kujtesën e Jakut…zhurmat e hapave të partizanëve që shkelnin në rrugën e shtruar me zhavorr, babanë i tij duke ecur, i gjatë, i bërë gërmuç nën një pardesy me një jakë të hollë lëkure, shëtitorja e mbushur me gjethe gështenjash të egra dhe shelgjesh, Lana që rridhte e ftohtë mes përmes qytetit, babai që, më në fund, i bëri një shenjë me dorë përpara se të zhdukej brenda kompleksit të rrethuar me mure…

Antoni qe dënuar me 30 vjet burgim si *armik i popullit*, nga dhjetë vjet për çdo muaj që kishte shërbyer si ministër i drejtësisë në një prej qeverive që kishin pasuar njëra-tjetrën gjatë pushtimit italian. I dërrmuar prej viteve të burgut, ai qe liruar në mars të vitit 1964 pas një amnistie të përgjithshme. Të gjithë fqinjët e njihnin atë si *armik i popullit* dhe e trajtonin si njeri me lebrozë. Vdiq vetëm disa muaj më vonë.

"Si është e mundur që nëna juaj nuk di asgjë për të? A nuk u gjet dikush që t'i tregonte asaj diçka për të?", - Jaku po më pyeste mua. Pastaj na i mbushi gotat me raki duke më parë ngultas me një vështrim që dukej sikur thoshte se, po t'i kishim ditur ne vuajtjet e babait të tij, kjo do t'ua kishte lehtësuar dhembjet në hullinë e atyre viteve të tmerrshme. Çfarë t'i thoja atij burri aq të dashur më flokë të bardhë? Unë kurrë nuk kisha ditur qoftë edhe për ekzistencën e tij, deri sa fati e solli që ta kërkoja në Shkodër.

Ai e kuptoi, më dhuroi një buzëqeshje dhe vazhdoi. - "Nuk mjaftonte që Enveri ma futi babanë në burg. E tërë familja duhej të zhytej në mizerje". Nëna e Jakut ishte dërguar në një kamp pune në Tepelenë, gjyshja në një burg – spital, jashtë Tiranës. Arsimimi i Jakut ishte ndërprerë. Regjimi e bëri atë murator. Stacioni i fundit i internimit të familjes së tij ishte Shijaku, aty ku i gjeta unë.

Djemtë e Jakut – Aleksandri dhe Blendi – vuajtën, gjithashtu, si nipat e gjyshit armik i popullit. Arsimimi përtej klasës së tetë u ishte mohuar. Të dy u bënë mekanikë.

"Ju mërzita, por kështu ishte shkruar," - shtoi Jaku. - "Ne jetuam që të gjithë në një burg të madh." Ai pushoi për një minutë ose më shumë. Shmoi një herë dhe u përpoq ta mblidhte veten.

"Jak, Jak,", ia pat e shoqja, Ana, e cila po rrinte dhe dëgjonte në heshtje. Jaku ia nisi përsëri tregimit, por zëri i tij e kishte ndryshuar timbrin nga kujtimi plot zemërim i asaj që kishte përjetuar.

Më datën 1 qershor festohej Dita e Fëmijëve. Në Qershorin e vitit 1990, dy vajzat e Aleksandrit, njëra tetë vjeç dhe tjetra nëntë do të merrnin pjesë në një shfaqje që jepej për prindërit.

Jaku kujton: "Ato bënë prova me zell të madh. Një ditë përpara shfaqjes, një anëtar i komitetit të partisë së Shijakut shkoi në shkollë dhe i tha drejtorit të shkollës që vajzat e Aleksandrit duhej të hiqeshin nga grupi i fëmijëve që do të bënin shfaqjen".

Armiqtë e popullit! Jaku bëri një pauzë të gjatë. "Të dënosh pesë breza! Pesë breza, ej! Cili është ai krim që meriton një dënim të tillë? Nuk ka pasur qoftë edhe një akuzë të qartë dhe të qëndrueshme që ta ngarkonte babanë tim, qoftë edhe një!"

"Po më duhet t'jua tregoj tërë tragjedinë tonë të vërtetë", - më tha ai, kësaj radhe duke pëshpëritur, sikur më kishte hapur derën që të futesha drejtpërdrejt në të fshehtat e jetës së tij. - "Ditën kur mbesat e mia u dënuan kësisoj, dy djemtë m'u betuan se do të iknin nga ky vend një orë e më parë.

Të shpëtonin me çdo kusht. Edhe sa duhej që të vuanim? As nipat e mbesat e mia nuk janë falur?"

Të dy edhe Aleksandri i moshës 35-vjeçare, edhe Blendi 21 vjeç e mbajtën fjalën. Ata ikën nga Shqipëria në mars të vitit 1991. "Nuk shqetësohem për Blendin", - shtoi ai. - "Jo. Ai është i ri, është në Itali. Shqipëria ka marrëdhënie të mira me Italinë. Ne mund të flasim me të në telefon nga postë-telegrafa".

"Por Aleksandri…" Ai e hodhi vështrimin larg. "Nuk më zë gjumi i natës për të. Gruan dhe dy fëmijët i ka këtu. Ai është në burgjet jugosllave, ku i mbajnë refugjatët. Do që të shkojë në Amerikë, në Kanada ose në Australi. Por në këto ditë, eh, askush nuk i pranon shqiptarët!".

Ua dhashë Jakut dhe Anës dhuratën dhe u premtova se do të përpiqesha ta ndihmoja Aleksandrin. *Besa ime.* Sytë e tyre u qullën në lotët dhe unë e kuptova se u kisha thënë atyre, pikërisht, atë fjalë magjike që ata fshehtasi shpresonin tua thoshja.

Ia hodha Jakut krahun rreth qafës, rrugës duke dalë jashtë, nën shndëritjen e diellit, si dy kushërinj, të shoqëruar nga Ana, gruaja e Aleksandrit, Rita dhe vajzat e saj.

"Më premto se do të kthehesh," - më tha Jaku. Dhe unë i premtova.

Anembanë Shqipërisë jourbane gjeta njerëz, të cilët kishin hequr dorë me kohë nga shumë gjëra të tyre në jetë, por, herë pas here, gjenin kënaqësi të panjohura nën regjimin e Enver Hoxhës. "Ne po përpiqemi të kënaqim veten dhe të mos mendojmë për nesër," - më thotë Namzo Guzi, një bujk i ri që e takova në fshatin Borçë afër detit Adriatik. Disa prej shokëve të Namzos po martoheshin dhe e gjithë bashkësia kishte dalë për një mbrëmje dëfrimi.

"Sonte, ne shpresojmë," - tha Namzo, 35-vjeçar. - "Kjo është dasma e parë në të cilën kam marrë pjesë. Dhe kjo është gota e parë që unë kam ngritur ndonjëherë për dikë tjetër dhe jo për Enver Hoxhën dhe partinë." Namzo dhe motra e tij iu bashkuan të tjerëve, të cilët po e kërcenin furishëm napolonin, një valle dasme e emëruar sipas emrit të monedhave të floririt që miqtë dikur i hidhnin çiftit në periudhën parakomuniste. Që atëherë, florori ishte zhdukur prej këtu.

Dollibashi propozoi përsëri një tjetër dolli, e cila rezultoi në zhurmë. "Ishte një dolli për njerëzit tanë jashtë,"- më shpjegoi Namzo. - "Thuajse secili këtu kishte dikë në Itali. Vëllai i dhëndrrit iku në mars, i shoqi i motrës sime në prill."

Të jetosh në Shqipëri do të thotë të hasesh me vështirësi në rritje. Siç shihet, muaji i fundit i vitit 1991 tregon sesa të dëshpëruar janë njerëzit. Trashëgimia e Enver Hoxhës është shkërmoqur po kështu është bërë edhe me disiplinën. Askush nuk punon. Në të vërtetë unë takova shumë mekanikë nga ish kombinati 'Enver Hoxha' në Tiranë, të cilët nuk kishin shkuar që të punonin në Mars. E, megjithatë, ata kishin marrë 80% të pagës. E njëjta gjë ishte bërë edhe me punonjësit e së vetmes fabrikë të qelqit, e cila e kishte ndërprerë prodhimin që në vitin 1990 se nuk mund të siguronte më lëndë të para. Një gjë të çonte te tjetra. Për shkak të mungesës së xhamave të dritareve për t'u mbrojtur nga të ftohtët, shkollat, fabrikat dhe zyrat detyroheshin të mbylleshin. Kur është fjala për shkollat, ato shpesh nuk kishin ngrohje, pasi nuk kishte prodhim të mjaftueshëm qymyri.

Trazirat për shkak të ushqimit shpërthenin nëpër bashkësi të ndryshme. Në Fushë Arrëz, një qytet sharrash në male, protestuesit e uritur shpërthyen magazinat vendore të ushqimit, pas thashethemeve të përhapura për mungesë të menjëhershme të bukës. Njëzetë policë nuk ishin aq shumë për një turmë 2.000 vetëshe, e cila i vuri ndërtesës zjarrin. Më shumë se 30 vetë u dogjën në atë ngjarje.

Miqtë e mi shqiptarë u pajtuan se kriza e ushqimit ishte edhe më e keqe pas humbjes së pushtetit nga komunistët. "Përpara, shpërndarjen e ushqimeve e ruante frika," - më thoshte një burrë, i cili kishte qenë zyrtar i lartë i qeverisë. Tani njerëzit nëpër fshatra po e rrethonin me dërrasa ushqimin, që do të thotë se banorët e qytetit në Tiranë duhej të zinin radhën në mes të natës për pak furnizim me qumësht, i cili do të shitej në mëngjes.

"Edhe kur e zë radhën herët, njeriu nuk është i sigurt se do të arrijë të marrë qumësht", - më tha një grua e vjetër. Asaj i nevojitej qumësht për nipat. Udhëtarët këshilloheshin që të merrnin ushqime me vete anë e mbanë vendit. Një diplomat grek që po udhëtonte me makinë nga Athina për në Tiranë ishte ndaluar, i kishin vjedhur çdo gjë dhe, më pas, e kishin lejuar që të ikte në këmishë dhe në të linjtat.

Këto trauma intensifikonin luftën politike në Tiranë. Shqipëria hyri në vitin 1992 duke qenë jashtë kontrollit. Forcat demokratike kërkonin zgjedhje të parakohshme në pranverë. Ato u bënë dhe demokratët fituan 62% të votave duke i dhënë asaj kontrollin mbi parlamentin 140 vendesh.

Ramiz Alia, mbajtësi i fundit komunist i postit të Presidentit, dha dorëheqje në Prill. Ai u zëvendësua nga Sali Berisha, themeluesi i Partisë Demokratike dhe një udhëheqës karizmatik.

Shumica e shqiptarëve e dinë se çfarë kërkojnë. Ata duan një shoqëri të qytetëruar, ekonomi tregu, sundim parlamentar dhe respekt për të drejtat e njeriut. Vendi po i futet një tranzicioni të dhembshëm i cili do të zgjatë vite të tëra. Sfidat janë të qarta – Shqipërisë i duhet të tejkalojë një psikologji disfatiste e cila zë fill që në vitet e shtypjes, të zhdukë shprehitë e këqia të burokracisë së vendosur nëpër fshatra, të bindë të rinjtë (60% e popullsisë është nën moshën 25-vjeçare) që të qëndrojnë, të ruajë tolerancën fetare dhe, mbi të gjitha, të ngjallë një ekonomi që është duke vdekur.

Ka disa shenja shprese. Investitorët e huaj po fillojnë ta vizitojnë vendin, duke parë mundësi në plazhet piktoreske të Shqipërisë, në malet e mbuluara me borë, si dhe në rezervat e vajgurit, kromit dhe bakrit.

Ka plane për të zhvilluar plazhet e mrekullueshme të detit Jon. Por rrugët bregdetare janë të pamjaftueshme dhe frikshëm të pariparuara. Enver Hoxha nuk donte që kjo pjesë e vendit të ishte e populluar nga frika se mos u shkrepej në kokë që të notonin drejt Korfuzit, i cili duket me sy prej këtej. Pasi kalova përgjatë njërit prej atyre plazheve, nuk pashë tokë tjetër që të dukej prej aty përveç bunkerëve të çimentos dhe gjadheve me tela me gjëmba. Gjurmët e regjimit të Enver Hoxhës janë të pranishme kudo. Zhvillimi i turizmit aty kërkon investime të mëdha, por, gjithsesi, po të kishte vullnet do të ishte bërë tashmë.

Duke u kthyer nga Saranda për në kryeqytet, kalova nëpërmjet një zone me një pamje madhështore të mbuluar me ullinj, limona e pemë. Në Vuno, fshat i vogël malor afër bregdetit, ndalova që të bisedoja me një çift që ishin ulur në një tarracë.

A mund ta parashikonin ata këtë vend si shesh lojërash për turistët e pasur?

"Asgjë nuk është e mundur këtu", - më tha gruaja duke qeshur.

"Po ka ndryshime", - i thashë.

Ajo qeshi përsëri dhe më pa sikur deshi të thoshte: "Ju nuk kuptoni."

I shoqi më hodhi një vështrim pyetës. "Çfarë ka ndryshuar?" - më pyeti. "Dy djemtë tanë janë në Itali. Le t'i lemë ata që të kërkojnë fatin e tyre dhe të kthehen si duhet. Kjo është udha jonë." - Ata e ndjenin, me fjalë të tjera, ishte ende e pamundur për shqiptarët që t'ia dilnin mbanë në Shqipëri. Për ata fati i mirë ishte një produkt importi, siç ishte edhe për kushëririn tim Jak Kosmaçi."

Dushko Doder e mbyll shkrimin e tij me premtimin e mbajtur ndaj kushëririt Jak Kosmaçi, pra për *Besën* që ia kishte mëkuar e ëma bashkë me qumështin, që e kemi trajtuar si ilustrim në kapitullin për Besën Shqiptare të këtij libri.

Periudhën komuniste dhe paskomuniste me rrjedhojat e saj na e përshkruan edhe Priit Vesilind në vitin 2000. Duket se gjurmët e bëmave dhe hija e rëndë që ka lënë pas regjimi komunist në Shqipëri, do të nxisin udhëtarët edhe për shumë kohë t'u referohen këtyre dukurive në Shqipëri:

> "Në vend të rrugëve, Enver Hoxha ndërtoi bunkerë të panumërt betoni, të cilët edhe sot përbëjnë pjesë të peizazhit shqiptar, të ngjashme me fosile kërpudhash. Ai e la popullsinë e vendit të vet larg botës, të izoluar dhe të humbur. Duke i mbajtur në një izolim të tillë të thellë, ai ia doli t'i bindte njerëzit e vendit të tij se ata ishin kthyer në qendër të botës dhe se gëzonin mirëqenien më të lartë në Evropë.
>
> Mizoritë e tij prekën, thuajse, zemrën dhe mendjen e çdo shqiptari. "Babai im që prej njëzet vjetësh kishte një makinë,"- thotë Genc Tirana, shkrimtar 43 vjeç. - "Ai e ruante atë në garazh, pasi nuk lejohej të kishe makinë private. Ajo ishte veturë e modelit *Skoda*. E ndizte atë një herë në javë për ta mbajtur në gjendje pune. Dhe, kur ra regjimi, ai e kishte ende makinën. Por vdiq përpara se të arrinte që ta ngiste atë."
>
> "Kur vdiq Enver Hoxha, të gjithë qanë,"- thotë Ada Kongoli, avokate e re nga Tirana. - "Oh, po na duhej të qanim! Nëse dikush na shihte duke mos qarë, mund të përfundonim në arrest. Në rast se dikush e harron të kaluarën, atëherë ja tek është Muzeu Historik Kombëtar që shërben për të sjellë ndërmend atë. Ai jep një shifër tronditëse të të dënuarve politikë gjatë regjimit të Enver Hoxhës: 17.900 të burgosur, 5.157 të ekzekutuar dhe 30.383 të arratisur."[145]

[145] National Geographic Magazine, *'Albania Opens the Door'*, shkruar nga Dushko Doder, korrik 1992.

Në maternitet, fotografi e vitit 1991

Me ndihmën amerikane, - dëgjova të thuhet më se një herë, - ne mund të shpresojmë që të shkojmë drejt jetës normale.

Shqiptarët tani, për herë të parë, shohin se ka dritë në fund të tunelit. Ata e shohin se bota i vë re. Dhe të gjithë e ndiejnë tani në zemrat e tyre se diçka është gati për të ndodhur.

XV

DASHURIA PËR NJËRI-TJETRIN E NJË POPULLI TË NDARË

Udhëtarët e revistës më në fund vijnë, në atë përfundim, në të cilin bota perëndimore me shumë vështirësi po vjen sot: në njohjen e popullit dhe të kombit shqiptar si një dhe të pandarë. Priit Vesilind ka vënë në fund të shkrimit të vet një fragment, i cili, në të vërtetë, është shumë profetik. Duke iu referuar luftës në Kosovë, ai e ka quajtur dhembjen e shkaktuar nga kjo luftë një kapitull të ri në jetën e popullit shqiptar. Më poshtë është fragment i fundit i revistës, por edhe *drita e qartë* në fund të tunelit që ai parasheh për shqiptarët:

> Pavarësisht nga pikëllimi dhe rrënimi që pësoi, Kosova, pa dyshim, do të bëhet njësi juridike kosovare shqiptare dhe shqiptarët më të aftë do të gjenden në Prishtinë dhe jo në Tiranë. Por edhe vetë Shqipëria do të përfitojë nga kriza në Kosovë.
>
> Pranverën e kaluar një popullsi e madhe shqiptare u shfaq papritur në kufijtë e Shqipërisë. Shqiptarët, ashtu siç erdhën nga Kosova, të dërrmuar, të lodhur, të sfilitur e të palarë nga udhëtimi i tyre i gjatë, u pritën me krahë hapur nga vëllezërit e tyre të Shqipërisë. Fshatra dhe familje të tëra u strehuan nëpër shtëpitë e tyre pa pasur asnjë lloj njohjeje të mëparshme. Gjaku i shprishur – gjaku ynë i shpërndarë!
>
> Kjo bujari dhe bashkëpunimi i afërt i shqiptarëve me NATO–n do të ndihmojnë në ndërtimin e infrastrukturës kombëtare dhe do

të garantojnë siguri, “Me ndihmën amerikane,” - dëgjova të thuhet më se një herë, - “ne mund të shpresojmë që të shkojmë drejt jetës normale.”

Shqiptarët tani, për herë të parë, shohin se ka dritë në fund të tunelit. Ata e shohin se bota i vë re. Dhe të gjithë ata e ndiejnë tani në zemrat e tyre se diçka është gati për të ndodhur.[146]

KOMBI SHQIPTAR PO RILIND.

[146] National Geographic Magazine, ‘*Albanians A People Undone*’, shkurt 2000, faqe 70.

XVI

HISTORI E SHKURTËR E SHOQËRISË DHE E REVISTËS

Për të ardhur te shkrimet e kësaj reviste për Shqipërinë dhe për shqiptarët, më parë le të njihemi me historinë e saj. Si lindi dhe si erdhi deri në ditët tona? Si u gjetëm ne, shqiptarët, në

faqet e saj në rrjedhë të shekullit XX? Çfarë përfaqëson ajo në të vërtetë?

Në mbrëmjen e 13 Janarit 1888, tridhjetë e tre vetë udhëtuan sa në këmbë, sa me kuaj dhe sa me karroca kuajsh mespërmes rrugëve të Washington për te Klubi Kozmos dhe më pas te sheshi Lafajete përballë Shtëpisë së Bardhë. Ata u mblodhën rreth një tryeze të rëndë druri për të diskutuar se sa i dobishëm do të ishte organizimi i një shoqërie për njohjen dhe për shpërndarjen e njohurive gjeografike. Entiteti që ata themeluan atë natë, u bë institucioni jofitimprurës shkencor dhe edukativ më i madh në botë.

Në përbërje të këtij grupi u përfshinë gjeografë, zbulues, mësues, juristë, hartografë, oficerë ushtrie dhe ekonomistë – të gjithë njerëz me shkollë, të cilët kishin bërë udhëtime të pafundme. Të gjithë i bashkonte dashuria që kishin për dijen dhe etja për zbulime dhe për arritje të mëdha. Ata u bënë zbuluesit e parë të Kanionit të Madh dhe të Gurit të Verdhë; valvitën flamurin amerikan në cepin më verior të globit, matën lartësitë e maleve më të larta, gjurmuan vijën gjarpëruese të brigjeve detare dhe të lumenjve, përcaktuan shpërndarjen e florës dhe të faunës, hulumtuan

doket e zakonet e popujve të lashtë dhe shpjeguan fenomene të natyrës që nga tërmetet deri te vullkanet.

Ata burra sollën në jetë një epokë, që u dallua prej ekspeditave, zbulimeve, shpikjeve dhe ndryshimeve të mëdha. Zgjerimi masiv i industrisë dhe prurja njerëzore e emigracionit po i ndryshonte faqen Amerikës duke sjellë, bashkë me to ide dhe vlera të mëdha. Amerikanët ishin energjikë, ambiciozë, optimistë dhe kureshtarë për informacionin e ri për botën që i rrethonte. Për ata burra të mbledhur në Klubin Kozmos ishte e qartë se duhej një mjet që do ta vinte në lëvizje atë dëshirë të zjarrtë që kishin për dituri.

Ata miratuan njëzëri një dokument të kësaj shoqërie, i cili përcaktonte organizimin e saj "mbi baza të gjera dhe liberale me hapësira të pafundme për kualifikime nga më të ndryshmet dhe për mbrojtjen e dinjitetit të shkencës, të cilën do ta përfaqësonte ajo". U deshën dy javë për të përgatitur planin e organizimit dhe, në datën 27 janar 1888, shoqëria *National Geographic* u regjistrua edhe zyrtarisht.

Foto nga mbledhja themeluese e shoqërisë *National Geographic*

Presidenti i saj i parë u zgjodh Gardiner Grine Hubard, jurist, financier dhe filantrop i njohur. Një ndër anëtarët e parë drejtues të

shoqërisë u bë edhe Aleksandër Graham Bell, shpikësi dhe pronari i kompanisë së parë telefonike amerikane, e njohur deri sot si Bell Atlantik. Meqë Hubard nuk e konsideronte veten *'as njeri të shkencës, as gjeograf'*, ai deklaroi: "Duke më zgjedhur, mua ju i bëni të ditur publikut se anëtarësimi në shoqërinë tonë nuk do të jetë i mbyllur vetëm për gjeografët profesionistë, por do të përfshijë një numër të madh njerëzish, të cilët, sikundër edhe unë vetë, dëshirojnë të nxisin kërkime të veçanta prej të tjerëve dhe të shpërndajnë dijenitë e fituara prej tyre, për të bërë që, ne të gjithë, të dimë më shumë për botën që na rrethon".

Nëntë muaj pasi u themelua shoqëria *National Geographic*, u botua e para revistë që mbante të njëjtin emër. Ajo do të dilte si revistë shkencore, studimore me një faqe të parë ngjyrë kafe, e cila kishte shumë pak gjëra të përbashkëta me atë revistë të ilustruar me ngjyra që shohim sot. Në dy faqet e saj të para, kishte një deklaratë ku shpallej misioni që do ta udhëhiqte Shoqërinë dhe revistën e saj në shekullin që po vinte më tej.

Fotografi e Grupit Themelues të Shoqërisë *National Geographic*

Shoqëria *National Geographic* është ngritur "për të njohur dhe për të shpërndarë dijenitë për gjeografinë", ndërsa botimi i revistës është vendosur të jetë një prej mjeteve për të arritur këtë qëllim.

Meqë ajo nuk ka për qëllim të jetë, vetëm organ i shoqërisë, faqet e saj do të jenë të hapura për tërë ata që janë të interesuar për gjeografinë, me shpresë që ajo të bëhet urë lidhëse ndërkomunikuese, të nxisë hulumtimin për gjeografinë dhe të kthehet në një mjet të pranueshëm për botimin e rezultateve. Pas më shumë se një shekulli në botim, revista e shoqërisë *National Geographic* e sheh sot veten si lokomotiva që nxit dëshirën e të rinjve për të njohur gjeografinë dhe burimet e planetit tonë, në tërë kuptimin e fjalës.



Presidenti i parë i shoqërisë *National Geographic* Gardiner Grine Hubard

Në këtë rrugë të gjatë që kur u botua për herë të parë *National Geographic Magazine* e deri tani kur po botohet ky libër, kanë kaluar 118 vjet. Nuk ka cep të globit ku të mos kenë shkelur udhëtarët, studiuesit,

zbuluesit, gjeografët, speleologët, etnografët, demografët, si dhe çdo lloj hulumtuesi tjetër i shoqërisë *National Geographic*.

Shqipëria dhe shqiptarët duhet të jenë krenarë për paraqitjen që revista u ka bërë në rrjedhë të kohëve.

Historia e shkurtër e shoqërisë dhe revistës



Kjo është fotografia e kopertinës së numrit të parë të revistës *National Geographic*

Fotografi nga M. Berisha, prill 2004
Biblioteka Publike në New York 42nd Street, 5th Avenue

MBYLLJE

Në tërë këtë korpus vlerësimesh për kombin shqiptar të bëra nga shtypi amerikan, del e qartë se populli shqiptar i ka dhënë njerëzimit shumë vlera, se është një komb dhe një racë e lashtë që meriton respekt, por që dallgët e historisë e kanë përplasur aq shumë, sa i mbetet edhe shumë punë për të bërë, për të arritur aty ku kanë arritur kombet e qytetëruara.

Ky libër ka për qëllim të na bëjë të ndihemi krenarë për prejardhjen tonë dhe secili, me mundësitë e veta, cilatdo qofshin ato dhe sado modeste, të lartësojë emrin e ndritur të shqiptarit dhe të kombit tonë.